

bulevardi: Gjerq Fishta, (ish npv nr.2)
tel: 068 20 16 616
info@uet.edu.al
www.uet.edu.al



RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
Për programin e studimit të *Shkollës Doktorale*
në Shkencat Sociale dhe të Edukimit,
Universiteti Europian i Tiranës

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Prof. Asoc. Dr. Aleksandër DHIMA
Dr. Tomi TRESKA
Gilman BAKALLI PhD
Erika MELONASHI PhD
Marsel CARA Dokt.

Tiranë, prill 2013

HYRJE

Programi i studimit të doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit pranë Universitetit Europian të Tiranës (më tej: UET) është hapur duke u mbështetur në:

- Urdherin Nr. 503, dt. 07.10.2011 te Ministrit te Arsimit dhe Shkencës për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë/ Studime të Doktoraturës në ‘Shkenca Sociale’, ‘Shkenca Ekonomike’ dhe ‘Shkenca Juridike’ të Universitetit Europian të Tiranës”;
- VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 për “Ndryshimin e emërimit nga ‘Shkolla e Lartë Universitare Jopublike, Universiteti Europian i Tiranës’ në ‘Universiteti Europian i Tiranës’;
- Statutin e Universitetit Europian te Tiranës;
- Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e Programit, nr. 14, dt. 22.12.2010.

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)

Raporti është përgatitur nga Grupi *ad-hoc* i ngritur për këtë qëllim në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit, me Urdhër të Rektorit të UET-it, nr. 2, dt. 06.03.2013. Në përzgjedhjen e anëtarëve të *Grupit* është mbajtur parasysh kompetenca e tyre profesionale, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm. *Grupi* ka një strukturë organizative me drejtuesin e tij dhe anëtarët, ku një prej tyre është përfaqësues i studentëve doktorantë.

Përbërja e GVB *ad-hoc* për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit është si vijon:

1. Prof. Asoc. Dr. Aleksandër DHIMA, Nëndrejtor i Shkollës Doktorale pranë UET-it (Kryetar).
2. Dr. Tomi TRESKA, Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit, UET (Anëtar).
3. Gilman BAKALLI PhD, Anëtar i KSBC-së në UET (Anëtar).
4. Erika MELONASHI PhD, Përgjegjëse e gruplëndëve “Psikologji” në UET (Anëtare).
5. Dokt. Marsel CARA (përfaqësues i studentëve doktorantë).

Në punën për hartimin e Raportit, *Grupi* ka vepruar me përkushtim dhe përgjegjësi të qarta. Në konsultim me personelin akademik dhe studentë, anëtarët e *Grupit* në analizën e tyre e kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të programeve që i nënshtrohen akreditimit, si dhe në ecurinë e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tyre, në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion si dhe kanë evidentuar parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit.

Grupi është mbështetur në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, aktet nënligjore përkatëse në fuqi, në mënyrë të veçantë në udhëzimet e APAAL-it si dhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. *Grupi* i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat statistikore që nevojiten për procesin e akreditimit, të cilat të strukturuar në formën e tabelave janë përfshirë në Raport.

Në mbështetje të Raportit është përgatitur *Dosja e Vlerësimit të Brendshëm*, në përbërje të së cilës vend qendror zë *Raporti i Vlerësimit të Brendshëm*. Në përmbajtjen e *Dosjes* përfshihet edhe dokumentacioni në mbështetje të vlerësimit.

POLITIKAT E DREJTIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Qëllimi dhe objektivat, Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike te UET-it

Programi i studimit të doktoratës në Shkenca Sociale dhe te Edukimit është një shkallë e epërme e studimit universitar i cili kërkon të ofrojë, në përputhje me filozofinë e UET-it, trajtim dhe zgjidhje për problemet me të cilat përballet shoqëria bashkëkohore shqiptare nëpërmjet krijimit të shkencëtarëve të cilët kanë një formim akademik që u lejon të ofrojnë një mendim të thelluar shkencor, një mendim analitik të plotë. Gjithashtu Universiteti European i Tiranës vë në dispozicion të kandidatëve për doktorë infrastrukturën, metodologjitë dhe informacionet shkencore më të plota dhe më të gjera në fushën e shkencave sociale dhe të edukimit.

Ky Program i doktoratës, për vetë fushat e studimit në të cilat zhvillohet, ka një qasje të gjerë rreth problemeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria shqiptare, si për sa i përket mënyrës së organizimit të institucioneve në një shoqëri dinamike që po zhvillohet në një kuader Rajonal dhe Evropian, ashtu edhe për problemet e funksionimit të tyre. Kandidatët për gradën shkencore “Doktor” do të kryejnë studime të thelluara në një fushë të përcaktuar qartë të problemeve sociale dhe të edukimit, në të cilën do të dëshmojnë një qasje shteruese për sa i përket teorive bashkëkohore dhe një aftësi analizuese e zbatuese në përputhje me problemet e shoqërisë sonë. Kjo synohet të arrihet duke zhvilluar marrëdhënie të ngushta pune e bashkëpunimi me një ose më shumë pedagogë dhe duke shkruar si bashkautorë me ta studime, kumtesa apo artikuj.

Vizioni: Të jetë një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve, një qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike, juridike, të edukimit dhe të teknologjisë së informacionit në vend, me ndikim në rajon dhe më gjerë, si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor në drejtimet specifike ku zotëron potencial prodhues.

Misioni: T’u japë studentëve një edukim cilësor, duke përthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm që do t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës si dhe partneriteteve me Tregun e Punës dhe atyre ndërkombëtare.

Për realizimin e *Vizionit* dhe *Misionit* të tij, UET-i ka si Objektiva Strategjike:

- a. Arritjen e ekselencës në të gjitha fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit;
- b. Mbajtjen e një profesorati të shquar që zotëron vlerat dhe aftësitë më të larta profesionale;
- c. Cilësinë e lartë në proceset akademike dhe të infrastrukturës së institucionit;
- d. Pajisjen e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisin më tej dijet, aftësitë dhe përvojën e tyre;
- e. Ndërtimin e urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- f. Krijimin e një mjedisi nxitës e zhvillues për profesorat dhe studentët;
- g. Sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm për ndjekjen e ekselencës;
- h. Sigurimin e fleksibilitetit dhe përgjegjshmërisë.

Studimet e ciklit të tretë

Programet e studimeve të Doktoraturës janë me karakter akademik; ato kanë në bazë kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese të pavarur. Këto studime zgjasin të paktën 3 (tre) vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite të studimeve të organizuara. Në përfundim të programeve të studimit të doktoraturës lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor" (Dr). Për administrimin e këtyre programeve, në UET është ngritur *Shkolla Doktorale* në vitin akademik 2011-2012.

Qëllimet dhe objektivat e Programit të studimit

Programi përmban veprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thelluar teorik, të përvetësimit të metodologjive të kërkimit dhe të teknikave operative të posaçme, të realizuara nëpërmjet moduleve mësimore, seminareve ndëraktive, periudhave të kërkimit pranë strukturave të kualifikuara etj. Keto veprimtari janë përcaktuar në mënyrë të qartë; ato janë të lidhura me objektivat formuese të Programit të studimit të doktoraturës dhe janë të kontrollueshme. Programi përfshin kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për punimin e tezës së doktoratës dhe mbrojtjen e suksesshme të saj, që çon në marrjen e grades "Doktor i Shkencave". Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit në Universitetin Europian të Tiranës i ofron programet e doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Astonit/ Birmingham (Britani e Madhe). Në 'të janë angazhuar edhe pedagogë të njohur të universiteteve publike shqiptare (Universiteti i Tiranës, Universiteti AAB i Prishtinës, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë).

Ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën

Programi i studimit të doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit pranë Universitetit Europian të Tiranës përfshihet në ciklin e tretë të studimëve universitarë dhë, në përfundim të tij, lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor". Ai ka kohëzgjatje së paku 2 (dy), përkatësisht 3 (tre) vjeçare, në varësi të llojit të diplomës së përfutur në ciklin e dytë të studimeve. Afati i mbrojtjes së tezës së doktoratës nuk duhet të kalojë, si rregull, 3 vjet nga regjistrimi në program, por- për arsye të përligjura- kandidati mund t'i kërkojë Këshillit të Profesorëve shtyrje të afatit të përfundimit të studimeve të doktoraturës duke paraqitur dhe dokumentuar edhe arsyet e kësaj shtyrjeje. Kjo shtyrje nuk mund të kapërcejë gjithsesi afatin 4 vjet nga regjistrimi në program. Për studentët të cilët janë të përfshirë në programe studimi specializuese afatgjata të ciklit të tretë ose që janë në marrëdhënie pune do të ndiqen afatet e përcaktuara në pikën 10.2 të *Rrëgjullorës së UET-it*. Në programet e doktoraturës, në përputhje me kërkesat e pikës 6 të kësaj *Rregulloreje* mund të regjistrohen edhe studentë, të cilët janë të përfshirë në programe studimi specializuese afatgjata të ciklit të tretë, sipas pikës 1.3.3 të nënit 26 të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë", të ndryshuar.

Në kushtet e mësipërme, në programet e doktoraturës mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët janë në marrëdhënie pune, si lektorë në institucione të tjera të Arsimit të Lartë apo në administratën publike. Për arsye se kjo kategori studentësh nuk është në gjendje të sigurojë frekuentim të plotë të aktiviteteve të parashikuara për doktoratën, koha e përfundimit të programit të Doktoratës për këta studentë mund të shkojë deri në 6 vjet. Skeduli për shlyerjen e detyrimeve përcaktohet me miratim të Drejtorit të Shkollës Doktorale.

Organizimi dhe veprimtaria e Programit të studimit të doktoraturës në Shkenca Sociale dhe të Edukimit mbështetet në:

- Ligjin nr. 9741, date 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- VKM Nr. 864, datë 5.12.2007, "Për hapjen e programeve të studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor," i ndryshuar;
- VKM Nr. 796, datë 22.7.2009 "Për Hapjen e Programeve të Reja të Studimit, "Mastër i Nivelit të Dytë", Pranë Shkollës Së Lartë Universitare, Private, "Universiteti Europian i Tiranës"
- Udhëzimin e MASH-it, Nr. 24, datë 2.9.2009 "Për disa Shtesa dhe Ndryshime në Udhëzimin Nr. 30, datë 26.9.2007 "Për Përcaktimin e Procedurave dhe Dokumentacionit që Duhet të Paraqesë Subjekti Juridik, për Hapjen e nje Institucioni Privat të Arsimit të Lartë ose Programeve të Studimit, në Ciklin e Parë dhe Ciklin e Dytë të Studimeve", të ndryshuar;
- Udhëzimin e MASH-it, Nr. 5, datë 22.1.2008 "Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementeve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse";
- Udhëzimin e MASH-it, Nr. 20, datë 29.7.2009 "Për disa ndryshime në shtojcën 1 të udhëzimit Nr. 5, "Për përcaktimin e standarteve akademike të nevojshme për hapjen, mbylljen dhe riorganizimin e programeve të studimit të doktoratës, si dhe të elementëve bazë, sipas të cilave institucionet e arsimit të lartë duhet të përgatisin rregulloren përkatëse";
- Udhëzimin e MASH-it, Nr. 21, datë 30.7.2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë";
- Udhëzimin e MASH-it, Nr. 39, datë 08.12.2009 "Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 21, datë 30.7.2009 "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë";
- Udhëzimin e MASH-it, nr. 22, datë 14/09/2012 (i cili ka filluar të zbatohet në 2013);
- Urdhërin Nr. 503, dt. 07.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për "Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në 'Shkenca Ekonomike', 'Shkenca Sociale' dhe 'Shkenca Juridike' të Universitetit Europian të Tiranës;
- VKM Nr. 657, datë 28.09.2011 për ndryshimin e emërimit nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës", në "Universiteti Europian i Tiranës";
- Statutin e Universitetit Europian te Tiranës;
- Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e programit, Nr.14, datë: 22.12.2010.

Të dhëna të përgjithshme për programin e studimit

Viti I - *Formim i thelluar teorik*

Viti i parë synon një formim të thelluar teorik në fushën e zgjedhur të Shkencave Sociale dhe të Edukimit, përvetësimin e metodologjive të kërkimit dhe zbatimit e këtyre metodologjive në mënyrë të pavarur në fushën e interesit të studentit. Studentët e vitit të parë të doktoratës ndjekin programin teorik (60 ECTS) që ofron UET-i. Studentët e vitit të parë ndjekin aktualisht një program teorik prej 7 lëndësh, 4 të përbashkëta dhe 3 të specialitetit apo drejtimit të zgjedhur prej tyre. Lëndët e propozuara janë në përputhje me objektivat dhe vetë përmbajtjen e këtij programi studimi; ato pasqyrojnë përvojën dhe strukturën e lëndëve që universitete cilësore perëndimore ofrojnë në cikle të ngjashme

studimesh doktorale. Një pjesë e krediteve merren përmes lëndëve të zhvilluara nga lektorë të huaj të Universitetit të Astonit/ Birmingham (me marrëveshje individuale). Në varësi të interesit të tyre, kandidatët përzgjedhin drejtimet: Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Sociologji-Antropologji Sociale, Komunikim-Dizajn, Psikologji, Pedagogji. Në fund të vitit të parë, ata testohen në një provim formues (*comprehensive exam*) për gjendjen teorike të disiplinës (10 ECTS), i cili synon njohjen objektive të formimit të tyre teorik. Programi i këtij provimi përbëhet nga një listë tekstesh të autorëve klasikë dhe të rinj, të cilët përfaqësojnë kontributet kryesore në zhvillimin e teorive përkatëse. Pasi kanë grumbulluar 60 ECTS, kandidatet mund të kalojnë në vitin e dytë të doktoratës.

Viti II - Veprimtari kërkimore

Në vitin e dytë të studimeve doktorale, kandidati zgjedh temën e disertacionit të doktoraturës, e cila miratohet nga Këshilli i Profesorëve i universitetit. Bashkë me miratimin e temës dhe udhëheqësit, nga udhëheqësi shkencor miratohet plani individual i punës studimore-kërkimore të kandidatit. Menjëherë pas kësaj, kandidati nis punën kërkimore duke mbledhur të dhënat e nevojshme në terren (në rast se studimi ka karakter empirik) apo në burime të tjera informacioni, sipas rastit. Në fund të vitit të dytë, kandidati duhet t'i paraqesë për miratim udhëheqësit shkencor propozimin/ prospektin për disertacionin e doktoraturës. Është e këshillueshme që brenda vitit të dytë të studimeve doktorale, studenti të mund të paraqesë një punim nga tema e disertacionit të tij në një konferencë apo seminar shkencor dhe, mundësisht, të ketë botuar një artikull (si autor i vetëm apo si bashkautor) në një revistë shkencore, brenda apo jashtë vendit, apo të ketë marrë zyrtarisht konfirmim për botimin e tij nga redaksia e një reviste shkencore.

Viti III - Kërkim / krijim + përpunim të dhënash + botim artikujsh + referime

Gjatë vitit të tretë, kandidati vazhdon të thellohet në punën e tij studimore. Ai analizon teorikisht, përpunon të dhënat e mbledhura dhe fillon të shkruajë disertacionin. Në proces e sipër, studenti punon për të paraqitur një kumtesë tjetër nga tema e disertacionit në një konferencë apo seminar shkencor dhe të botojë artikuj (si autor i vetëm ose në bashkautorësi) në revista shkencore, brenda apo jashtë vendit. Kandidati harton tezën e doktoratës dhe e mbron atë sipas procedurës së përcaktuar nga ligji dhe rregullorja e programit të studimit. Studentët e mbrojnë tezën e doktoratës vetëm pasi të kenë dëshmuar njohjen e gjuhës angleze përmes testeve të njohura ndërkombëtare (IELTS, TOEFL etj) sipas legjislacionit në fuqi.

Nje element i rëndësishem procedural i studimeve doktorale është fakti që pedagoget udhëheqës, sëbashku me doktorantët e tyre, janë të ndarë sipas profileve të Programit të studimit, më tej sipas drejtimeve të mëdha kërkimore brenda profileve, duke pasur në konsideratë *Akset kërkimore* të çdo pedagogu. Kjo gjë bën që doktorantët, gjatë udhëheqjeve të tyre, të punojnë në grupe të vogla pune, në kuadrin e *Ditëve doktorale*, duke shkëmbyer përvojën me njeri-tjetrin.

Një element i rëndësishëm i *Shkollës Doktorale* të UET-it, që ndihmon në përgatitjen e studentëve dhe mbajtjen e tyre në kontakt të vazhdueshëm me kërkimin shkencor, janë *Ditët doktorale*. Në 'to kandidatët raportojnë ecurinë e tyre përpara komisioneve shkencore që ngrihen me pedagogë udhëheqës të fushave të ngjashme. Vërejtjet dhe sugjerimet që marrin, ata i pasqyrojnë në punën e tyre. Gjithashtu, garantimi i zbatimit të standarteve të kërkimeve shkencore në zhvillimin e Programit të doktoratës vjen si rezultat i:

- Verifikimit dhe pranimit të *Propozimit doctoral* që dorëzojnë kandidatët në momentet e para të regjistrimit të tyre;
- Verifikimit të dosjeve prej Këshillit të Profesorëve.

Të gjitha sa më sipër mundësojnë harmonizimin e synimeve të studentit në fushën kërkimore-shkencore me projektet kërkimore të miratuara për këtë qëllim.

Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor

Kreditet teorike: Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoraturës, studenti ndjek lëndët e parashikuara në programin përkatës, sipas planit mësimor të miratuar, për të grumbulluar 50 kredite, nga të cilat një pjesë e krediteve merren përmes kurseve të zhvilluara nën drejtimin e personelit akademik të huaj (p.sh. nga universiteti i Astonit) dhe të tjerat përmes kurseve të zhvilluara nën drejtimin e personelit akademik vendas (të UET-it, ose universiteteve të tjera shqiptare). Studenti, i cili ka përfunduar ose vijon studimet në një program studimi të ciklit të tretë në universitete të tjera shqiptare ose të huaja, mund të transferojë kreditet e fituara në programin e doktoraturës të UET-it, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit.

Provimi për gjendjen teorike të disiplinës: Në fund të vitit të parë, studenti i nënshtrohet një provimi që përbën themelin e formimit të tij teorik dhe ka peshën e 10 krediteve. Nënshttrimi ndaj këtij provimi është detyrim për cilëndo kategori studentësh të regjistruar në programet e Doktoraturës. Provimi për gjendjen teorike të disiplinës jepet mbi bazën e një liste librash të hartuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale dhe të miratuar nga Këshilli i Profesorëve. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një Komision i përbërë nga 5 (pësë) profesorë të fushës kërkimore përkatëse ose të përafërt më të. Kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara, dhe i ndërpresin studimet e doktoratës. Pasi ka grumbulluar 60 kredite studenti kalon në vitin e dytë të doktoratës.

Detyrimet e tjera akademike: Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) Të ketë realizuar, së paku, tre referime ose paraqitje shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje (poster) të jenë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*" të indeksuar me kod *ISBN*-je.
- b) Të ketë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencore në revista shkencore; dy prej artikujve duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të njohura (me bord editorial) të vendeve të zhvilluara, sipas listës së miratuar me urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të KALSH-it, KVTA-së dhe Konferencës së Rektorëve.
- c) Të ketë paraqitur në Këshillin e Profesorëve dosjen e plotë që përmban edhe disertacionin e përfunduar. Disertacioni duhet të jetë në shqip, shoqëruar me përmbledhje në shqip dhe anglisht (rreth 20 mijë fjalë), i miratuar nga udhëheqësi shkencor i studentit. Pas shqyrtimit të dosjes, Këshilli i Profesorëve i përcjell Drejtorit të Shkollës Doktorale vendimin për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës. Kur Këshilli i Profesorëve vendos pozitivisht, ai i propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale edhe jurinë për mbrojtjen e Doktoratës.
- d) Të paktën një herë në vit, studenti raporton përpara një komisioni të përbërë nga Drejtori i Shkollës Doktorale, Koordinatori i programit, Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe udhëheqësi shkencor i temës; Komisioni vendos për vazhdimin normal të programit nga kandidati ose për plotësimet e nevojshme.

- e) Të ketë dhënë provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.
- f) Nëse nga këto analiza arrihet në përfundimin se studenti nuk është i aftë për vazhdimin e mëtejshëm të programit, Komisioni mund t'i propozojë Këshillit të Profesorëve çregjistrimin e tij nga programi.

Emërtimi i programit të studimit: Është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Në Urdherin Nr. 503, dt. 07.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë të studimeve të Doktoraturës në ‘Shkenca Ekonomike’, ‘Shkenca Sociale’ dhe ‘Shkenca Juridike’ të Universitetit Europian të Tiranës”, specifikohet në pikën 1.ii “Dokoratë në ‘Shkenca Sociale’” më profile:

- a. Shkenca Komunikimi;
- b. Shkenca Politike;
- c. Marrëdhënie Ndërkombëtare;
- d. Sociologji-Antropologji Sociale;
- e. Psikologji;
- f. Pedagogji.

Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Shqipëria ka nevojë për qytetarë të formuar dhe të edukuar më mirë si edhe për një forcë pune më të aftë, me qëllim që të ndërtojë një shoqëri të së ardhmes, bazuar në dije.

Programi i studimit të doktoratës në Shkenca Sociale dhe të Edukimit mbështetet totalisht mbi objektivat kryesore për mbështetjen dhe realizimin e *Strategjisë së UËT-it* për mësimdhënie, përvetësimin e dijeve dhe kërkim shkencor, të cilat përmblihen si më poshtë:

- o Edukimi i studentëve për një jetë qytetare aktive me impakt në zhvillimin e shoqërisë dhe promovimin i standarteve të demokracisë në Shqipëri;
- o Zhvillimi dhe konsolidimi i një baze të gjerë dhe të përshtatshme dijesh në shërbim të vendit;
- o Formimi i një force pune të kualifikuar për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit në veçanti dhe atij rajonal në përgjithësi;
- o Përbushja e aspiratave të brezit të ri për edukim dhe zhvillim.

Për të përmbushur këto objektiva, duke u mbështetur në nevojat e shoqërisë, UET do të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në funksion të përditësimit dhe zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve, si të mësimit ashtu edhe ofrimit të shërbimeve. Për realizimin e objektivave të mësipërme, UET do të punojë në pesë orientime strategjike në pesë vitet e ardhshme:

- o *Sigurimi i shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, përshtatja e metodave dhe e niveleve të financimit për ato dhe zgjerimi i sistemit, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit.*
- o *Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve në UET, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të kulturës së cilësisë.*
- o *Përmirësimi i jetës studentore, përvojës universitare, shtrirja dhe diversifikimi i mundësive të studentëve për të zhvilluar karrierën e tyre si qytetarë të së ardhmes.*

- *Përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimeve mbështetëse akademike*, në mënyrë që të plotësohen nevojat e UET-it me auditore cilësore, laboratore dhe biblioteka, në perspektivën e arritjes të standarteve për integrimin në Bashkimin Europian (BE) dhe HEAL (në kuptimin e treguesve për shkollimin terciar të popullsisë, psh: hapësira akademike për numër studentësh, numri i studentëve në auditore, numri i pedagoqeve për studentë, bibliotekat pasive, bibliotekat virtuale etj).
- *Përmirësimi i mekanizmave të qeverisjes* nëpërmjet zhvillimit të parimit të *subsidiaritetit*, përkundrejt rritjes së cilësisë së menaxhimit me llogaridhënie dhe me transparencë, në mënyrë që UET-i të funksionojë realisht si institucion demokratik.

Me realizimin e këtyre prioritetëve, UET-i angazhohet për të krijuar një mjedis që ofron mundësi të barabarta dhe pa diskriminim për të gjithë komunitetin universitar në arritjen e qëllimeve akademike dhe në realizimin e potencialit ekzistues në përmbushjen e misionit të UET-it. Kjo strategji nuk përfaqëson vetëm iniciativa, por edhe reforma në proces për zhvillimin e Universitetit.

Strategjia e Kërkimit Shkencor

Ligji nr. 9741, i ndryshuar në Ligjin nr. 10307, dt. 22.07.2010 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka qenë një hap i rëndësishëm përpara për përmirësimin e sistemit. Mbështetur në këtë ligj, UET-i, nëpërmjet *Strategjisë së mësimdhënies dhe të përvetësimit të dijeve* (MPD) shtron synime dhe objektiva afatgjatë për zbatimin e tij dhe paraqet politikën për prioritetet strategjike në mësimdhënie dhe në përvetësim dijes për vitet që pasojnë deri në vitin 2015.

Strategjia është në pajtueshmëri me prirjet kryesore të zhvillimit të Arsimit të Lartë (AL) në Shqipëri, Europë dhe në botë dhe, në veçanti, me procesin e Bolonjës. Qëllimi i saj është të përmirësojë mësimdhënien dhe përvetësimin e dijeve në nivel cilësor, në mënyrë që UET-i të zërë vendin që i takon brenda hapësirës shqiptare të Arsimit të Lartë, duke synuar Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL).

Strategjia pasqyron vizionin e UET-it për politikën afatmesme dhe afatgjatë në mësimdhënie dhe në përvetësim dijes. Në të janë përfshirë sugjerimet e botës akademike dhe të grupeve të interesit brenda institucionit (UET) si dhe ato të ekspertëve të arsimit të lartë në Shqipëri. Një nga synimet themelore të *Strategjisë* është që *UET të shndërrohet realisht në një Universitet privat në nivel cilësor*. Ky transformim do të kërkojë përmirësim të mtejshme të qeverisjes dhe menaxhimit të UET-it si dhe ndryshime për përmirësim në mekanizmat e sigurimit të llogaridhënies së brendshme dhe të jashtme. Procesi i ndryshimit të një sistemi kompleks drejt cilësisë (si ai i mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve) do të kërkojë kohë dhe është kjo arsyeja, për të cilën *Strategjia* e UET-it shtrihet në një periudhë prej pesë vitesh.

Dokumenti i *Strategjisë së Kërkimit Shkencor* pasqyron frymën/ filozofinë e realizimit të synimeve të mësipërme të UET. Konkretizimi i saj realizohet nëpërmjet katër përbërësve themelore: *mekanizmave të zbatimit*, të cilat përpunohen nga *Njësitë kryesore*, përpunimit të *planeve të integruara* që realizohen nga Dekanatet; procesit të *monitorimit* dhe *vlerësimit*, që përbën një detyrë parësore të *Këshillit të Shkencës*; *financimit* të projekteve një dhe shumëdisiplinore, që miratohen nga *Shkolla Doktorale* dhe *Qendra UET*.

Zbatimi i objektivave të Strategjisë

Planifikimi Strategjik i Universitetit nënkupton një proces ciklik, i cili fillon me vendosjen e *Objektivave Strategjike* dhe vazhdon me *përzgjedhjen*, duke u mbështetur në cilësinë, rigorozitetin shkencor dhe rëndësinë akademike dhe praktike të projekteve specifike që do të zbatohen. Zhvillimi i *Strategjisë së Kërkimit Shkencor (SKSH)* mbështetet në rëndësinë e

efektivitetit që sjellin mekanizmat e rishikimit periodik të prioritetëve të kërkimit shkencor, si dhe të vlerësimit të mundësive dhe kërcënimeve.

Indikatorët Kritikë të Suksësit (IKS) zhvillohen për ndjekjen e realizimit të synimeve të UET për kërkimin shkencor, njëkohësisht ato shërbejnë për përcaktimin e rezultateve të pritshme që lidhen sidomos me objektivat bazë të *Strategjisë*. IKS listohen në *Strategji* me shembuj konkretë të produktit bazë. *Plani i Veprimit*, në mbështetje të realizimit të *Objektivave*, synon realizimin e IKS, të cilat miratohen në mbledhjet e *Këshillit të Profesorëve të Shkollës Doktorale* në fund të çdo viti akademik.

Planet e Integuara të Kërkimit Shkencor detajohen me afate kohore të realizimit të veprimeve, ato hartohen dhe plotësohen me përgjegjësitë konkrete për secilën nga hallkat e UET-it, që nga ato akademike (*Njësitet kryesore bazë*) deri te ato administrative dhe mbështetëse, duke përfshirë kostot financiare. *Raporti* përfundimtar mbi progresin e bërë në drejtim të realizimit të veprimtarive kërkimore dhe IKS i paraqitet *Këshillit të Profesorëve* dhe miratohet prej tij në mesin e muajit korrik të çdo fundviti akademik.

Duke filluar nga viti akademik 2010-2011, UET ka një pozicion të ri dedikuar posaçërisht Kërkimit Shkencor, që është pozicioni i Zv/Rektores për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. Ky pozicion synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor që nga fakultetet/departamentet, Shkolla Doktorale dhe pasurimi i përhershëm i bibliotekës, si dhe ruajtja e standardeve të botimit në revistat shkencore të UET.

Kërkimi shkencor në UET zë një vend qendror dhe është baza e mësimdhënies për personelin akademik. Kërkimi shkencor bazohet në tre shtylla: Shkollën Doktorale, revistat shkencore, bibliotekën dhe njësinë e lëndëve metodologjike në UET, nga niveli Bachelor deri në atë Doktorat. Aktorët të cilët përfshihen në të tri këto shtylla janë së pari Departamentet si dhe *Qendra UET*. Pozicioni i Zv/Rektores për Kërkim Shkencor dhe Metodologji bashkëpunon ngushtë me *Qendrën UET për Projekte dhe Kërkim Shkencor*, me synim koordinimin e burimeve njerëzore për projekte të ndryshme kërkimore.

Shkolla Doktorale dhe Kërkimi Shkencor

Shkolla Doktorale ka një rëndësi kyçe, sepse nxjerr hulumtuesit dhe punonjësit e parë shkencorë të përgatitur në UET. Po ashtu, Shkolla Doktorale ofron udhëheqje shkencore për kandidatet dhe strukturën punën kërkimore të stafit akademik sipas drejtimeve specifike kërkimore. Drejtimet kërkimore të Programit të studimit udhëhiqen nga pedagogë dhe studiues me gradën më të lartë dhe numrin më të madh të botimeve në fushën përkatëse. *Konferencat (Ditët) Doktorale* strukturohen sipas Drejtimeve doktorale dhe organizimi i tyre sipas Drejtimeve kërkimore synon të arrijë të paktën tri objektiva:

Së pari, të prodhojë ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në një fushë të caktuar dhe të kthejë Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit në një burim të vazhdueshëm dijeje dhe konsulence, si për komunitetin akademik ashtu dhe për aktorë të tjerë;

Së dyti, rritja profesionale e stafit akademik dhe kërkimor brenda ekspertizave dhe fushave të tyre të interesit shkencor;

Së treti, krijimi i një ose disa komuniteteve kërkimore, të cilët ndërveprojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin në funksion të gjetjeve dhe analizave kërkimore sa më të arrira dhe bindëse.

Përshtatja e programeve të studimit me Vizionin, Orientimet dhe Strategjinë për Zhvillim të Institucionit

Oferta akademike e UET ka arritur nivelet e standartizuara nga APAAL-i, e provuar kjo edhe nga akreditimet e marra për ciklin e parë, të dytë dhe stadin fillestar të ciklit të tretë (MND).

Ndërkohë, për të përmirësuar cilësinë e ofertës akademike, kërkohet vazhdimisht zhvillimi dhe rifreskimi i saj. Në këtë kontekst, UET perpiqet të fuqizojë vazhdimisht programet ekzistuese, në mënyrë që këto të fundit të vazhdojnë të operojnë me këto standarde e për më tepër të garantojë që çdo nismë për hapjen e programeve apo cikleve të reja, të plotësojë kriteret dhe standardet e përcaktuara.

Zgjerimi i UET-it është një prioritet që do të ndiqet në vijimësi, por pa cënuar cilësinë. Ky zgjerim nuk mund të jetë më i shpejtë se rritja e kontigjentit të përshtatshëm për shkollim të lartë, që kushtëzohet nga evolucioni i sistemit parauniversitar dhe, mbi të gjitha, nga politikat publike të Arsimit të Lartë në Shqipëri si dhe nga numri i studentëve që duan t'i ndjekin studimet jashtë. Ky zgjerim, me afro 3.500 studentë për një periudhë 5-vjeçare, është rrjedhojë e:

- (i) Rritjes së pritshme vjetore të kontigjentit të nxënësve që përfundojnë me sukses shkollën e mesme;
- (ii) Hapjes së programeve të reja të ciklit të dytë (master profesional);
- (iii) Zgjerimit të UET-it me programet doktorale.

Ky objektivi zgjerimi është ambicioz, sidomos në kushtet e rritjes së ndjeshme të numrit të studentëve në universitetet publike dhe në kushtet e një tregu ende informal të universiteteve private. Rritja e numrit të studentëve në UET shkon krahas rritjes së kapacitetit të sistemit për të ofruar një shërbim që respekton standardet. Për këtë është siguruar:

Së pari, numri i nevojshëm i personelit akademik me kualifikim të përshtatshëm. Gjithsesi, UET-i ka realizuar tashmë në detaje një *Plan Strategjik Veprimi* për rekrutimin e studentëve të rinj, marketingun e arritjeve të studentëve aktualë dhe për vazhdimësinë e studimeve të tyre në UET.

Aspekti i dytë lidhur me zgjerimin e sistemit ka të bëjë me *burimet fizike* të ndërtesave dhe pajisjeve. Aktualisht, mjediset e UET-it përdoren përgjithësisht në mënyrë efektive gjatë javës dhe gjatë vitit; një përdorim në një shkallë më të lartë i mjedisëve dhe pajisjeve në orët e pasditës dhe gjatë fundjavës për programin e Doktoraturës ka rritur mundësinë e sistemit për zgjerim.

Aspekti i tretë lidhur me zgjerimin e sistemit ka të bëjë me përshtatshmërinë e mbështetjes financiare në të ardhmen. Qeveria është e angazhuar të dyfishojë fondet publike për arsimin në 5 vitet e ardhshme. Parashikohet që Arsimit të Lartë të ruajë përqindjen aktuale në buxhetin total të arsimit, por ajo që do të afektonte direkt UET-in, si institucion i Arsimit të lartë jopublik, do të ishte *skema e re e financimit të AL*, e parashikuar të implementohet qysh këtë vit. Mbështetja financiare nga burime të tjera, përfshirë kontribute private dhe ndihmë nga agjensi shumëpalëshe apo dypalëshe, është një nga mundësitë që do të shfrytëzohet. Një plan veprimi i *Qendrës UET* dhe i instituteve të tjera të UET-it në mbështetje të *Strategjisë për Shkencën dhe Partneritetet* dhe *Zyrës së Shërbimeve dhe Financës* do të bashkërendojë mundësitë e financimit nga burime të ndryshme. Pavarësisht kufizimeve, mendohet se objektivi për zgjerimin e UET-it mund të realizohet pa prekur cilësinë e tij.

Për të realizuar vizionin e tij, UET do të kërkojë *zhvillime cilësore* të sistemit të mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve me kohë të plotë. Ky zhvillim do të shoqërohet edhe me ndryshime të formës aktuale të sistemit (psh: *mësimi në distancë* apo edhe *part-time*, *diplomat në dy gjuhë* në kuadër të bashkëpunimit me universitete të huaja) dhe me një sistem të reformuar. Kjo do të ketë kosto financiare, por është me vlerë nëse kryhet

duke e transformuar UET-in në një universitet modern dhe cilësor. Kështu, kostot e zvillimit do të jenë më shumë investim për të ardhmen se sa thjesht shpenzim parash.

Niveli i zhvillimeve cilësore të sistemit të mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve në UET duhet të marrë në konsideratë dy aspekte të kërkesës së sotme: nevojat e ardhshme të Tregut të Punës dhe dëshirat e studentëve për të hyrë në sistemin e AL.

VIZIONI DHE ORIENTIMET STRATEGJIKE

Shqipëria në shek. XXI, si kudo në Europë, do të ketë nevojë për njerëz që kanë shprehur fleksibël dhe të adaptueshme të të menduarit, të analizës, krijimtarisë dhe zgjidhjes së problemeve në rrafsh të gjerë shoqëror. Nevojat e së ardhmes të vendit kërkojnë nga të tre ciklet e ofertës akademike- por, sidomos, nga cikli i tretë- sigurimin e këtyre shprehive dhe ky është ndryshimi më i rëndësishëm që i nevojitet tërë sistemit të AL-së. Sigurisht, do të ketë nevojë të vazhdueshme për njohuri specifike profesionale, por shprehitë e përgjithshme do të bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe, për shumë të diplomuar, do të jenë më me vlerë se njohuritë në drejtime specifike.

Për momentin, oferta akademike e UET-it ka arritur nivelet e standartizuara nga APPAL-i, e provuar kjo edhe nga akreditimet e marra për ciklin e parë, të dytë dhe stadin fillestar të ciklit të tretë (MND)¹. Ndërkohë, për të përmirësuar cilësinë e ofertës akademike, kërkohet vazhdimisht zhvillimi dhe rifreskimi i saj. Në këtë kontekst, UET duhet të fuqizojë programet ekzistuese, në mënyrë që ato të vazhdojnë të operojnë me këto standarde dhe- për më tepër- të garantojë që çdo nismë për hapjen e programeve të reja të plotësojë kriteret dhe standardet e përcaktuara.

Në vitet në vijim prioritet mbetet *reforma kurrikulare*. UET ndeshet me dy sfida në reformën e kurrikulës: rishikimi i kurrikulave ekzistuese dhe lançimi i kurrikulave të reja; që të dyja janë të përshtatshme për një grup të ngjashëm zgjidhjesh. Kështu, duhet bërë e qartë nevoja për të racionalizuar ofertën kurrikulare në shkallë Universiteti, kjo në përputhshmëri me kriteret dhe ofertën akademike për çdo cikël studimi, bazuar mbi *teorinë e rrathëve* (risija e kurrikulës, mospërsëritja dhe dublikimi) dhe në përputhje me nevojat e Tregut të Punës. Gjithashtu, *reforma kurrikulare*- perveçse do të mundësojë shumëllojshmërinë e ofertës së studimit në cikle të ndryshme- duhet të krijojë frymëmarrje akademike brenda të njejtit cikël studimi, mundësi ndërkurrikulare (lëvizja nga një fakultet në tjetrin apo dhe nga një program në një tjetër brenda ciklit) dhe do të favorizojë mobilitetin dhe ekuivalentimin e studentëve. Kështu mundësohet një ekuilibër mes gjerësisë dhe thellësisë së studimeve, fleksibilitet i mjaftueshëm kurrikular si dhe lehtësohet zgjedhja/përcaktimi i fushës së studimit nga studentët.

Reforma kurrikulare duhet të konsiderohet një proces akademik dhe menaxherial shumë i rëndësishëm për UET-in në vazhdimësi. Ajo do të nxisë një kulturë diskutimi të gjerë në rrafsh Universiteti dhe do të japë efektisht një kontribut të ndjeshëm për programet dhe diplomat e UET-it. Nëse UET e vendos këtë kulturë, koherenca e ofertave të Universitetit padyshim do të përmirësohet.

Përsa i përket *ngarkesës akademike*, mund të ketë konceptime të ndryshme të saj për IAL të ndryshme, madje edhe për fakultete të ndryshme brenda një IAL-je. Gjithsesi, ngarkesa akademike në UET përfshin katër lloje veprimtarish:

- Mësimdhënien (së bashku me kualifikimin e vazhdueshëm profesional);
- Kërkimin shkencor;
- Transferimin e teknologjisë dhe njohurive;

¹ Studimet në UET, në të tre ciklet e studimit, janë me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas *Sistemit European të Transferimit të Krediteve* (ECTS) dhe në frymën e Kartës së Bolonjës. Ngarkesa normale është 60 kredite në vit.

- Shërbimet;
- Detyrimet administrative.

Strukturat e UET miratojnë në mënyrë institucionale *ngarkesën akademike* për çdo pjesëtar të personelit të tyre dhe vlerësojnë performancën në secilin zë të veprimtarive të mësipërme. Për *mësimdhënien* merret parasysh *Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë*, i hartuar nga njësia përkatëse (KSBC). Konceptimet e ndryshme të ngarkesës kanë ndikime të rëndësishme mbi kriteret e punësimit të personelit akademik dhe të progresit në karrierë.

UET-i ka përcaktuar tashmë disa nga *kriteret e punësimit* dhe të *karrierës akademike*, sipas parimit që ato duhet të jenë fleksibël; kjo do të thotë konceptim dhe zhvillim modelesh të ndryshme për ngarkesën e personelit akademik, parimet e të cilave mund të përfshihen në termat e punësimit të kandidatit. Këto terma punësimi përfshijnë gjithashtu referenca lidhur me përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Si pjesë e marrëveshjes me personelin, që realizon këto përmirësime, parashikohen edhe forma nxitjeje financiare. Në këtë mënyrë, pagat përfshijnë një komponent të lidhur me performancën. Pas përcaktimit të kriterëve të qarta, UET është i përgjegjshëm për të operuar me to në mënyrë plotësisht transparente.

Shumica e personelit të ri akademik, të angazhuar në Doktoraturë përqendrohet në mësimdhënie. Për vendet e reja të punës në Shkollën Doktorale kërkohet minimalisht një kualifikim në nivelin PhD, sipas udhëzimeve të MASH-it. Për të patur një mësimdhënie cilësore dhe me informacion të pasur, personeli akademik është angazhuar në një punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike që i lejon ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse. Për të mbështetur zhvillimin e shpejtë të burimeve njerëzore, personeli akademik i UET-it ka filluar të përfitojë nga *"Fondi i Ekselencës"*, i cili ofron bursa për asistentët që dëshirojnë të kryejnë një pjesë ose të gjithë studimet e doktoratës dhe postdoktoratës në universitetet e huaja me emër.

Në kuadrin e zgjerimit të sistemit, UET-i do të vazhdojë të zbatojë një sistem rigoroz të *Sigurimit të Cilësisë*, për të mbrojtur interesat e studentëve dhe për të garantuar që ata të veprojnë brenda një kuadri me standarde të qarta. *Strategjia* përshkohet nga ideja se, pavarësisht rritjes së numrit të studentëve në UET, kërkesa për cilësi do të mbetet edhe në të ardhmen përgjegjësi publike.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi sipas standardit/ kriterit
Standardi I.1 - Kuadri i përgjithshëm		
Kriteri 1	Programi i studimit i ciklit të tretë (doktoratë) është një program i ri apo një program i riorganizuar;	Programi i studimit të ciklit të tretë (doktoraturë) në Universitetin Europian të Tiranës është një program i ri , i cili është hapur me Urdhërin Nr. 503, datë 07.10.2011 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës për "Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës, në 'Shkenca Ekonomike', 'Shkenca Sociale' dhe 'Shkenca Juridike' të Universitetit Europian të Tiranës". Programi i studimit të doktoraturës në Shkenca Sociale dhe të Edukimit përmban gjithë elementet e nevojshme që garantojnë përputhjen me kriteret dhe kërkesat shtetërore për programet e këtij niveli.

Kriteri 2	Nëse është i riorganizuar, në ç'masë e ka prekur ai programin e mëparshëm.	Duke qenë një <i>Program</i> i ri, ai nuk ka lidhje me ndonjë program të vjetër.
Kriteri 3	Numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit është në përputhje me politikat e Institucioneve të Arsimit Lartë (IAL) ku zhvillohet programi si dhe me politikat shtetërore për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës dhe me raportin e numrit të doktorantëve për një udhëheqës shkencor.	<p>Në Universitetin Europian të Tiranës doktorantët e regjistruar po ndjekin programin e studimit të doktoraturës në Shkencat Sociale dhe të Edukimit prej 2 viteve akademike (2011-2012 dhe 2012-2013).</p> <p>Gjatë vitit akademik 2011-2012, numri i atyre që janë duke e ndjekur këtë Program studimi në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Edukimit është 94 doktorantë (gjatë vitit akademik 2012-2013, numri është në rritje). Aktualisht kane fituar te drejten per te vazhduar ne vitin e dyte te studimit (sipas ligjit te Arsimit te Larte dhe <i>Rregullores</i> se Programit te studimit) 23 doktorante. Procesi eshte ne vazhdim per pjesen tjeter te doktoranteve, sepse provimi i radhes për gjendjen teorike të disiplinës (<i>comprehensive exam</i>) do te jete ne fillim te muajit maj 2013.</p> <p>Këto shifra janë në përputhje me numrin total të doktorantëve për çdo vit (40), të shprehur si një angazhim i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit në kuadrin e Programit të studimit të Doktoraturës, të miratuar me Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e programit, nr. 14, datë 22.12.2010 (rrjedhimisht të rehabilituar me Urdhërin Nr. 503, dt. 07.10.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për “Hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në ‘Shkenca Ekonomike’, ‘Shkenca Sociale’ dhe ‘Shkenca Juridike’ të Universitetit Europian të Tiranës). Ato përputhen gjithashtu me politikat shtetërore për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës.</p> <p>Përsa i përket raportit të numrit të doktorantëve për një udhëheqës shkencor, ai është në përputhje me këto politika dhe, më konkretisht, sipas Udhëzimit nr.21, datë 30.7.2009 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të doktoratës në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe kjo garanton cilësinë e</p>

<p>Kriteri 4</p>	<p>Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga grupe kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare të akredituara për kërkim në fushën a fushat përkatëse të studimeve.</p>	<p>doktoraturave dhe formimin shkencor e kërkues të doktorantëve.</p> <p>UET i ofron programet e doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Astonit, Birmingham (Britani e Madhe) dhe me Universitetin AAB të Prishtinës (Kosovë). Formimi i “Doktorit të Shkencave” kërkon që një pjesë e studimeve të thelluara teorike (e shprehur në kredite), të zhvillohet nën drejtimin e profesorëve të huaj, në UET ose në universitete/ institute kërkimore të tjera brenda dhe jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (tre) mujore dhe jo më të gjatë se sa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës (shih: <i>Rregulloren për “Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratës”</i>).</p>
<p>Kriteri 7</p>	<p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit të ciklit të tretë shqyrtohet nga Këshilli i Profesorëve</p>	<p>Në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, të ndryshuar, në UET është ngritur dhe funksionon në nivel universiteti <i>Këshilli i Profesorëve</i>. Ky organ është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programeve të studimit të doktorates, sipas <i>Statutit</i> të UET-it. Mbështetur në VKM Nr. 467, datë 18.07.2007, pika 1.5, <i>Këshilli i Profesorëve</i> përbëhet vetëm nga pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin “Akademik”, “Profesor” ose edhe titullin “Prof. Asoc.”, por që janë në procesin e aplikimit për titullin “Profesor”. Numri aktual i profesorëve në përbërje të <i>Këshillit të Profesorëve</i> është 8 (tetë).</p> <p>Rregullorja “Per Organizimin e Programeve të Studimit të Doktorates”, në pikën 5.1.1, shprehet: “Këshilli i Profesorëve shqyrton Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programeve të studimit të doktoratës”. Pas shqyrtimit të kërkesave, <i>Këshilli i Profesorëve</i> përcjell propozimet në institucionet përkatëse të Arsimit të Lartë, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave për dhënien e titujve akademikë respektivë.</p> <p><i>Këshilli i Profesorëve</i>, konform legjislacionit në fuqi, është përgjegjës për vendimmarrjen akademike në funksion të drejtimit dhe organizimit të</p>

	<p>studimeve doktorale, realizimin e marrëveshjeve për zhvillimin e doktoratave të ndryshme të UET-it, në bashkëpunim edhe me Universitete të tjera vendase apo të huaja që organizojnë studime doktorale.</p> <p><i>Këshilli i Profesorëve</i> shërben edhe si organ këshillimor për strategjitë e zhvillimit dhe të programimit të aktivitetit shkencor të UET-it si edhe për vlerësimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Prej vlerësimit të kritereve vërehet se standartet e mëpsipërme janë përmbushur, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Arsimit të Lartë dhe të gjitha akteve nënligjore qe rrjedhin prej tij:

- Programi i studimit i ciklit të tretë (doktoratë) është një program i ri;
- Numri i përgjithshëm i doktorantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit ne UET është në përputhje me politikat shtetërore për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në lidhje me njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës;
- *Raporti i Vlerësimit të Brendshëm* të Programit të studimit të ciklit të tretë shqyrtohet nga Këshilli i Profesorëve.

Dokumentacioni i nevojshëm:

Legjislacioni përfshin:

- *Statutin, Rregulloren bazë dhe Broshurën UET*
- *Vendimin e Senatit të UET-it për hapjen e Programit.*

2. Struktura akademike e Shkollës së Doktoratës

Pjesa përshkrimore

Vendi që zë Shkolla e Doktoratës në organigramën e IAL

Shkolla Doktorale është në varesi të drejtperdrejte të *Keshillit të Profesoreve*. Ajo ka në perberje të saj: Drejtorin e Shkolles Doktorale, Koordinatorët e programeve të studimit dhe Sekretarinë (Në dosjen e dokumentacionit ndodhet *Organigrama* e UET- shih Aneksin III).

Të dhëna për personelin akademik përgjegjës për doktoratën

Personeli akademik që angazhohet në Shkollën Doktorale është ndër më të kualifikuarit dhe përbën një garanci për mbarëvajtjen e studimeve të doktoratës pranë Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit në UET. Në mësimdhënie dhe udhëheqje janë të angazhuar gjithsej 41 pedagogë, nga të cilët 21 pedagogë efektivë dhe 20 pedagogë me kontratë. Prej tyre, 19 janë të angazhuar vetëm në mësimdhënie dhe 22 edhe në udhëheqje shkencore. Personeli akademik shqiptar përbëhet nga pedagogë të UET si dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera shqiptare.

Personeli Akademik Efektiv i Shkollës Doktorale (*PAE*) për Programin doktoral të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit përbëhet nga 13 pedagogë, nga të cilët 12 janë të angazhuar në mësimdhënie dhe të gjithë në udhëheqjet e studentëve. Pjesë e këtij stafi janë: 1 Prof. Dr, 4 Prof. Asoc., 7 PhD dhe 1 Dr. Ky personel është i përgatitur, me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, brenda dhe jashtë vendit.

Personeli Akademik me Kontratë (PAK) përbëhet nga 18 pedagogë, të gjithë të angazhuar në mësimdhënie dhe në udhëheqjet e doktorantëve. Pjesë e këtij stafi janë: 5 Prof. Dr, 6 Prof. Asoc. dhe 7 PhD. Ky staf është i përgatitur, me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Pjesë e këtij stafi janë edhe 4 pedagogë të huaj, të angazhuar në mësimdhënie; ata vijnë prej Universitetit të Astonit në Britaninë e Madhe.

Personel Administrativ (PA). Fakulteti ka angazhuar personelin administrativ të nevojshëm:

- o Drejtori i Shkolles Doktorale (në kuader të IAL);
- o Zv/ Drejtor i Shkolles Doktorale (në kuader të IAL);
- o Koordinator i Programit të Doktorates (personel administrativ në kuader Fakulteti);
- o Ndhimes-Koordinator i Programit të Doktorates (personel ndihmës-mësimor shkencor në kuader fakulteti);
- o Koordinator i procesit mesimor (personel ndihmës-mësimor shkencor për te tre fakultetet);
- o Sekretare *Front Office* (personel administrativ për te tre fakultetet);
- o Ndhimes-Sekretare *Front Office* (personel administrativ për te tre fakultetet);
- o Sekretare mesimore e Shkolles Doktorale (personel administrativ për te tre fakultetet).

Përbërja e Stafit të Shkollës Doktorale

<i>Emër Mbiemër</i>	<i>Titulli</i>	<i>Pozicioni</i>
Adrian Civici	Prof. Dr	Drejtor i Shkollës Doktorale UET
Aleksandër Dhima	Prof. Asoc.Dr	Zv/ Drejtor i Shkollës Doktorale UET
Odeta Barbullushi	PhD	Koordinatore e Programit të Studimit për Fak. e Shkencave Sociale dhe të Edukimit

Anjeza Xhaferaj	Doktorante	Ndihmës/ Koorditore e Programit për Fak. e Shkencave Sociale dhe të Edukimit
Arnisa Gorezi	PhD	Koordinator e Programit të Studimit për Fakultetin Juridik
Blerta Alushi	Doktorante	Ndihmës/ Koorditore e Programit për Fakultetin Juridik
Kreshnik Bello	Dr.	Koordinator i Programit të Studimit për Fak. e Ekonomisë dhe Teknol. së Informacionit
Saimir Suma	Doktorant	Ndihmës/ Koordinator i Programit për Fak. e Ekonomisë dhe Teknol. së Informacionit
Besarta Vladi	Doktorante	Koordinator mësimore
Nertila Koka	MA	Sekretare administrative (<i>Front Office</i>)
Amela Hoxha	Masterante	Ndihmës/ Sekretare administrative (<i>Front Office</i>)
Vilma Hako	MA	Sekretare mesimore e Shkollës Doktorale

Tregues të matshëm:

- Organigrama e organizimit të Shkollës Doktorale (shih Aneksin III bashkëngjitur *Raportit*)
- Numri i personelit akademik dhe administrativ të përfshirë në programin e doktoratës: PAE, PAK, PA, titujt/gradat për të tre Fakultetet (Tab. 1)

Tabela 1

Shkolla e Doktoratës	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	45	19/26	45	33/12	33	0	123	52/38

- Numri i personelit akademik, i përfshirë në programin e doktoratës: PAE, PAK, PA, titujt/gradat për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit (Tab. 1a)

Tabela 1a

Shkolla e Doktoratës	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	13	1 Prof. Dr 4 Prof. As. 7 PhD 1 Dr.	18	5 Prof. Dr. 6 Prof. As. 7 PhD	10	2 Prof. As 1 PhD 5 Dokt. 1 MA 1 BA	41	6 Prof. Dr. 12 Prof. As. 15 PhD 5 Dokt 1 Dr 1 MA, 1 BA

- Të dhëna statistikore për studentët e pranuar në vitin akademik 2011-2012 në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit (Tab. 1b)

Tabela 1b

NR.	Të dhëna statistikore për studentët e pranuar	
1	Nr. total i doktoranteve te pranuar ne Fakultetin e Shkencave Sociale dhe te Edukimit	94*
2	Nr. i doktoranteve jashte njesise që ka hapur programin	0
3	Numri dhe % që zë në nivel programi studimesh i atyre qe kane nderprere studimet	4 / 4.08%
4	Nr. ne % i doktoranteve nga Kosova dhe Diaspora	32 / 32.65%
5	Nr. ne % i doktorantëve qe vijne nga Ballkani	3 / 3.06%
6	Nr. ne % i doktorantëve qe vine nga vendet e Be-se	0
7	Nr. ne % i doktorantëve qe vine nga vendet e tjera te Botes	0

* Nga të cilët 17 kanë fituar të drejtën për të kaluar në vitin e dytë dhe 23 të tjerë presin provimin e radhës të formimit teorik (Comprehensive exam).

- Këshilli i Profesorëve dhe Koordinatorët e programit të studimit (Tab. 2)

Tabela 2

Emër Mbiemër	Titulli	Pozicioni (anëtar/ Kryetar)
Romeo Gurakuqi	Prof. Dr.	Kryetar
Adrian Civici	Prof. Dr.	Anëtar
Luljeta Minxhozi	Prof. Dr.	Anëtare
Ksenofon Krisafi	Prof. Dr.	Anëtar
Përparim Fuga	Prof. Dr.	Anëtar
Ferit Duka	Prof. Dr.	Anëtar
Engjëll Pere	Prof. Dr.	Anëtar
Kosta Barjaba	Prof. Dr.	Anëtar
Odeta Barbullushi	PhD	Koordinatore e Programit Shk. Sociale dhe te Edukimit
Arnisa Gorezi	PhD	Koordinatore e Programit Shkenca Juridike
Kreshnik Bello	Dr. (në proces për Prof. As.)	Koordinator i Programit Shkenca Ekonomike dhe TI

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardit/ kriterit
Standardi III.1 - Administrimi dhe mjetet për financimin e programit të studimeve të doktoratës	
Kriteri 1	<p>Njësia që organizon programin e studimeve të doktoratës i ka të akredituara dy ciklet e para të studimeve në fushën, në të cilën e ofron programin e studimit të doktoratës.</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës është akredituar institucionalisht shprehur në urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009. Po ky urdhër ka akredituar edhe programet e ciklit “Bachelor” dhe me urdhër Nr. 68 datë 14.02.2011, UET është akredituar për programet “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit në 3 (tre) departamentet e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; b. Departamenti Marrëdhënie Publike/Komunikim; c. Departamenti i Shkencave të Edukimit. <p><u>Shënim:</u> Ne këtë të fundit, duke qene departamenti më i ri i Fakultetit, jane akredituar tashmë 2 programe, dy të tjera kanë kaluar Vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm, një i fundit ka kaluar Vlerësimin e brendshëm dhe është në pritje të <i>Vlerësimit të Jashtëm</i>.</p>
Kriteri 2	<p>Njësia që organizon programin e studimeve të doktoratës ka në dispozicion mjedise administrative të mjaftueshme për të realizuar mirefunksionimin e tij.</p> <p>Infrastruktura specifike, operative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit të doktoratës në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit është e plotë duke përfshirë <i>Bibliotekën</i> e UET-it dhe <i>Librarinë</i>. Edhe mjediset e tjera pedagogjike e të shërbimeve të përfshira në këtë program studimi janë mëse të mjaftueshme. Ato garantojnë një mbarëvajtje cilësore të këtij programi doktorature.</p> <p>Meqenëse infrastruktura dhe mjediset administrative të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit janë njëkohësisht edhe ato të Universitetit Europian të Tiranës, ato</p>

<p>Kriteri 3</p>	<p>Per realizimin e programit te studimeve te doktorates, njesia qe propozon hapjen e tij angazhon personelin e nevojshem, duke filluar qe nga Sekretaria mesimore qe ndjek mbarevajtjen e programit mesimor te studimeve te ciklit te trete.</p>	<p>janë të shprehura më qartë në kriterin pasardhes të këtij <i>Raporti</i>.</p> <p>30. Personeli ndihmës-mësimor shkencor</p> <p>Personeli ndihmës mësimor-shkencor kryen veprimtari ndihmëse në mësimdhënie, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët dhe detyra administrative.</p> <p>30.1 Personeli ndihmës-mësimor shkencor ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.</p> <p>30.2 Personeli ndihmës-mësimor shkencor përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një <i>Komision Rekrutimi</i> ku marrin pjesë Prorektori, drejtuesit e njësive kryesore dhe/ose bazë të UET-it. Kandidaturat e përzgjedhura i propozohen Rektorit për miratim. Kandidatët e miratuar, në një fazë të mëvonshme, testohen për njohjen dhe përvetësimin e akteve rregulluese dhe procedurave të funksionimit të institucionit.</p> <p>30.3 Personeli ndihmës-mësimor shkencor i nënshtrohet vlerësimit periodik të kryer në fund të vitit akademik nga <i>Komisioni i Vlerësimit të Performancës</i>.</p> <p>31. Personeli administrativ</p> <p>31.1 Personeli administrativ kryen veprimtari administrative në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor në institucion, sipas detyrave të përcaktuara, si dhe shërbimeve për zhvillimin e UET-it. Ai ndihmon në realizimin e misionit të UET-it.</p> <p>31.2 Personeli administrativ ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme.</p> <p>31.3 Personeli administrativ përzgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga një <i>Komision Rekrutimi</i> ku marrin</p>
-------------------------	---	---

<p>Kriteri 4</p>	<p>Në <i>Rregulloren</i> e programit të studimeve të doktoratës përcaktohen organet përgjegjëse për drejtimin e tij.</p>	<p>pjesë Sekretari i Përgjithshëm si dhe personi nën varësinë e të cilit do të punojë kandidati i përzgjedhur. Kandidaturat e përzgjedhura i propozohen Rektorit për miratim.</p> <p>31.4 Personeli administrativ i nënshtrohet vlerësimit periodik, të kryer në fund të vitit akademik nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës.</p> <p>Në <i>Statutin</i> e UET-it (neni 21, pika 21.4) përcaktohet procedura e emërimit të <i>Koordinatorit të Programit të Doktoratës</i>, si një hallkë e drejtimit të Shkollës Doktorale. Ndërsa në <i>Rregulloren</i> “Per organizimin e programeve të studimit të doktoratures” (pika 5.3) specifikohen detyrat e tij.</p> <p>20.6 Drejtori i Shkollës Doktorale</p> <p>Drejton Këshillin Drejtues të Shkollës Doktorale. Ai emërohet nga Rektori me mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.</p> <p>20.7.1 Drejtori i Shkollës Doktorale ka titullin “Profesor”. Ai kryen këto detyra kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Garanton mbarëvajtjen e të gjithë proceseve akademike dhe administrative të Shkollës Doktorale; Përcakton periudhën kohore në dispozicion për regjistrimin e kandidatëve fitues; Firmos programet e lëndeve (silabuset); Informon me shkrim kandidatët në rast të mospranimit të dosjes së dorëzuar prej tyre për mbrojtjen e doktoratës; Garanton mbarëvajtjen e organizimit të programeve të doktoratës; Monitoron realizimin e veprimtarive akademike për ciklin e tretë të studimeve në përputhje me rregulloret përkatëse të UET dhe
-------------------------	--	---

<p>Kriteri 5</p>	<p>Këshilli i Profesorëve, që është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të studimeve të doktoratës ka një numër të mjaftueshëm anëtarësh që mbulojnë gjithë problematikën e tij. Numri minimal i profesorëve të KP-së duhet të jetë 7 (shtatë) veta. Këshilli i Profesorëve mund të ngrihet edhe në nivel të institucionit të arsimit të lartë, kur njësitë kryesore të tij nuk përmbushin numrin e nevojshëm të profesorëve me kohë të plotë.</p>	<p>cilësinë e zhvillimit të tyre;</p> <p>g) Miraton komisionin për vlerësimin e brendshëm të programeve të doktoratës.</p> <p>5. Organi përgjegjës për programet Në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë, të ndryshuar, në UET është ngritur dhe funksionon <i>Këshilli i Profesorëve</i>. Mbështetur në VKM Nr. 467, datë 18.07.2007, pika 1.5, <i>Këshilli i Profesorëve</i> përbëhet vetëm nga pedagogë me kohë të plotë që mbajnë titullin “Akademik”, “Profesor”, ose edhe titullin “Prof. Asoc.”, por që janë në procesin e aplikimit për titullin “Profesor”. Numri i profesorëve në përbërje të <i>Këshillit të Profesorëve</i> në UET është 8 (tetë). <i>Këshilli i Profesorëve</i> drejtohet nga një prej profesorëve, me rotacion, për një vit akademik. Organizimi dhe funksionimi i <i>Këshillit të Profesorëve</i> përcaktohet me <i>Rregulloren</i> përkatëse të UET-it.</p> <p>5.1 <i>Këshilli i Profesorëve</i> ngrihet në nivel institucioni dhe ka këto funksione kryesore:</p> <p>a) I propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale caktimin e kritereve të pranimit të kandidatëve;</p> <p>b) Miraton listën e kandidatëve fitues në programet e doktoratës;</p> <p>c) Ngre komisionet <i>ad hoc</i> që bëjnë vlerësimin e dosjeve të aplikanteve;</p> <p>d) Shqyrton ankimimet e aplikantëve jo fitues dhe shprehet me vendim, i cili është përfundimtar;</p> <p>e) Ngre komisionet e drejtuara nga koordinatori i programit të doktoratës për njohjen dhe transferimin e krediteve të fituara nga kandidatët e regjistruar, të cilët kanë përfunduar ose vijojnë një program studimi të ciklit të tretë;</p> <p>f) Miraton literaturën, mbi bazën e të cilës do të zhvillohet provimi për gjendjen teorike të disiplinës;</p> <p>g) Miraton temat e disertacionit dhe</p>
-------------------------	---	--

- udhëheqësit për çdo kandidat;
- h) Përcakton numrin e studentëve që mund të udhëheqë njëkohësisht një udhëheqës shkencor;
- i) Shqyrton dosjen e plotë të kandidatëve dhe i percjell Drejtorit të Shkollës Doktorale vendimin për vazhdimin ose jo të procedurës së mbrojtjes së doktoratës;
- j) I propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale jurinë për mbrojtjen e doktoratës;
- k) Shqyrton dhe miraton hapjen, mbylljen ose riorganizimin programeve të studimit të doktoratës, përpara përcjelljes për miratim në Senatin Akademik;
- l) Shqyrton raportin e vleresimit të brendshëm të programeve të studimit të doktoratës.

Sipas *Statutit* të Universitetit jopublik “Universiteti European i Tiranës”, *Këshilli i Profesorëve* drejton studimet e Doktoratës dhe të kualifikimit shkencor të personelit akademik në UET, që kërkon të kualifikohet me synim fitimin e titujve akademikë pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”. Pas shqyrtimit të kërkesave, *Këshilli i Profesorëve* përcjell propozimet në institucionet përkatëse të Arsimit të Lartë, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave për dhënien e titujve akademikë respektivë.

Këshilli i Profesorëve, ne perputhje me legjislacionin në fuqi, është përgjegjës për vendimmarrjen akademike në funksion të drejtimit dhe organizimit të studimeve doktorale, realizimin e marrëveshjeve për zhvillimin e doktoratave të ndryshme të UET-it në bashkëpunim edhe me Universitete të tjera vendase apo të huaja, të cilat organizojnë studime doktorale.

Këshilli i Profesorëve shërben edhe si organ këshillimor për strategjitë e zhvillimit dhe të programimit të aktivitetit shkencor të UET-it si edhe

<p>Kriteri 6</p>	<p>Këshilli i Profesorëve të njësisë kryesore që organizon dhe menaxhon programin e studimeve të doktoratës mbledhet periodikisht gjatë vitit.</p>	<p>për vlerësimin e aktiviteteve kërkimore-shkencore.</p> <p><i>KP</i> mbledhet në kohën më të shkurtër të mundshme, çdo herë që në përputhje me legjislacionin në fuqi kërkohet angazhimi i tij. Mbledhjet e <i>KP</i> thirren, organizohen dhe drejtohen nga kryetari. Thirrja e mbledhjes së <i>KP</i> mund të bëhet edhe me kërkesë të një të tretës së anëtarëve të tij. Mbledhja e <i>KP</i> realizohet atëherë kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij dhe merr vendime me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, në bashkërendim të vendimarrjes me Administratorin e UET-it. UET-i po ngre kapacitetet e brendshme që do të mundesojnë ngritjen e <i>Këshillit të Profesorëve</i> në rang Fakulteti.</p>
-------------------------	--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Pas vlerësimit të kriterëve, konstatohet se Standardi III.1 është përmbushur, në përputhje si me legjislacionin dhe rregullat në fuqi, ashtu dhe kundrejt *Statutit* dhe *Rregullores* së UET-it:

- Mjediset administrative, personeli i nevojshëm administrativ dhe ndihmës si dhe organet përgjegjëse, së bashku me *Këshillin e Profesorëve*, garantojnë mbarëvajtjen e studimit në këtë Program;
- Numri i profesorëve në përbërje të *Këshillit të Profesorëve* në UET është 8 (tetë) anëtarë. *Këshilli i Profesorëve* ngrihet në nivel universiteti në UET;
- Po bëhen përpjekje që, me sigurimin e numrit të nevojshëm të pedagogëve me titullin “Profesor”, ai të shtrihet në të ardhmen e afert edhe në rrafsh Fakulteti.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- *Vendimet* e akreditimeve të mëparshme
- *Rregullorja* e Programit të studimit
- *Vendimi* i emërimit të Koordinatorëve dhe stafit administrativ të Shkollës Doktorale
- *Rregullorja* e brendshme e *Këshillit të Profesorëve*
- VKM nr. 467, datë 18.07.2007, pika 1.5

3. Personeli akademik dhe mbështetës

Pjesa përshkrimore

Të dhëna për kualifikimin e personelit akademik të Doktoratës

Personeli akademik që angazhohet në Shkollën Doktorale është ndër më të kualifikuarit në rrafsh Fakulteti. Duke u nisur prej fushave të tyre të ekspertizës, si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkimin shkencor dhe aktivitetin botues (sikurse dëshmohet edhe prej CV-ve të tyre), garantohet plotësisht realizimi me cilësi i programit të kësaj doktorature në të pesë profilet e saj, si për te gjitha lëndët teorike e metodologjike të propozuara në programin e saj, ashtu edhe përsa i përket cilësisë së udhëheqjes shkencore të doktorantëve.

Raporti PAE/PAK

Në realizimin e Programit të Studimit të doktoraturës, një vend të rëndësishëm zë edhe raporti PAE/PAK. Aktualisht, në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit japin mësim dhe udhëheqin 16 pedagogë efektivë, 12 pedagogë të jashtëm (drejtorë shkollash jo publike dhe në profesion të lirë- për programin e Edukimit) dhe 3 pedagogë të huaj me kontratë (nga universiteti i Astonit në Britaninë e Madhe), duke pasur një raport 103 %.

Personeli akademik/Personeli administrativ/studentët

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit në UET përfshin në vitin e parë të këtij programi doktorature 28 pedagogë e kërkues, nga të cilët 13 të brendshëm, 11 të jashtëm dhe 4 të huaj. Ndërsa numri i udhëheqësve shkencorë të përfshirë në drejtimin e doktorantëve është 32, nga te cilët: personel akademik i brendshëm 16 dhe personel akademik i jashtëm 16.

Në Universitetin Europian të Tiranës, kandidatët në Programin e studimit të doktoraturës po ndjekin (të regjistruar) programin e studimit në Shkencat Sociale dhe të Edukimit prej 2 viteve akademike (2011-2012 dhe 2012-2013). Numri i kandidateve të regjistruar në programin e studimit të doktoraturës për vitin e parë është 94.

Shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik

Ngarkesa e pedagogëve që bëjnë pjesë në Shkollën Doktorale, për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit përbëhet prej dy komponentësh: a) ngarkesa në mësimdhënie; b) ngarkesa për udhëheqjen e temave të diplomave.

Personeli efektiv dhe joefektiv i angazhuar në programet e ciklit të tretë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur më UET-in. Si rregull, pedagogët efektivë me grada dhe tituj sipas kërkesave, duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe të tretë. Një orë fizike në auditor llogaritet 1.5 orë-njësi për efekt ngarkese.

Shefi i Departamentit përkates (sipas profileve të Programit të studimit të Shkollës Doktorale) është personi përgjegjës që përcakton ngarkesën mësimore të stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie pranë Shkollës Doktorale. Ndërsa, përsa i përket udhëheqjes së temave të doktoraturës, si për stafin efektiv ashtu edhe për atë joefektiv, ngarkesa realizohet sipas akteve në fuqi (nr. i studentëve që mund të udhëhiqen është i përcaktuar) dhe kontratës së lidhur me UET-in.

Koordinatori i Shkolles Doktorale është personi përgjegjës për caktimin e ngarkesës të stafit akademik të angazhuar në udhëheqje pranë Shkolles Doktorale.

Kriteret e rekrutimit të personelit akademik jo efektiv

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të veçantë. Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidatëve janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

- Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar;
- Të ketë së paku gradë shkencore PhD si dhe titujt *Akademik, Profesor, Profesor i Asociuar*;
- Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve përëndimore;
- Rezultatet personale të kandidatit;
- Aktiviteti kërkimor dhe botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencorë të UET-it;
- Aftësitë komunikuese dhe etike;
- Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike dhe shkencore;
- Përvoja e punësimit;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre.

Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në *Kontratën* e lidhur mes tij dhe UET-it, bazuar në *Kodin e Punës*, në *Statutin* e UET-it, në *Rregulloren* e Shkolles Doktorale, në *Kodin e Etikës* dhe në *Kodin e Integritetit Akademik*, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it.

Perzgjedhja e kandidatëve bëhet prej një Komisioni të përbërë prej Drejtorit të Shkollës Doktorale, Dekanit të Fakultetit dhe Koordinatorit të Programit të Studimit, të cilët mbështeten në gjykimin e tyre mbi kriteret e mësipërme.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ (Tab. 3)

Tabela 3

Institucioni/Njësia Bazë/Shkolla e Doktoratës/ Shkenca Ekonomike							
Personeli Akademik Efektiv		Detyra në UET	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë		Institucioni ku punon full time	
(Emër Mbiemër)				(Emër Mbiemër)			
1	Adrian Civici	President, Drejtor i Shkollës Doktorale	Prof. Dr.	1	Vjollca Karapici	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës
2	Luljeta Minxhozi	Zv. Rektore/ Dekane e Fakultetit Ekonomik	Prof. Dr.	2	Flutura Kalemi	Prof. Dr.	Universiteti Bujqësor i Tiranës
3	Engjell Pere	Përgjegjës Departamenti	Prof. Dr.	3	Lindita Milo (Lati)	Prof. Dr.	Autoriteti i Konkurrencës
4	Magdalena Bregasi	Udheheqese Doktoratash	Prof. Asoc.	4	Drini Salko	Prof. Dr.	Universiteti Bujqësor i Tiranës
5	Hysen Binjaku	Udheheqes Doktoratash	Prof. Asoc.	5	Donika Kerçini	Prof. Dr.	Universiteti Bujqësor i Tiranës
6	Nevila Xhindi	Zv. Rektore për Partneritetet dhe Marrëdh. me J.	Prof. Asoc.	6	Shyqyri Llaci	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë

7	Tamara Luarasi	Udheheqese Doktoratash, Lektor	Prof. Asoc.	7	Ilia Kristo	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
8	Arjan Kadareja	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	8	Arben Verçuni	Prof. Dr.	Universiteti Bujqësor i Tiranës
9	Mimoza Durresi	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	9	Sulo Haderi	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
10	Anilda Bozdo	Udheheqes Doktoratash	Dr.	10	Arjan Durresi	Prof. Dr.	Indiana University, SHBA
11	Arben Bakllamaja	Udheheqes Doktoratash, Lektor	Dr.	11	Fatos Ibrahim	Prof. Asoc.	Banka e Shqipërisë, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës
12	Edlira Gjura	Udheheqes Doktoratash	Dr.	12	Arben Malaj	Prof. Asoc.	Kuvendi i Shqipërisë
13	Elvin Meka	Zv. Dekan/Përgjegjës Departamenti	Dr.	13	Drita Kruja	Prof. Asoc.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
14	Ermira Qosja	Udheheqes Doktoratash	Dr.	14	Holger Kachelein	PhD	DAAD (German Academic Exchange Service)
15	Oltjana Zoto	Udheheqes Doktoratash	Dr.	15	Bruno Sergi	Prof. Dr.	University of Messina, Italy
16	Indrit Baholli	Përgjegjës Departamenti	Dr.	16	Franco Sotte	Prof. Dr.	Università Politecnica delle Marche ad Ancona, Itali
17	Kreshnik Bello	Koordinator i Programit	Dr.	17	Selami Xhepa	Dr.	Kuvendi i Shqipërisë
18	Petraç Papajorgji	Udheheqes Doktoratash, Lektor (aktualisht larguar nga UET)	Prof. Dr.	18	Etleva Leskaj	Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë
19	Aranit Shkurti	Udheheqes Doktoratash, Lektor (aktualisht larguar nga UET)	PhD	19	Arjan Qefalia	Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë

Institucioni/Njësia Bazë/Shkolla e Doktoratës/ Shkenca Sociale

Personeli Akademik Efektiv		Detyra në UET	Titulli/Grada	Personeli Akademik me Kontratë		Institucioni ku punon full time	
(Emër Mbiemër)				(Emër Mbiemër)			
1	Perparim Fuga	Prorektor	Prof. Dr.	1	Blerim Reka	Prof. Dr.	Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni
2	Kosta Barjaba	Pedagog	Prof. Dr.	2	Edmond Dragoti	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
3	Aleksandër Dhima	Zv. Drejtor i Shkollës Doktorale	Prof. Asoc.	3	Ladi Shahini	Prof. Dr.	në pension
4	Çapajev Gjokuta	Udheheqes Doktoratash, Lektor	Prof. Asoc	4	Erleta Mato	Prof. Dr.	Universiteti Planetar i Tiranës
5	Tonin Gjura	Rektor	Prof. Asoc.	5	Milika Dhamo	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

6	Valjer Peshkepia	Udheheqes Doktoratash, Lektor	Prof. Assoc.	6	Ylli Pango	Prof. Dr.	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Informacionit
7	Enika Abazi	Udheheqes Doktoratash, Lektor	Prof. Assoc.	7	Theodhori Karaj	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
8	Fatos Tarifa	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	8	Bujar Kapexhiu	Prof. Dr.	në pension
9	Klejd Kelliçi	Përgjegjës Departamenti	PhD	9	Zenel Orhani	Prof. Assoc.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale
10	Odeta Barbullushi	Zv. Rektore për Kërkimin Shkencor	PhD	10	Jetmir Aliçka	Prof. Assoc	Shkolla Private "Faik Konica"
11	Edi Puka	Udheheqes Doktoratash	PhD	11	Petrit Nathanaili	Prof. Assoc	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Histori - Filologjisë & Instituti i Studimeve Europiane
12	Erika Melonashi	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	12	Petrit Muka	Prof. Assoc.	në pension
13	Henri Çili	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	13	Jelena Obradovic	PhD	Aston University
14	Gilman Bakalli	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	14	Annalisa Dodds	PhD	Aston University
15	Tomi Treska	Dekan i F. të Shkencave Sociale dhe Edukimit	Dr.	15	Nicola Corkin	PhD	Aston University
16	Artur Jaupaj	Përgjegjës Departamenti (aktualisht larguar nga UET)	PhD	16	Mark Marku	PhD	Kuvendi i Shqipërisë

Institucioni/Njësia Bazë/Shkolla e Doktoratës/ Shkenca Juridike

<i>Personeli Akademik Efektiv</i>		<i>Detyra në UET</i>	<i>Titulli/Grada</i>	<i>Personeli Akademik me Kontratë</i>		<i>Titulli/Grada</i>	<i>Institucioni ku punon full time</i>
(Emër Mbiemër)				(Emër Mbiemër)			
1	Ferit Duka	Udheheqes Doktoratash, Lektor	Prof. Dr.	1	Skënder Kaçupi	Prof. Dr.	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë
2	Ksenofon Krisafi	Udheheqes Doktoratash, Lektor	Prof. Dr.	2	Blerim Reka	Prof. Dr.	Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, Maqedoni
3	Romeo Gurakuqi	Kryetar i Këshillit të Profesorëve	Prof. Dr.	3	Shefqet Muçi	Prof. Dr.	Shkolla e Larte Universitare "Wisdom University", Tiranë
4	Migena Leskoviku	Zv. Dekane /Përgjegjëse departamenti	Prof. Assoc.	4	Xhezair Zaganjori	Prof. Dr.	Gjykata Kushtetuese
5	Darjel Sina	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	5	Vasilika Hysi	Prof. Dr.	Kuvendi i Shqipërisë
6	Erjona Canaj	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	6	Marjana Semini	Prof. Dr.	Shkolla e Magjistraturës

7	Juelda Lamçe	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	7	Kestrin Katro	Prof. Asoc.	Universiteti i Tiranës
8	Arjan Vasjari	Udheheqes Doktoratash, Lektor	PhD	8	Irakli Koçollari	Dr. (Prof. Asoc. ne proces)	Universiteti Luarasi
9	Arnisa Gorezi	Koordinatorë e programit	PhD	9	Altin Shegani	PhD	Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik
10	Çlirim Gjata	Dekan i Fakultetit Juridik	Dr.	10	Genta Tafa (Bungo)	Dr.	Studio përmbaremore "Debit Collection"
				11	Lulzim Tafa	Dr.	Universiteti AAB, Kosovë

Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre për të tre Fakultetet (Tab. 4)

Tabela 4

Titulli	PAE	PAK		Raporti
		Vendas	Te huaj	PAE/PAK
Profesorë	9	22	3	9:25
Profesorë të Asociuar	10	8	0	10:8
Doktorë (PhD) mbaruar në Universitetet Europiane	16	2	4	16:6
Dr.	10	5	1	10:6
Personeli Administrativ	33			

Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit (Tab. 4a)

Tabela 4a

Titulli	PAE	PAK		Raporti
		Vendas	Te huaj	PAE/PAK
Profesorë	1	5		1:5
Profesorë të Asociuar	4	6		4:6
Doktorë (PhD) mbaruar në Universitetet Europiane	8	3	3	8:7
Personeli Administrativ	10			10:0

Të dhëna sipas moshës për të tre Fakultetet (Tab. 5)

Tabela 5

Personeli sipas titujve / gradave	Numri sipas moshës							
	(36-45)		(46-55)		(56-65)		(66-68)	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesorë	0	0	4	9	3	13	2	3
Profesorë të Asociuar	2	2	3	1	5	4	0	1
Doktorë (PhD mbaruar në Universitetet Europiane)	11	5	4	1	1	0	0	0

Dr.	5	4	3	1	2	1	0	0
Personeli Administrativ	25	0	5	0	3	0	0	0

- Të dhëna sipas moshës për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit (Tab. 5a)

Tabela 5a

Personeli sipas titujve / gradave	Numri sipas moshës							
	(22-36)		(37-45)		(46-55)		(56-68)	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesorë					1	4		1
As. Profesorë të Asociuar					1	2	3	4
Doktorë (PhD) mbaruar në Universitetet Europiane			5	3	1	3	2	1
Personel Administrativ	7		2				1	

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat (shih Aneksin VI)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi I.1 - Kuadri i përgjithshëm		
Kriteri 6	Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këtë program përbën një garanci për realizimin e programit (60% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, i angazhuar në kërkim dhe me tituj akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PhD” të fituar në universitete të njohura në botë për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse).	Plotësohet (shih tab. 3-4)
Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor		
Kriteri 2	Institucioni që ofron programe studimi të ciklit të tretë (doktoratë), ka personel të mjaftueshëm, akademik me tituj e grada shkencore.	Po (shih tab. 5)
Kriteri 3	Institucioni ka struktura administrative dhe kërkimore, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit për kryerjen e kërkimeve. Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një a më shumë institucione të tjera, në bazë marrëveshesh midis tyre.	Njësitë bazë 15.1 Njësi bazë janë departamentet dhe qendrat e kërkimit dhe të zhvillimit. 15.2 Departamenti është njësi bazë mësimore–kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene dhe grupon disiplinat mësimore respektive. 15.3 Departamenti nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e

mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik.

15.4 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me grada dhe tituj.

15.5 Departamenti mund të organizohet në **grupe mësimore-kërkimore**. Këto organizime kanë të drejtë të kenë edhe karakter të përkohëshëm. Titullarët e grupeve emërohen nga autoriteti i njësisë kryesore për një periudhë 4 vjeçare ose për periudhën që përputhet me kohëzgjatjen e funksionimit të grupit. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të departamentit si dhe detyra të tjera të tij përcaktohen në përputhje me Ligjin mbi Arsimin e Lartë si dhe rregulloren bazë të institucionit.

15.3 **Qendrat e kërkimit dhe zhvillimit** kryejnë veprimtari kërkimore shkencore dhe zhvillimi, si dhe marrin pjesë në zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, duke u harmonizuar në veprimtarinë e tyre edhe me departamentet përkatëse sipas fushave të kërkimit.

15.3.1 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të qendrave kërkimore si dhe detyra të tjera të tyre përcaktohen në *Rregulloren e institucionit*.

Njësitë ndihmëse mësimore

16.1 Njësi ndihmëse konsiderohen laboratorët, njësitë didaktike, bibliotekat dhe njësi të tjera që shërbejnë për të realizuar studime dhe shërbime në kuadër të zhvillimit të procesit akademik dhe të kërkimit shkencor.

Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit të doktoratës

4.1 Propozimi për hapjen dhe

	<p>mbylljen e programeve të studimit të doktoratës mund të formulohen nga njesite baze apo çdo grup mësimesor kërkimesor i njësive kryesore, Këshillat e Fakulteteve dhe Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale. Propozimi formulohet sipas kërkesave dhe formularëve të parashikuara nga Udhëzimi nr. 5, dt. 22.01.2008 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, i ndryshuar.</p> <p>Propozimi i paraqitet për miratim Këshillit të Profesoreve</p> <p>4.2 Hapja e programeve të Doktoratës bëhet e mundur nëse institucioni plotëson kushtet e mëposhtme:</p> <p>4.2.1 Ka personel akademik me titull "Profesor", "Profesor i Asociuar" ose me gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete përëndimore dhe që ka, së paku, dy vjet përvojë mesimore-kërkimore pas doktoratës;</p> <p>4.2.2 Ka numrin e nevojshëm të personelit akademik për të udhëhequr çdo student të doktoratës në veprimtaritë e kërkimit dhe në kryerjen e detyrave përkatëse didaktike;</p> <p>4.2.3 Ka struktura të posaçme operative dhe kërkimore për veprimtaritë e parashikuara nga programi i studimit të doktoratës (biblioteka, studime etj);</p> <p>4.2.4 Ka burime financiare mbështetëse;</p> <p>4.2.5 Bashkepunon me</p>
--	---

universitete të huaja
apo me subjekte
publike dhe private të
kërkimit që garantojnë
programe të
shkëmbimit të personelit
akademik dhe të
studentëve të
doktoratës;

4.2.6 Ka percaktuar
mënyrat e verifikimit
te veprimtarisë
kërkimore apo
krijuese të
studentëve të
doktoratës,
vecanërisht
lidhur me përgatitjen
e tezes së doktoratës.

**Marrëveshje me
universitete dhe ente
të huaja**

Programet e doktoratës
hartohen nga Universiteti
Europian i Tiranës në
bashkëpunim me
universitete të tjera sipas
marrëveshjeve të veçanta.

Bashkëpunimi për programet e
doktoratës përqendrohet në këto
çështje:

- a. Shkëmbim i studentëve
dhe personelit akademik;
- b. Përfaqësimi i universitetit
bashkëpunues në Keshillin
Drejtues të Shkollës Doktorale;
- c. Bashkëpunim për seksionin
metodologjik;
- d. Bashkëpunim në fusha
studimi të përbashkëta;
- e. Aktivitete të përbashkëta në
fushën e kërkimit shkencor.
- f. UET-i ka të drejtë të
nënshkruajë marrëveshje
bashkëpunimi me
universitete të tjera, me
ente publike apo private, të
cilat kanë rekuizite të një
kualifikimi të lartë kulturor
dhe shkencor personal si
dhe të strukturave dhe

mjeteve te përshtatshme dhe që angazhohen në dhënien e ndihmës dhe mbështetjes së nevojshme për të krijuar kushte të përshtatshme kërkimi për studentët e pranuar në programet e doktoratës në UET.

Studentët e doktoratës kanë të drejtën dhe detyrimin të shpenzojnë të paktën 3 muaj nga periudha e tyre kërkimore në institucione të tjera kërkimore, me të cilat UET-i ka marrëveshje bashkëpunimi.

Modalitetet e qëndrimit dhe kryerjes së aktiviteteve kërkimore në këto universitete dhe ente përcaktohen në marrëveshja e lidhur me: *Aston University, Britani e Madhe, parashikon:*

- Ndjekjen e kurseve që lidhen me punimin e disertacionit;
- Shfrytëzimin e bibliotekave për kërkim shkencor;
- Takim me profesorë të huaj;
- Pjesëmarrje në aktivitete shkencore të organizuara nga universiteti pritës.

2.1 Formimi i “Doktorit të Shkencave” kërkon që një pjesë e krediteve të zhvillohet nën drejtimin e profesoreve të huaj, në UET ose në Universitetin e Astonit, si dhe kryerjen e punës kërkimore në universitete ose institute kërkimore të tjera jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (tre) mujore dhe jo më të gjatë se sa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës.

2.4 Universiteti European i Tiranës i ofron programet e doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Astonit. Me vullnetin e lire të palëve, këto programe mund të

organizohen në te ardhmen si programe të përbashkëta, duke pasur parasysh sa me poshte:

2.4.1 Programi i studimit të doktoratës dhe përgatitja e tezes së saj kryhen me periudha te alternuara në secilin universitet;

2.4.2 Fusha e kërkimit të jetë e përafert;

2.4.3 Caktimin e dy udhëheqësve, nga një për secilen njësi kryesore për studentët që zhvillojnë programe të tilla. Vlerësimi pozitiv i të dy udhëheqësve është kusht për të kaluar në mbrojtjen e tezes së doktoratës;

2.4.4 Caktimin e gjuhës, në të cilën do të hartohet dhe paraqitet teza e doktoraturës apo pjesë të saj, përcaktohen në *Marrëveshjen* midis dy universiteteve;

2.4.5 Anëtarët e jurisë për mbrojtjen e tezes caktohen me vendim të drejtuesve të secilit universitet në numër të barabartë.

3. Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës

a. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 anëtarë (3 anëtarë të stafit akademik të Fakultetit dhe 2 anëtarë të jashtëm, nga të cilët një anëtar i personelit akademik nga universiteti ose institucioni jashtë vendit, që ka qenë përgjegjës për ndjekjen e punës studimore të kandidatit gjatë periudhës së formimit dhe kërkimit) si dhe nga një

		<p>anëtar nga universitetet bashkëpunuese.</p> <p>b. Antaret e jurisë duhet të kenë të paktën gradën shkencore "Doktor", të fituar në universitete perendimore dhe, më së paku, dy vjet përvojë në aktivitete mësimore-kërkimore pasdoktorale si dhe të kenë veprimtari kërkimore e botuese të pasur, brenda dhe jashtë vendit, në fushën përkatëse të studimevë në të cilat ofrohet programi i studimevë të doktoratës.</p> <p>c. Njëri nga anëtarët e jurisë është kryetar, ndërsa dy anëtarë të tjerë janë oponentë. Një nga oponentët duhet të jetë nga jashtë institucionit.</p> <p>d. Nuk emërohen oponentë individët, që kanë pasur një përfshirje thelbësore në punën e studentit të doktoratës, ose puna e të cilëve është vetë fokusi i projektit të kërkimit.</p> <p>ë. Këshilli i Profësorëvë i propozon Drejtorit të Shkollës Doktorale juridike për mbrojtjen e doktoratës.</p> <p>f. Vëndimin për miratimin e jurisë e merr Drejtori i Shkollës Doktorale.</p> <p>g. Mbrojtja e doktoratës bëhet me pjesëmarrjen e plotë të jurisë, jo më parë se një muaj nga data e miratimit të saj.</p> <p>h. Kur për arsye të përlegjura njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, Drejtori i Shkolles Doktorale vë në dijeni Këshillin e Profësorëvë, duke i propozuar sipas rastit një</p>
--	--	--

		<p>datë tjetër për mbrojtje, ose zëvendësimin e anëtarit të jurisë.</p> <p>Pas miratimit paraprak nga Këshilli i Profesorëve, Drejtori i Shkollës Doktorale merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës ose zëvendësimin e anëtarit të jurisë.</p>
--	--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Standarti I.1 është përmbushur në një masë mjaft të madhe, konform kërkesave për një personel me titujt e nevojshëm për të drejtuar doktoratura, duke pasur parasysh edhe numrin e studentëve që kanë fituar të drejtën për të vazhduar studimet në vitin e dytë.

- Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këtë program përbën një garanci për realizimin e programit.

Standarti II.1 është përmbushur konform kërkesave në lidhje me personel, struktura administrative dhe kërkimore të mjaftueshme si dhe në sajë të mundësisë së organizimit të programeve të përbashkëta me institucione të tjera.

- Institucioni që ofron programe studimi të ciklit të tretë (doktoratë) ka personel të mjaftueshëm akademik me titujt e grada shkencore (31 PAE);
- Institucioni ka struktura administrative dhe kërkimore, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit për kryerjen e kërkimeve;
- Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimit të doktoratës me një a më shumë institucione të tjera, në bazë marrëveshesh midis tyre.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- *Marrëveshje kontraktuale me universitete të huaja*
- *Kontrata të UET-it me pedagogët e huaj (bashkëngjitur CV-të e tyre)*
- *Rregullorja e Programit përkatës të studimit*
- *Kodi i Etikës dhe i Integritetit Akademik.*

4. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të Doktoratës

Pjesa përshkrimore:

Mjediset dhe Infrastruktura

Universiteti European i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10,000 m². Përreth godinave, ndodhet një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina.

Objekti është i pajisur me dy palë shkallë, nga të cilat, në rast emergjence në njërin krah të godinës, mundet të përdoret shkalla tjetër. Gjithashtu, godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si vijon: një shuarse zjarri në çdo kat, dhe nga një shuarse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 12 copë, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatesisht rrufepritëse.

Institucioni ka të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike që përbëhet nga motogjenerator, si edhe ka të garantuar rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, të cilat realizohen nga rrjeti publik i ujit të pijshëm si dhe pus uji rezervë dhe sistem pompimi përkatës.

Mjediset janë të kompletuara me sistemin e ngrohjes të tipit *Fancoil*, me komandim qëndror. Ky sistem funksionon pa ndërprerje dhe janë çertifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese.

UET ka aktualisht në përdorim 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare), të gjitha të pajisura me mjete audio-vizive si *PC*, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Njëkohësisht edhe biblioteka është e paisur me *PC*, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat *on line* të vëna në dispozicion nga UET. Mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë *web-in*. Paisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.

Të gjithë laboratorët janë të paisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i paisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë, programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore, duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore.

Biblioteka

Një nga synimet dhe detyrat kryesore të Bibliotekës është pasurimi i fondit të saj. Pasurimi i fondit të bibliotekës është bërë dhe vazhdon të bëhet përmes këtyre rrugëve:

(a) Blerja në fillim të cdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkollore si tekste bazë ose si literaturë e rekomanduar;

(b) Blerja në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të cdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor në të trija fakultetet e UET-it;

(c) Përkthimi dhe botimi nga *UET Press* i shumë teksteve universitare dhe monografive shkencore që kanë për autorë pedagogë të UET-it, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë. Këtu bëjnë pjesë disa prej botimeve më të mira dhe më të fundit të Universitetit të Oksfordit si dhe kolëksionet e plota të të gjitha

revistave shkencore që botohen nga ky universitet, midis të cilave edhe revistat e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit si *Polis*, *Sociological Analysis* dhe *Educatio*;

(d) Porosive dhe blerja online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet më së miri ekspertiza e UET-it (vëtem për 3 mujorin e parë të vitit 2013 janë shpënuar 1,300.00 \$);

(ë) Të dhuruara nga organizata dhe shoqata të ndryshme, ambasada të huaja dhe individë të ndryshëm.

Tregues të matshëm:

Mjediset e fakultetit (Tab. 6, 6a)

Tabela 6

<i>Mjediset dhe fasilitete për programin e Doktoratës</i>	<i>Sasia</i>	<i>Sipërfaqja</i>
Salla për leksione	9	1160 m ² (1.215 vende)
Klasa për seminare	24	1200 m ² (840 vende)
Salla për aktivitete promovuese	2	180 m ² (150 vende)
Laboratorë informatike	3	140 m ² (110 vende)
Salla interneti	1	160 m ² (80 vende)
Salla për bibliotekë	1	300 m ²
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	150 m ²
Biblioteka <i>online</i>	1	-
Zyrë informacioni për studentët	1	150 m ²
Numër botimesh, titujsh	2	"Polis"; "Educatio"
Korridore/holle	8+2	-
Mjedise sportive	-	-
Mjedise shërbimi për të tretë	-	-
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	500 m ²
Nyje hidrosanitare për studentët	40	250 m ²
Norma m²/për student	4.6 m ² /student	

Tabela 6 a

<i>Mjediset për stafin:</i>	<i>Sasia</i>	<i>Sipërfaqja</i>
Zyra për Drejtorin/ zv Drejtorin/ Koordinatorët	4	240 m ²
Zyra për sekretarinë mësimore	1	30 m ²
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	9	360 m ²
Zyra për personelin akademik	25	400 m ²
Zyrë për financën	2	60 m ²
Zyrë për Njësinë e SBC	1	30 m ²
Salla për mbledhje	3	180 m ²
Mjedis për stafin e shërbimit	4	150 m ²
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	8	55 m ²
Norma m²/për person	18.8 m ² /person	

Dokumentacioni përkatës (planimetritë, të dhëna për teknologjinë e pajisjeve kërkimore (shih Aneksët IX dhe X).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.2 - Baza didaktike dhe mbështetja teknike	
Kriteri 1	<p>Studentet e pranuar ne programin e studimit te ciklit te trete kane kushtet e nevojshme per te realizuar programin e studimit me karakter akademik dhe kerkimor.</p>
	<p>Njësitë ndihmëse mësimore dhe administrative</p> <p>6.1 <i>Njësitë ndihmëse mësimore</i> janë:</p> <p>1 <i>Biblioteka</i> bën ruajtjen, përdorimin, pasurimin, shpërndarjen dhe huazimin e pasurisë bibliografike të UET-it. Organizimi dhe funksionimi i <i>Bibliotekës</i>, i sistemit bibliotekar dhe i administrimit të pasurisë bibliografike në UET disiplinohen me rregullore të veçantë.</p> <p>2 <i>Laboratori i Informatikës</i> dhe laboratorë të tjerë.</p> <p>2.1 <i>Laboratori i Informatikës</i> ofron shërbimin e internetit në kuadër të kërkimit dhe të shfrytëzimit të artikujve dhe të botimeve të tjera <i>on-line</i>. Kompjuterët në dispozicion mund të shfrytëzohen nga studentët për të punuar esetë dhe detyrat e tjera për lëndët që ndjekin. Laboratori ofron edhe shërbimin e printimit. Funksionimi i Laboratorit disiplinohet me rregullore të veçantë.</p> <p>3. <i>Studio komunikimi/Media UET</i>.</p> <p>4 <i>Libraria</i>. Libraria Universitare e UET-it tregton pasurinë bibliografike akademike dhe atë të mësimdhënies, e vënë në qarkullim për shitje në përputhje me legjislacionin në fuqi. Funksionimi i <i>Librarisë</i> rregullohet me rregullore të veçantë.</p> <p>5 <i>UET Press</i>. UET Press-i është përgjegjës për botimet e teksteve të aprovuar sipas procedurave përkatëse, si dhe angazhohet për publikimin e revistave shkencore të UET-it në bashkëpunim me njësitë e tjera të UET-it, që ngarkohen me përgjegjësi për botimin e tyre.</p> <p>6 <i>UET Sondazhe</i></p> <p>a) Njësi që ka për funksion të kryejë sondazhe për matjen, analizën dhe interpretimin e te dhenave.</p>

<p>Kriteri 2</p>	<p>Programi i studimeve te doktoratures siguron harmonizim te synimeve te studentit ne fushen kerkimore-shkencore, projekteve kerkimore te miratuara dhe, ne perfundim te tij, edhe te mundesise per karriere akademike dhe punesim.</p>	<p>7. <i>UET Imazhe</i> Është një fond imazhesh, fotografish, videosh, animimesh, dokumentarësh, filmash, etj, në shërbim të procesit mësimor, të kërkimit shkencor dhe të tretëve.</p> <p>8. <i>Zyra e Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim</i> Mbështet dhe koordinon në shkallë institucioni aktivitetet e lidhura me projektet e kërkimit shkencor; iu ofron njësisve të tjera të Universitetit informacionin dhe asistencën e nevojshme për hartimin, për ndjekjen dhe për realizimin e projekteve në funksion të procesit mësimor e të kërkimit shkencor, si dhe mban kontaktet e nevojshme me donatorët brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>9. <i>Qendra e Teknologjisë së Informacionit (Zyra e IT-së)</i> Është përgjegjëse për funksionimin dhe përditësimin e <i>UMIS-it</i>; për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e sistemeve <i>IT</i> në procesin mësimor, kërkimin shkencor dhe për administrimin e <i>UET-it</i>. Gjithashtu mbështet kualifikimin e personelit akademik dhe administrativ në fushën e përdorimit të teknologjive të informacionit. Mbështet përditësimin e faqes <i>web</i> dhe të prodhimit të materialeve grafike për mbështetjen e aktiviteteve të <i>UET-it</i>.</p> <p>Tipologjia e aktiviteteve formuese te programit te studimit</p> <p>10.1 Kreditet teorike: Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoraturës studenti duhet të ndjekë lëndët e parashikuara në programin përkatës, sipas planit mësimor të miratuar, për të grumbulluar 50 kredite, një pjesë e të cilave merren përmes kurseve të zhvilluara nën drejtimin e personelit akademik të huaj, në <i>UET</i> ose në <i>Aston University</i>. Studenti i cili ka përfunduar ose vijon studimet në një program studimi të ciklit të tretë mund të transferojë kreditet e fituara në programin e doktoraturës, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 7.8 të kësaj</p>
-------------------------	--	--

<p>Kriteri 3</p>	<p>Programi i studimit të ciklit tretë ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p>	<p><i>Rregulloreje.</i></p> <p>10.2 Provimi për gjëndjen tëorike të disiplinës. Në fund të vitit të parë studenti i nënshtrohet një provimi që përbën themelin e formimit të tij teorik dhe ka peshën e 10 krediteve. Nënshtrimi ndaj këtij provimi është detyrim për cilëndo kategori studentësh të regjistruar në programet e doktoratës. Provimi për gjëndjen tëorike të disiplinës jepet mbi bazën e një liste librash të hartuar nga</p> <p>10.3 Këshilli Drejtues i Shkollës Doktorale, dhe të miratuar nga Këshilli i Profësorëve. Vlerësimi i kandidatëve bëhet nga një Komision i përbërë nga 5 (pësë) profesorë të fushës kërkimore përkatëse ose të përafërt me të. Kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e doktoratës. Pasi ka grumbulluar 60 krëdite studenti kalon në vitin e dytë të doktoratës.</p> <p>Programet e studimit të doktoratës organizohen brenda një projekti të madh kërkimor, didaktik, kulturor, kërkimi të pavarur dhe realizohen në koordinim me zhvillimin e dokumentuar të veprimtarive të kërkimit të çdo fakulteti apo të universitetit në tërësi. Ato mund të organizohen si programe ndërdisiplinore ose të përbashkëta. Objektivat formuese të programeve të studimit të doktoratës duhet të jenë të gjëra, të motivuara dhe të lidhura më orientimet shkencore në fushën e zgjedhur apo në fushat e zgjedhura në rastin e doktoratave të dy ose më shumë disiplinave. Programet formuese duhet të jenë të verifikueshëm konkretisht. Formimi i “Doktorit të Shkencave” kërkon që një pjesë e studimeve të thëlluara tëorike të zhvillohet nën drejtimin e profesorëve të huaj, në UET ose në Universitetin e Astonit/ në Birmingham, si dhe kryerjen e punës kërkimore në universitete ose institute kërkimore jashtë vendit, për një periudhë kohe të paktën 3 (trë) mujore dhe jo më të gjatë sesa gjysma e kohëzgjatjes së programit të doktoratës.</p>
-------------------------	---	--

Programet përmbajnë vëprimtari didaktiko-shkencore të formimit të thëlluar teorik, të përvetësimit të metodologjive të kërkimit dhe të teknikave operative të posaçme, të realizuara nëpërmjet moduleve mësimore, seminareve me kualifikim të lartë, periudhave të kërkimit pranë strukturave të kualifikuara etj. Këto vëprimtari duhen përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të lidhen me objektivat formues të programit të studimit të doktoratës dhe të jenë të kontrollueshme. Programet përfshijnë kërkimin shkencor dhe vëprimtarinë krijuese të pavarur si bazë për punimin e tezës së doktoratës dhe mbrojtjen e suksesshme që çojnë në marrjen e titullit “Doktor i Shkëncavë”.

Viti I - *Formim i thelluar teorik*

Viti i parë synon një formim të thelluar teorik në fushën e zgjedhur të ekonomisë, përvetësimit të metodologjive të kërkimit dhe aplikimit të këtyre metodologjive në mënyrë të pavarur në fushën e interesit të studentit. Studentët e vitit të parë të doktoratës ndjekin programin e teorik (60 ECTS) që ofron UET; nje pjese e krediteve merren përmes lëndëve të zhvilluara nga lektorë të huaj të Universitetit të Astonit, Birmingham. Në varësi të interesit të tyre, kandidatët perzgjedhin drejtimet e Sociologji-Antropologjise Sociale, Komunikimit dhe Dizajnit, të Psikologjisë apo të Edukimit. Në fund të vitit të parë ata testohen në një provim për gjendjen teorike të disiplinës (10 ECTS) i cili synon të testojë themelin e formimit të tyre teorik. Programi i këtij provimi përbëhet nga një listë tekstesh klasikë dhe të rinj, të cilët përfaqësojnë kontributet kryesore në zhvillimin e teorive të shkencave sociale dhe të edukimit. Pasi kanë grumbulluar 60 ECTS kandidatët mund të kalojnë në vitin e dytë të doktoratës.

Viti II - *Veprimtari kërkimore*

Në vitin e dytë të studimeve doktrale kandidati zgjedh temën e disertacionit të doktoraturës, e cila miratohet nga Këshilli i Profesorëve i universitetit. Bashkë me miratimin e temës dhe udhëheqësit, nga udhëheqësi shkencor miratohet plani individual i punës studimore-kërkimore të kandidatit. Menjëherë pas kësaj, kandidati nis punën kërkimore duke mbledhur të dhënat e nevojshme në terren (në rast se studimi ka karakter empirik), apo në burime të

tjera informacioni sipas rastit. Në fund të vitit të parë, kandidati duhet t'i paraqesë për miratim udhëheqësit shkencor propozimin/prospektin për disertacionin e doktoraturës. Sugjerohet që brenda vitit të dytë të studimeve doktrale, studenti të mund të paraqesë një punim nga tema e disertacionit të tij në një konferencë apo seminar shkencor dhe, mundësisht, të ketë botuar një artikull (si autor i vetëm apo si bashkautor) në një revistë shkencore, brenda apo jashtë vendit, apo të ketë marrë zyrtarisht konfirmim për botimin e tij nga redaksia e një reviste shkencore. Studentet kalojnë në vitin e tretë pasi të kenë dëshmuar njohjen e gjuhës angleze, përmes testeve të njohura ndërkombëtare, sipas legjisllacionit në fuqi.

Viti III - *Kërkim / krijim + përpunim të dhënash + botim artikujsh + referime*

Gjatë vitit të tretë, kandidati vazhdon të thellohet në punën e tij studimore. Ai analizon teorikisht dhe përpunon të dhënat e mbledhura dhe fillon të shkruajë disertacionin. Në proces e sipër, studenti punon për të paraqitur një kumtesë tjetër nga tema e disertacionit në një konferencë apo seminar shkencor dhe të botojë artikuj (si autor i vetëm ose në bashkautorësi) në revista shkencore, brenda apo jashtë vendit. Kandidati harton tezën e doktoraturës dhe e mbron atë sipas procedurës së përcaktuar nga ligji dhe rregullorja e programit të studimit.

Udhëheqësi shkencor i studentit

15.1 Udhëheqësi shkencor për studentin pjesëmarrës në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin "Profesor", "Profesor i asociuar" osë të ketë të paktën gradën shkencorë "Doktor" të fituar në universite perëndimore.

15.2 Numri i studentëve që mund të udhëheqë njëkohësisht një udhëheqës shkencor përcaktohet nga Këshilli i Profesorëve, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më i madh së 3 deri në 5 studentë në vit, me kusht që temat të jenë të fushave të përafërta.

15.3 Udhëheqësi shkencor ka këto përgjegjësi kryësore:

- a. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së doktoratës.
- b. Të garantojë se udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.
- c. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarte të larta të

	<p>kërkimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi ka përgjegjësi të vetëdijësojë studentin për rrëzikun e falsifikimeve dhe të plagjiaturës.</p> <p>d. Të mbajë takime të rregullta me studentin mbi ecurinë e punimit.</p> <p>e. Në rastet e bashkudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.</p> <p>f. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. Të informojë studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarre veprimet e duhura mbështetëse.</p> <p>g. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e punës së tij që do të prezantohet në seminare ose takime.</p> <p>h. Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga kërkimi i tij.</p> <p>i. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.</p> <p>15.4 Nëse udhëheqësi nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit, ose do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme, ai duhet të zëvendësohet nga një udhëheqës tjetër para periudhës së marrjes së diplomës për marrjen e gradës shkencore "Doktor".</p> <p>15.5 Nëse marrëdhënia student-mentor nuk funksionon mirë, me kërkesë të studentit ndryshohet udhëheqësi, me kusht që kjo të mos çënojë ecurinë e projektit.</p> <p>15.6 Udhëheqësi shkencor për studentin pjesëmarrës në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin "Profesor", "Profesor i asociuar" ose të ketë të paktën gradën shkencorë "Doktor" të fituar në universitete perëndimore.</p> <p>15.7 Numri i studentëve që mund të udhëheqë njëkohësisht një udhëheqës shkencor përcaktohet nga Këshilli i Profesorëve, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më i madh se 3 deri në 5 studentë në vit, me kusht që temat të jenë të fushave të përafërta.</p> <p>15.8 Udhëheqësi shkencor ka këto përgjegjësi kryesore:</p> <p>a. Të garantojë se do të zbatojë të gjitha</p>
--	--

	<p>rregullat e udhëheqjes së doktoratës.</p> <p>b. Të garantojë së udhëheqja do të kryhet brenda kohës së parashikuar.</p> <p>c. Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarte të larta të kërkimit. Kjo përfshin ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe përgatitjen e punimit. Udhëheqësi ka përgjegjësi të vetëdijësojë studentin për rrezikun e falsifikimeve dhe plagjiaturës.</p> <p>d. Të mbajë takime të rregullta me studentin mbi ecurinë e punimit.</p> <p>e. Në rastet e bashkudhëheqjes, përgjegjësitë duhet të jenë të qarta për të dyja palët dhe ato duhet të mbajnë kontakte të rregullta.</p> <p>f. Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht duke i kërkuar atij të paraqesë një raport të shkruar dhe të monitorojë punën e tij përkundrejt standartit të kërkuar. Të informojë studentin nëse puna e tij është nën standartin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimët e duhura mbështetëse.</p> <p>g. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e punës së tij që do të prezantohet në seminare ose takime.</p> <p>h. Të nxisë studentin që ai të botojë pjesë nga kërkimi i tij.</p> <p>i. Të vërtetojë se kandidati ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet e jurisë kur ajo e ka rikthyer punimin për riparaqitje.</p> <p>15.9 Nëse udhëheqësi nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit, ose do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme, ai duhet të zëvendësohet nga një udhëheqës tjetër para periudhës së marrjes së diplomës për marrjen e gradës shkencore "Doktor".</p> <p>15.10 Nëse marrëdhënia student-udhëheqës nuk funksionon mirë, me kërkesë të studentit, ndryshohet udhëheqësi, me kusht që kjo të mos çënojë ecurinë e projektit.</p>
--	--

Koordinatori i Programit te Doktoratës

Zgjidhet me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit dhe kryen këto detyra kryesore:

- a. Harton çdo vit një listë me literaturën mbi bazën e së cilës do të zhvillohet provimi për gjendjen teorike të disiplinës për programin përkatës të doktoratës;
- b. Kujdeset që të gjithë studentët të kenë udhëheqësin shkencor të temës së doktoratës, duke respektuar rregullat për caktimin e udhëheqësit shkencor të doktoratës duke i dërguar propozimet përkatëse Këshillit të Profesorëve.
- c. Siguron që udhëheqësit e propozuar janë ekspertë të fushës së kërkimit, kanë kualifikimet e kërkuara, kohën dhe angazhimin për t'i ofruar kandidatit një udhëheqje cilësore të kërkimit dhe një menaxhim cilësor të punës së tij.
- d. Interesohet për t'iu siguruar kandidatëve lehtësirat e nevojshme në përmbushjen e detyrimeve të programit të studimit.
Garanton zbatimin e standarteve të kërkimeve shkencore në zhvillimin e programit të doktoratës;
- ë. Shqyrton raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentet dhe udhëheqësit dhe sigurohet që udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, i propozon Këshillit të Profesorëve masat e nevojshme;
- f. Informon studentët për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime, rregullore etj. që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore.

Angazhimi i doktorantëve në Mësimdhënie

UET-i ka të drejtë të angazhojë në procesin e mësimdhënies në programet e ciklit të parë dhe të dytë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme, studentë në procesin e kryerjes së studimeve të doktoratës dhe përgatitjes së disertacionit për gradën shkencore "Doktor".

Studentët në programet e doktoratës duhet të fitojnë, brenda mundësive, përvojë në mësimdhënie dhe forma të tjera të shpërndarjes së njohurive mbi projektet e doktoratës. Përfshirja dhe kohëzgjatja e

<p>Kriteri 4</p>	<p>Studentët kanë mbështetjen teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor.</p>	<p>angazhimit në aktivitetin e mësim-dhënies përcaktohet në marrëveshje me profesorët udhëheqës, brenda mundësive dhe nevojave të njësisë bazë përgjegjëse për programin e doktoratës. Doktorantët janë punësuar në UET si pedagogë dhe si kërkues shkencorë në projekte me <i>Zyrën e Kërkimit dhe Projekteve</i> (shih: Dosjen e aplikimit- Aneksi XX).</p> <p><i>Biblioteka</i> e UET-it bën ruajtjen, përdorimin, pasurimin, shpërndarjen dhe huazimin e pasurisë bibliografike të UET-it. Organizimi dhe funksionimi i Bibliotekës, i sistemit bibliotekar dhe i administrimit të pasurisë bibliografikë në UET, dispijlohen me rregullore të veçantë.</p> <p>Njësitë ndihmëse mësimore</p> <p>4.2 Njësi ndihmëse konsiderohen laboratorët, njësitë didaktike dhe njësi të tjera që shërbejnë për të realizuar studime dhe shërbime në kuadër të zhvillimit të procesit akademik dhe të kërkimit shkencor.</p> <p>6.1 Njësitë ndihmëse mësimore janë:</p> <p><i>Laboratori i Informatikës</i> dhe laboratorë të tjerë.</p> <p>Laboratori i Informatikës ofron shërbimin e internetit në kuadër të kërkimit dhe të shfrytëzimit të artikujve dhe të botimeve të tjera <i>on-line</i>. Kompjuterët në dispozicion mund të shfrytëzohen nga studentët për të punuar <i>ese-të</i> dhe detyrat e tjera për lëndët që ndjekin. Laboratori ofron edhe shërbimin e printimit. Funksionimi i <i>Laboratorit</i> dispijlohet me rregullore të veçantë.</p> <p><i>Studio komunikimi/media UET.</i></p> <p><i>Libraria.</i> Libraria Universitare e UET-it tregton pasurinë bibliografike akademike dhe atë të mësimdhënies, e vënë në qarkullim për shitje në përputhje me legjislacionin në fuqi. Funksionimi i Librarisë rregullohet me rregullore të veçantë.</p> <p><i>UET Press</i></p> <p>Është përgjegjës për botimet e teksteve të aprovuar sipas procedurave përkatëse, si dhe angazhohet për publikimin e revistave shkencore të UET-it në bashkëpunim me njësitë e tjera të UET-it, që ngarkohen me përgjegjësi për botimin e tyre.</p>
-------------------------	--	--

<p>Kriteri 5</p>	<p>Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p>	<p><i>UET Sondazhe</i></p> <p>Njësi që ka për funksion të kryejë sondazhe për matjen, analizën dhe interpretimin e opinionit publik dhe të tregut, në mbështetje të procesit mësimor dhe të aktivitetit kërkimor të Universitetit, si dhe për llogari të të tretëve.</p> <p><i>UET Imazhe</i></p> <p>Është një fond imazhesh, fotografish, videosh, animimesh, dokumentarësh, filmash, etj, në shërbim të procesit mësimor, të kërkimit shkencor dhe të tretëve.</p> <p><i>Zyra e Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim</i></p> <p>Mbështet dhe koordinon në shkallë institucioni aktivitetet e lidhura me projektet e kërkimit shkencor; iu ofron njësisve të tjera të Universitetit informacionin dhe asistencën e nevojshme për hartimin, për ndjekjen dhe për realizimin e projekteve në funksion të procesit mësimor e të kërkimit shkencor, si dhe mban kontaktet e nevojshme me donatorët brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Qendra e Teknologjisë së Informacionit (Zyra e IT-së)</i></p> <p>Është përgjegjëse për funksionimin dhe përditësimin e UMIS-it; për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e sistemeve IT në procesin mësimor, kërkimin shkencor dhe për administrimin e UET-it. Gjithashtu mbështet kualifikimin e personelit akademik dhe administrativ në fushën e përdorimit të teknologjive të informacionit. Mbështet përditësimin e faqes <i>web</i> dhe të prodhimit të materialeve grafike për mbështetjen e aktiviteteve të UET-it.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Standarti II.2 është përmbushur konform kritereve në lidhje me bazën didaktike dhe mbështetjen teknike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Studentët e pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë kanë kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit; ○ Programi i studimeve të doktoratës siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën kërkimore-shkencore, projekteve kërkimore të miratuara dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë akademike dhe punësim; ○ Programi i studimit të ciklit të tretë ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur; ○ Studentët kanë mbështetjen teknike të mjaftueshme për zhvillimin e kërkimit shkencor; 		

- Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- *Rregullorja e Programit* përkatës të studimit
- *Programi i studimit*
- *Emërimi i Koordinatorit* të programit.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Studimet e programit të doktoraturës fillimisht janë planifikuar dhe momentalisht mbulohen nga të ardhurat që UET siguron prej tarifave të shkollimit në këtë program, nisur nga veçantia e ofrimit për herë të parë e një programi të tillë nga një universitet privat. Ndërkohë, në vijim UET synon dhe po punon aktualisht për përfitimin e financimeve nga angazhimi i stafit pedagogjik dhe kandidatëve të studimeve doktrale në projekte te ndryshme, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Lidhur me *tarifën e shkollimit* për ndjekjen e programit doktral, kjo është e përcaktuar me vendim të posaçëm të UET dhe madhësia e tarifës përmbledh në vetvete disa vlera dhe parametra:

1. vleren për pjesen e studimeve të organizuara, që ndahet për çdo modul (lëndë) sipas krediteve përkatëse;
2. vleren për pjesën e studimeve, që lidhen me periudhën që përmbledh kërkimin shkencor dhe përgatitjen e temës së disertacionit, deri në marrjen e diplomës për gradën shkencore "Doktor".

Sipas *Rregullores*, tarifa e shkollimit mund të paguhet nga studenti plotësisht ose me këste. Nëse ajo paguhet me këste, atëherë kësti i parë paguhet menjëherë me regjistrimin e kandidatit për "Doktor i Shkencave", ndërkohë që kandidatët që kanë transferuar kredite nga programe të tjera të ciklit të tretë paguajnë vlerën përkatëse, sipas moduleve (lëndëve) dhe krediteve që ata duhet të fitojnë në programin përkatës të doktoratës.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (Tab. 7)

Tabela 7

<i>Të ardhurat nga:</i>	<i>Për vitet e zhvillimit të doktoratës</i>
Pushteti qendror	-
Pushteti vendor	-
Fonde jopublike:	Tarifat
Grantet për kërkim dhe kontratat	Nga pune administrative dhe kërkimore të doktorantëve për UET-in
Konsulencat, shërbimet	-
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	100%
Sponsorizimet	-
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	-
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	-

- Shpenzimet për studentët dhe kosto për mobilitetin e tyre*

Kosto për studentët e regjistruar në programet e Shkollës Doktrale në vitin akademik 2011-2012 është 145.950 lekë.

Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet

Universiti European i Tiranës (UET) kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpk përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Audituesi i pavarur është Znj. Enkelejda Stefani, me licëncë numër 208, datë 04.10.2010, Nipt K 72228006 I.

Rezultati: Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjendjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit 2011 dhe 2012, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kapacitetet menaxhuese financiare

Projekti financiar hartohet në muajin korrik të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm z. Henri Çili. Për zbatim të këtij projekti, ngarkohet Kancelari i UET dhe Zyra e Financës. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajis me “Kërkesë për lëvrim fondesh”, e miratuar nga Menaxheri. Projektbuxheti vjetor hartohet sipas një skenari konservator, të tillë që gjithmonë të ketë një rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi I.1 - Kuadri i përgjithshëm		
Kriteri 5	Programi i studimeve të doktoratës mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për kërkim.	Lidhur me kete program, UET është në fazën përfundimtare të pajtimit periodik në bazën e të dhënave REUTERS/THOMSON, si një nga bazat më të fuqishme të të dhënave, kryesisht për projektet kërkimore në fushën e financave. Më tej, kjo bazë të dhënash do të shërbejë dhe për programet e tjera studimore si dhe për vetë projektet individuale dhe institucionale kërkimore të stafit pedagogjik të UET. Pajtimi ne këtë bazë të dhënash kushton rreth 50,000 euro ne vit. Gjithashtu, në koston për student përllogariten detyrimisht dhe kostot që lidhen me realizimin e kërkimit shkencor të doktorantëve, investimet per labororet e PC-se, për bibliotekat on line, kosto per lecture’s papers etj.

Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor		
Kriteri 8	Financimet e jashtme të përfituara për kërkim shkencor janë tregues të veprimtarisë kërkimore me nivel të lartë dhe administrohen për mbarëvajtjen e programit përkatës të studimeve.	Shkolla doktorale nuk merr aktualisht financime nga jashtë institucionit, lidhur me kërkimin shkencor dhe momentalisht cdo lloj financimi kryhet me fonde të brendshme.
Standardi III.1 - Administrimi dhe mjetet për financimin e programit të studimeve të doktoratës		
Kriteri 7	Buxheti financiar i programit të studimeve të doktoratës është i mjaftueshëm për të arritur objektivat kërkimore për çdo doktorant.	UET në përcaktimin e tarifave përkatëse të ndjekjes së studimeve për programin e doktoraturës ka përllogaritur dhe marrë parasysh mbulimin optimal të të gjithë elementëve të kostove që burojnë nga detyrimi për t'i siguruar doktorantëve përmbushjen sa më të mirë të objektivave të tyre kërkimore.
Kriteri 8	Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të doktoratës përputhet me politikën dhe nevojat e kërkimit shkencor.	<p>Në përcaktimin e tarifës së shkollimit dhe ndjekjes së programit të studimeve doktorale merret në konsideratë sigurimi i një harmonizimi optimal midis vlerës së:</p> <ul style="list-style-type: none"> - studimeve sipas çdo moduli (lënde), në përputhje me kreditet përkatëse dhe - studimeve per periudhen që lidhet me kërkimin shkencor dhe përgatitjen e temës së diplomës per graden shkencore "Doktor". <p>Në këtë kuadër, UET planifikon që rreth 10% e tarifës së paguar të shkojë në mbështetje të kërkimit shkencor të doktorantit.</p>
Standardi III.3 - Financimi i programit të studimeve të doktoratës		
Kriteri 1	Numri i punimeve kërkimore të mbështetur financiarisht nga Ministria.	Aktualisht nuk ka punime shkencore që të jenë mbështetur me mjete financiare nga Ministria.
Kriteri 2	Shpërndarje e fondeve për grupet pritëse dhe drejtuese të punimeve kërkimore është bërë në mënyrë të ekuilibruar;	Pedagogu i shkolles doktorale paguhet për orë/njësi të mësimdhënies dhe për udhëheqjen e studentit për punimin shkencor sipas udhëzimit të përcaktuar nga MASH.
Kriteri 3	Numri i punimeve kërkimore të financuara në kuadrin e projekteve kërkimore kombëtare, të	Ekziston nje mbeshtetje institucionale, por ajo nuk ka dhene

Kriteri 4	<p>përfituara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh.</p> <p>Numri i punimeve kërkimore të financuara në kuadrin e projekteve kërkimore ndërkombëtare të përfituara nga udhëheqësit shkencorë të doktorantëve për këtë program studimesh.</p>	<p>ende rezultatet e para.</p> <p>E njejta gjendje.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Financimi i programit doktoral dhe kërkimit shkencor në UET siguron mbulimin e plotë të të gjithë shpenzimeve që kërkohen për këtë qëllim. Si një program në hapat e para, në mënyrë objektive e të arsyeshme ai mbështetet plotësisht në fondet e brendshme, madhësia e të cilëve synohet të mbulojë optimalisht kostot përkatëse të procesit mësimor, si dhe ato të kërkimit shkencor. Ndërkohë, për UET-in mbetet një përpjekje thelbësore sigurimi i një baze më të diversifikuar të financimit të kërkimit shkencor, drejt përdorimit edhe të burimeve të jashtme.</p>		

Dokumentacioni i nevojshëm:

- *Bilancet vjetore (Aneksi VII)*
- *Raportet e auditit të pavarur (Aneksi VIII).*

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkimore

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike kujdesen strukturat organizative drejtuese të UET-it, të cilat janë ngritur e veprojnë konform kërkesave të Ligjit nr. 9741, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të datës 21.05.2007, i ndryshuar si dhe *Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë* (NJSBC) e cila në UET njihet edhe si *Komisioni i Sigurisë së Brendshme të Cilësisë* (KSBC). Kjo njësi e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve të ngritura *ad hoc* dhe që nga janari i vitit 2011 e në vazhdim në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë të tre fakultetet e UET, nga një përfaqësues nga sektorët ndihmës dhe studentët.

Aktivitetin e saj, NJSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar të përvitshëm në të cilin programohen kontrollet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET, rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njërive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies mbështetur në “Librin e Pedagogut” si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin jo vetëm në njohjen e specifikave të rregulloreve të UET, por edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimin.

Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohet përmes paraqitjes në *Intranet* (shih te: *Dokumenta UET*) të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, etj, legjislacionin përkatës, urdhërat e rektoratit të UET, etj. Në këtë kuadër, për secilin program lënde që është pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas grup-lëndëve dhe në departament.

Impakt të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga “fokus grupet” si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Të dhënat e fituara nga këta pyetësore, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të *follow up*-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik.

Drejtuesit e Shkollës doktrale dhe koordinatori i programit të studimit janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët, për problemet e tyre dhe për çështje që lidhen

me mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, në këtë program studentët, në ditët doktorale plotësojnë pyetësorët që lidhen me mbështetjen teknike që japin udhëheqësit doktoralë. Brenda çdo departamenti në UET, janë ngritur dhe funksionojnë grup-lëndët, për rritjen e cilësisë së programeve të lëndëve që zhvillohen brenda një programi studimi dhe garantimin e një harmonizimi më të mirë të njohurive brenda të njëjtit grup-lëndësh, duke u shtrirë si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht.

NJSBC-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm në akreditimet e programeve akademike që zhvillohen në UET, ku përmendet procesi i akreditimit si institucion dhe i programeve të para të studimit: Vendimi i Këshillit të Akreditimit nr. 24, datë 19.07.2009, Urdhëri i Ministrisë të Arsimit nr. 246, datë 24.07.2009 dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i hartuar në prill-maj 2010 në kuadër të proceseve të akreditimit.

Si rezultat i një veprimtarie intensive për sigurimin e brendshëm të cilësisë është fituar një përvojë e gjerë, e cila ka diktuar marrjen e një sërë masash me karakter organizativ dhe metodik. Kështu, theksi është vënë në forcimin e rolit dhe përgjegjësisë së departamentit në proceset akademike, janë gjetur forma të reja për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve, kontrollin e njohurive të fituara nga studentët përmes zhvillimit të detyrave në auditor, marrjen e masave për të mënjeluar plagjiaturën në diploma, ese, provime etj.

Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET është *Pyetësi me studentët*, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve janë përpunuar tërësisht nga ana e personave përgjegjës për statistikën në UET, ndërsa rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Njëherazi, ato kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndër problemet më kryesore kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontroll etj.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në *NJSBC* si:
 - Sa anketime kanë bërë me studentët, pedagogët, udhëheqësit e tezës;
 - Sa studentë janë anketuar;
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë;
 - Cilët kanë qënë hapat e metejshëm.
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikën e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tab. 8)

Tabela 8

	Anëtarët e NJBSC	Detyra që ka në NJBSC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Përparim Fuga	Kryetar	janar 2011
2	Elda Papa	Anëtare	dhjetor 2008
3	Evis Gjebrea	Anëtare	mars 2010
4	Gilman Bakalli	Anëtar	mars 2010
5	Merita Kotorri	Anëtare	janar 2011
6	Marinela Seitaj	Anëtare	prill 2012
7	Erjona Canaj	Anëtare	tetor 2012
8	Arbi Agalliu	Anëtar	tetor 2012

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë		
Kriteri 1	Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecuresë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni analizon mbi bazë Fakulteti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në 'to mendimin e përfaqësuesve të Tregut të Punës dhe opinionin e studentëve.
Kriteri 2	Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në "fokus grupe", institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.		

Kriteri 1	Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve.	UET-i ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional si edhe përpara të studimit me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr.24, datë 19.07.2009, të shoqëruar me Urdhërin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 246, datë 24.07.2009).
Kriteri 2	Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë.	Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të antarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me APAAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.
Kriteri 3	Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.	Për të siguruar cilësinë e proceseve akademike UET harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatin Akademik, Këshillin e Fakultetit, këshillat e departamenteve.
Kriteri 4	Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit.	Një rol të veçantë luajnë mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, ndër të cilët përmendim atë për format e kontrollit; organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe që janë diplomuar në UET etj.
Kriteri 5	Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to.	Ndërgjegjësimi i personelit synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për

Kriteri 6	Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik, dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e UET-it, pedagogët etj. Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të <i>NJSBC</i> dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikura në intranetin e UET-it.
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve		
Kriteri 1	Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	UET përdor metodologji vlerësimi për tërë aktivitetet me karakter kontrolli që organizohen nga <i>NJSBC</i> , për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, njesia (Fakulteti) rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë <i>NJSBC</i> .
Kriteri 2	Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë.	Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për

<p>Kriteri 3</p>	<p>Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë.</p>	<p>të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët.</p> <p>Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe gjejnë reflektimin e tyre në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 4</p>	<p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të <i>tërthorta</i> ose të <i>drejtpërdrejta</i>.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet etj); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit/tezës etj. 	<p>Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UET, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog etj.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm</p>		
<p>Kriteri 1</p>	<p>Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimit periodike mbi cilësinë, por</p>

<p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj, për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>deri më sot nuk ka ndonjë botim të publikuar për përdorim masiv.</p> <p>UET organizon një pyetësor/sondazh në faqen e tij të internetit mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, etj dhe rezultatet përkatëse reflektohen në <i>web-in</i> e UET-it.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Sigurimit të cilësisë në UET i tregohet kujdes i veçantë, konsiderohet prioritet për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Eksperienca e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ.</p>		

Dokumentacioni i nevojshëm:

- *Formulari* i anketimit (Aneksi XI)
- *Raportet* e auditit të brendshëm të KSBC-së për *syllabus*-et e lëndëve si dhe rezultatet e provimeve të nivelit dy-vjeçar, duke qënë se këta studentë zënë peshën më të madhe ndaj numrit total të doktorantëve të pavarur (Aneksi XII)
- *Pyetësi* i vlerësimit të pedagogut/udhëheqësit nga studenti (Aneksi XIII)
- *Plani kalendar*.

PROGRAMI I STUDIMEVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Shkolla Doktorale në UET ka për mision të lehtësojë dhe udhëheqë procesin e produkteve cilësore shkencore në Shkencat Sociale, të kandidatëve të cilët plotësojnë kriterët për të ndjekur studimet doktorale në përputhje me udhëzimet e MASH dhe legjislacionin në fuqi. Doktorantët e suksesshëm që përfundojnë studimet kërkimore dhe mbrojnë disertacionin doctoral brenda afatëve fitojnë gradën “Doktor” (*Rrëgullore për Organizimin e Programeve të Të Studimit të Doktoratës 3.4*). Organizimi i vitit mësimor, përmbajtja e planit mësimor me të gjithë elementët e përgjithshëm dhe të vëçantë të tij janë ndërtuar në përputhje me këtë mision dhe objektiva (sic ilustrohen më poshtë në tabelat përkatëse).

Tregues të matshëm:

- Elementë të përgjithshëm të Programit të Studimit:
- Kohëzgjatja: të paktën 3 vite;
 - Formim i thelluar teorik: 1 vit ose 60 ECTS;
 - Kërkim/krijim: të paktën 2 vjet;
 - Mbrojtja e tezës: brenda 4 viteve nga regjistrimi.

Plani mësimor për vitin e parë (Tab. 9)

Tabela 9

Viti I (Viti II)	Lëndë/Module	Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore															Provime
					Leksione			Seminare			Leksione të Hapura/ te ftuar special/ vizita studimore			Detyra Praktike			Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	Metoda Kerkimi 1	I	10	8	4	45	55	3	27.5	60	1	5	20	1.5	12.5	25	90	160	250	1
2	Metoda kërkimi në shkencat sociale 2	I	10	8	4	45	55	3	27.5	60	1	5	20	1.5	12.5	25	90	160	250	1
3	Teori bashkëkohore në shkencat sociale 1	I	10	8	4	45	55	3	27.5	60	1	5	20	1.5	12.5	25	90	160	250	1
4	Teori bashkëkohore në shkencat sociale 2	I	5	7	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	125	1
5. a	Teori dhe debate bashkëkohore në komunikim	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	125	1

6. a	Teori dhe strategji të kom.t politik	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
7. a	Mediat e reja, teknologjitë e komunikimit dhe konsumatori	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
5. b	Teori dhe debate bashkëkohore në SHP	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
6. b	Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet elektorale	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
7. b	Sociologji e demokratizimit dhe e tranzicionit	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
5. c	Teori dhe debate bashkëkohore në MN	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
6. c	Politika e Jashtme dhe e sigurisë	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
7. c	Organizatat Nderkombetare në Politikën botërore	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
5. d	Teori dhe debate bashkëkohore në sociologji e antropologji sociale	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
6. d	Antropologji politike dhe juridike	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
7. d	Modernizimi, zhvillimi dhe globalizimi	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
5. e	Teori dhe debate bashkëkohore ne Psikologji	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
6. e	Dallimet Individuale (Inteligjenca, Personaliteti, Psikopatologjia	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
7. e	Psikologjia Sociale dhe e Shendetit	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
5.f	Teori dhe debate bashkekohore në Edukim	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1
6.f	Mësimdhënia dhe mësimnxënia	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	12.5	1

7.f	Sistemet e administrimit modern të arsimit	II	5	4	2	35	15	1	5	20	1	5	20	1.5	12.5	20	50	75	125	1
	Provimi per gjendjen teorike te disiplines		10																	
	Totali		60	20	275	225	145	102.5	260	7	35	140	85	57.5	155	470	780	1250	7	

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tab. 10)

Tabela 10

Lënda / Moduli		Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1.	Metoda Kerkimi 1	Nicola Corkin, Holger Kachelein, Jelena Obradovic, Alexander Wochnik	PhD	SHP-MN	PAK
2.	Metoda kërkimi në shkencat sociale 2	Odeta Barbullushi, Aleksandër Dhima	PhD/Prof. Asoc	SHP-MN	PAE
3.	Teori bashkëkohore në shkencat sociale 1	Fatos Tarifa, Annaliese Dodds Aleksandër Dhima	PhD/Prof. Asoc	SHP-MN	PAE/ PAK
4	Teori bashkëkohore në shkencat sociale 2	Jelena Obradovic, Odeta Barbullushi, Enika Abazi	PhD/Prof. Asoc	SHP-MN	PAK/PAE
5.a	Teori dhe debate bashkëkohore në komunikim	Gilman Bakalli	PhD	Komunikim	PAE
6.a	Teori dhe strategji të komunikimit politik	Henri Çili, Mark Marku	PhD	Komunikim	PAE/PAK
7.a	Mediat e reja, teknologjitë e komunikimit dhe konsumatori	Mark Marku	PhD	Komunikim	PAK
5.b	Teori dhe debate bashkëkohore në Shkencat Politike	Klejd Kellici	PhD	SHP-MN	PAE

6.b	Partitë politike, zgjedhjet dhe sistemet elektorale	Klejd Kellici	PhD	SHP-MN	PAE
7.b	Sociologji e demokratizimit dhe tranzicionit	Tonin Gjuraj	Prof. Asoc. Dr	SHP-MN	PAE
5.c	Teori dhe debate bashkëkohore në MN	Enika Abazi	Prof. Asoc. Dr	SHP-MN	PAK
6.c	Politika e Jashtme dhe e Sigurisë	Perparim Fuga, Odeta Barbullushi	Prof. Dr/ PhD	SHP-MN	PAE
7.c	Organizatata nderkombetare në politikën botërore	Ksenofon Krisafi	Prof. Dr	E Drejte Publike	PAE
5.d	Modernizimi, zhvillimi dhe globalizimi	Adrian Civici	Prof. Dr	Menaxhim & Ekonomiks	PAE
6.d	Antropologji politike dhe juridike	Aleksandër Dhima	Prof. Asoc. Dr	SHP-MN	PAE
5.e	Teori dhe debate bashkëkohore ne Psikologji	Edmond Dragoti	Prof. Dr	Edukim	PAK
6.e	Dallimet Individuale: Inteligj Personaliteti, Psikopatologjia	Zenel Orhani	Prof. Asoc. Dr	Edukim	PAK
7.e	Psikologjia Sociale dhe e Shendetit	Erika Melonashi	PhD	Edukim	PAE
5.f	Teori dhe debate bashkekohore në Edukim	Valier Peshkepja	Prof. Asoc. Dr	Edukim	PAE
6.f	Mësimdhënia dhe mësimnxënia	Ladi Shahini	Prof. Dr	Edukim	PAK
7.f	Sistemet e administrimit modern të arsimit dhe integrimi European	Jetmir Alicka	Prof. Asoc. Dr	Edukim	PAK

- ☑ *Syllabus*-et për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:
 - Emërtimi i lëndës/modulit
 - Viti/semestri kur zhvillohet lënda
 - Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
 - Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
 - Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
 - Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
 - Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
 - Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
 - Format e vlerësimit të studentëve
 - Detyrimet e studentit për lëndën
 - Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.

- ☑ Procedurat që ndiqen për aprovimin e projektit kërkimor të propozuar nga kandidatët.

- ☑ Të dhëna për vitin e dytë (Kërkim/Krijim). Të dhëna për Institucionet brënda ose jashtë vendit, ku studentët kanë kryer kërkimet e tyre shkencore:
 - Universitet/Qëndër kërkimi dhe zhvillimi të Universitetit
 - Institut/Enti i kërkimit joakademik
 - Fondacion/Subjekt publik/subjekt privat

- ☑ Të dhëna për vitin e tretë: Kërkim/Krijim + Përpunim të dhënash + Botim artikujsh + Referime
 - Të dhëna për botimet/referimet e studentëve ;
 - Të dhënat për Revistat, entet botuese ku janë botuar këto artikuj.

- ☑ Të dhëna për hartimin e tezës së doktoratës dhe mbrojtjen e saj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret/ standardet
Standardi I.4 - Hartimi dhe realizimi i kursit teorik të ciklit tretë të studimeve (doktoratë)		
Kriteri 1	Programet e studimeve të ciklit të tretë përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike.	Kriteri 1 dhe 2 plotësohen tërësisht, pasi programi- sic është paraqitur në <i>Rrëgulloren</i> (§11.1 dhe §11.2) dhe në Broshurën bashkëlidhur- ilustron zbatimin e këtyre kriterëve në mënyrë rigorozë.
Kriteri 2	Në studimet e organizuara teorike janë parashikuar, të ekuilibruara, raportet e orëve për formim akademik dhe shkencor të përgjithshëm me atë specifik.	Plani mësimor i përgjithshëm dhe programet specifike janë ngritur në përputhje me udhëzimet ligjore.
Kriteri 3	Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve nënligjore në fuqi.	Kriteri përmbushet plotësisht, madje një mundësi e dytë u është dhënë studentëve afër 80% të kalojnë pragon me produkt të mirëpërcaktuar shkencor të standartit doktoral, në përputhje të plotë me <i>Regulloren</i> (§ 11.2).
Kriteri 4	Kursi teorik i doktoratës vlerësohet me një provim të përgjithshëm teorik, në fushën përkatëse të studimeve, të organizuar nga dekanati dhe Këshilli i Profesorëve me një komision të përbërë nga 5 (pesë) Profesorë të fushës kërkimore përkatëse ose të përafërt me të. Kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e doktoratës.	Në shkurt të vitit 2013 u zhvillua provimi për gjendjen teorike të disiplinës. Provimi u organizua nga Dekanati dhe Këshilli i Profesorëve, me një komision të përbërë nga pesë profesorë të fushës përkatëse. Në <i>Rregulloren</i> për " <i>Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoraturës</i> " (pika 11) përcaktohet se kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e doktoratës.
Standardi II.3 - Hartimi dhe miratimi i projektit kërkimor të propozuar		
Kriteri 1	Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve të doktoratës ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë kërkimi dhe kjo është diskutuar me të gjatë intervistës.	Aplikanti shpreh interesin e tij kërkimor në një projekt-propozim doktoral, i cili diskutohet gjatë një interviste (apo me shumë konsulta metodologjike, nëse shihet e nevojshme). Ndërkohë, konsulta <i>on line</i> është një tjetër opsion që përdoret gjerësisht nga kandidatët (shih të <i>Rregullorja</i> , seksionet 7 dhe 9).

<p>Kriteri 2</p>	<p>Fusha e hulumtimit/kërkimit është përzgjedhur në mënyrë të tillë që programi i studimeve të doktoratës të mund ta mbështesë atë.</p>	<p>Pavarësisht se aplikanti vjen me një propozim original, ai në vijim inkuadrohet në një nga profilet e mirëpërcaktuara të <i>Shkollës Doktorale (Rrëgullorja, 5.3)</i>. Propozimi shqyrtohet nga koordinatori përkatës për çështje si mbështetja teorike dhe çështjet metodologjike. Më pas, ai zhvillohet me udhëheqësin në aspekte si: organizimi i veprimtarisë shkencore; shqyrtim literature i thelluar; kërkim në terren; mënyra e shkrimit dhe mbrojtjes.</p>
<p>Kriteri 3</p>	<p>Propozimi miratohet nga Këshilli i Profesorëve, në rast se plotësohen kriteret e parashikuara dhe të shpallura në rregulloren e studimeve të doktoratës. Gjithashtu duhet të konfirmohen: a) Kohëzgjatja e programit të studimeve; b) Modalitetet e verifikimit të veprimtarisë kërkimore apo krijuese të studentëve të doktoratës; c) Mënyra e paraqitjes përfundimtare të rezultatit të kërkimit që do arrijë doktoranti.</p>	<p>Këshilli i Profesorëve merr më pas në shqyrtim propozimin për të shprehur vendimin përkatës (miratim, sugjërime për përmirësim ose kthim të propozimit).</p>
<p>Kriteri 4</p>	<p>Një anëtar i personelit akademik me titull “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose me gradën shkencore “Doktor” apo “PhD”, të fituar në fushën shkencore në të cilën vazhdon studimet doktoranti, në universitete të njohura në botë për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, është emëruar nga Këshilli i Profesorëve për të udhëhequr dhe për të mbështetur punën kërkimore të studentit.</p>	<p>Anëtarët e Këshillit të Profesorëve në UET përmbushin kënaqshëm kërkesat e kriterit 4.</p>
<p>Kriteri 5</p>	<p>Studenti i doktoratës paraqet para Këshillit të Profesorëve planin e zhvillimit të kërkimit, të hartuar prej tij dhe të diskutuar me udhëheqësin e vet.</p>	<p>Studenti paraqet paraprakisht përpara komisioneve të <i>Diteve Doktorale</i>, pas konsultimit me udhëheqësin, planin e zhvillimit të kërkimit. Në Këshillin e Profesorëve paraqitet drafti final i propozimit doctoral i cili përmban në vetvete një strukturë organizimi kërkimor.</p>
<p>Kriteri 6</p>	<p>Udhëheqësi i ka këshilluar në mënyrë të vazhdueshme studentët që udhëheq, për detyrat didaktike dhe aktivitetet kërkimore si edhe për metodologjinë e hulumtimit për të siguruar ecurinë e tij/tyre në këtë program studimesh.</p>	<p>Studenti mban kontakte me udhëheqësin nëpërmjet <i>Diteve Doktorale</i> të organizuara në UET, si dhe në çdo kohë që të dyja palët e shohin të arsyeshme apo te nevojshme takimin/kontaktin <i>on line</i> dhe</p>

		<p>konsultimin. <i>Ditet Doktorale</i> kane shërbyer kryesisht për të diskutuar çështjet madhore, ndërsa kontaktet ndërmjet, për qartësimin e aspekteve dytësore.</p>
<p>Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor</p>		
<p>Kriteri 1</p>	<p>Një program studimi i ciklit tretë (doktoratë) është i integruar në veprimtarinë kërkimore të Institucioneve të Arsimit të Lartë.</p>	<p>Kriteri permbushet plotësisht. Profilët doktorale jane ngritur mbi kapacitete akademike dhe kërkimore tashmë të konsoliduara në Shkencat Sociale.</p>
<p>Standardi II.4 - Udhëheqja e doktorantëve dhe vlerësimi në vazhdimësi i ecurisë së studimeve të doktoratës</p>		
<p>Kriteri 1</p>	<p>Udhëheqësi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit. Ai ka titullin akademik “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” apo (“PhD”) të fituar në universitetet perëndimore dhe ka veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese.</p>	<p>Kriteri permbushet. Udhëheqësit shkencorë ne <i>Shkollën Doktorale</i> UET mbajnë një apo më shumë nga titujt e kërkuar dhe kanë veprimtari të pasur kërkimore-botuese (shih Tab. 10).</p>
<p>Kriteri 2</p>	<p>Të gjithë udhëheqësit shkencorë kanë pasur ekspertizën, instruksionin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tyre në realizimin e projektit kërkimor-shkencor të studentëve të doktoratës.</p>	<p>Kriteri përmbushet plotësisht. Në rast se propozimi i një aplikanti është tejet specifik dhe nuk përputhet plotësisht me profilët kërkimor të udhëheqësve të brendshëm, Fakulteti (ose vetë aplikanti) mund të propozojë një udhëheqës të jashtëm që përmbush kushtet e kriterit të mësipërm dhe miratohet nga drejtuesi i Këshillit të Profesorëve.</p>
<p>Kriteri 3</p>	<p>Udhëheqësit shkencorë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.</p>	<p>Në UET organizohen në mënyrë periodike simpoziume dhe konferenca shkencore (<i>call for papers</i>-bashkëlidhur), ku udhëheqësit shkencorë dhe doktorantët e avancuar në studime doktorale marrin pjesë dhe shkëmbejnë njohuri dhe ekperiencë me akademike dhe kolegë vendas e të huaj.</p>
<p>Kriteri 4</p>	<p>Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit shkencorë, të aftë për të drejtuar punën kërkimore të doktorantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.</p>	<p>Udhëheqësit shkencorë duhet të përmbushin kriteret e vendosura nga Shkolla Doktorale dhe të miratohen nga Këshilli i Profesorëve (<i>Rregullorja</i>, seksioni 15).</p>

Kriteri 5	Udhëheqësi shkencor kryesor dhe udhëheqësi tjetër (kur programi i studimeve të doktoratës ofrohet nga më shumë se një universitet) siguron/jnë që studentët e doktoratës të marrin mbështetje të mjaftueshme dhe udhëzime për të lehtësuar punën e tyre për arritjen e suksesit.	Kriteri përmbushet. Monitorimi i progresit të studentit në ditët doktorale, është një mekanizëm që e lehtëson mbështetjen dhe udhëzimin gradual drejt suksesit, siç është specifikuar.
Kriteri 6	Në të gjitha rastet, studenti duhet të ketë vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studenti duhet të dijë se kush do të jetë personi që do ta zëvendësojë; Universiteti siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur studentin e doktoratës.	Pas konsultave metodologjike me koordinatorët, studenti hyn në një marrëdhënie të individualizuar me udhëhesin shkencor. Në rast se udhëheqësi nuk është më i disponueshëm, Fakulteti i Shkencave Sociale siguron zëvendësimin e udhëheqësit në kohë të mjaftueshme dhe pa ndërprerë ritmin normal të punës kërkimore (<i>Rregullorja</i> , §15.4 dhe §15.5).
Kriteri 7	Universiteti siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur studentin e doktoratës.	Pas konsultavë metodologjike me koordinatorët, studenti hyn në një marrëdhënie të individualizuar me udhëheqësin shkencor.
Kriteri 8	Në qoftë se udhëheqësi kryesor nuk është në gjendje të vazhdojë mbikëqyrjen e studentit, ose do të mungojë për një periudhë të konsiderueshme, ai duhet të zëvendësohet nga një udhëheqës tjetër para periudhës së marrjes së diplomës për gradën shkencore “Doktor”.	Në rast se udhëheqësi nuk është më i disponueshëm, Fakulteti/ departamenti përkatës siguron zëvendësimin e tij në kohë të mjaftueshme dhe pa ndërprerë ritmin e tij normal të punës kërkimore (<i>Regullorja</i> , §15.4 dhe §15.5).
Kriteri 9	Nëse marrëdhënia student-udhëheqës nuk funksionon mirë, me kërkesë të studentit ose të mbikëqyrësit të tij, ndryshohet udhëheqësi, me kusht që kjo të mos cenojë ecurinë e projektit.	Marrëdhënia student-udhëheqës ndërpritet në ato raste kur bëhet e qartë që marrëdhënia nuk ofron produktin e pritur apo të dëshiruar shkencor. Studenti dhe udhëheqësi njoftojnë menjëherë koordinatorët për vendimin e shkëputjes së marrëdhënies së tyre.
Kriteri 10	Janë përcaktuar procedura të qarta dhe transparente për verifikimin e dijeve apo vlerësimin periodik të studentit (për shembull, një rishikim vjetor nga një panel i thirrur për këtë qëllim ose nga një komision i posaçëm i ngritur nga Këshilli i Profesorëve). Studenti i doktoratës dhe udhëheqësi i tij duhet të jenë të pranishëm gjatë këtij procesi. Mënyra dhe periudhat e verifikimit të dijeve apo vlerësimit periodik të studentit të doktoratës parashikohen dhe	<i>Ditët Doktorale</i> në UET janë të strukturuar për këtë qëllim dhe duket se përmbushin plotësisht kërkesat e kriterit 10 (për detaje shih <i>Vendimin</i> e dt. 30.10.2012 “Për Ditët Doktorale” – bashkëlidhur).

<p>Kriteri 11</p>	<p>specifikohen që në fillim të programit të studimeve të doktoratës.</p> <p>Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, për realizimin e projektit kërkimor shkencor të programit të studimeve të doktoratës, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet e doktoratës.</p>	<p>Konkluzionet janë transparente për studentët, janë të dokumentuara dhe të përmbledhura në dosjen personale të secilit student.</p>
<p>Kriteri 12</p>	<p>Takimet ndërmjet udhëheqësve dhe doktorantëve janë të dokumentuara, sidomos gjatë shqyrtimit të raporteve të progresit.</p>	<p>Udhëheqësit pajisen me forma specifike për dokumentimin e progresit të studentëve në ditët e ndryshme doktorale. Ndërkohë korrespondenca elektronike shërben si një formë plotësuese e dokumentacionit (bashkëlidhur një forme e Raport-Progresit Vjetor dhe Raport-Progresit Tremujor).</p>
<p>Kriteri 13</p>	<p>Udhëheqesi shkencor me titullin akademik "Profesor", i punësuar me kohe të plote, udhëheq njëkohësisht jo me shume se pesë doktorante. Udhëheqesi shkencor me titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe udhëheqesi shkencor me gradën shkencore "Doktor" ("PhD) të fituar pranë universiteteve perendimore, i punësuar me kohe të plote, udhëheq njëkohësisht, jo me shume se dy doktorante. Udhëheqesi me titullin akademik "Profesor", i punësuar me kohe të pjesshme, udhëheq vetëm një doktorant.</p>	<p>Organi kompetent për përcaktimin e numrit të studentëve që mund të udhëhe një mentor është <i>Këshilli i Profesorëve</i>, siç specifikohet në <i>Regullore</i> (§ 5.1.b). <i>Këshilli</i>, gjatë mbledhjes së tij, operon duke u mbështetur në udhëzimet specifike të MASH-it në fuqi.</p>

Standardi II.5 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve në këtë cikël studimesh

<p>Kriteri 1</p>	<p>Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri të thelluara në fushën përkatëse shkencore; Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; Aftësi profesionale në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet kritike që lidhen me fushën e tij të kërkimit; Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese; Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja që nxisin kërkimin shkencor. 	<p>Disertacioni doktorale është parashikuar të analizohet nga Oponenti/ Udhëheqësi/ Komisioni, me qëllim shqyrtimin e objektivitetit të përcaktuar qartë, ndër të cilat përfshihen edhe pikat a-e të kriterit 1. Kushte specifike janë përcaktuar me qëllim garantimin e cilësisë shkencore dhe etike të kërkimit dhe disertacionit doktorale.</p>
-------------------------	--	--

Kriteri 2	Studenti jep prova që me anë të kërkimit shkencor të realizuar, ai ka sjellë produkte shkencore origjinale, punime shkencore të një niveli të lartë shkencor, disa prej të cilave kanë merituar a meritojnë publikimin në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.	Kriteret 2 dhe 3 përmbushen plotësisht. Janë përcaktuar procedura specifike për vlerësimin rigoroz të disertacionit (shih të <i>Rregullorja</i> , 13; 14 dhe 15). Disertacioni, artikujt, referimet në konferenca, janë kërkesa transparente të cilat janë parashikuar të vlerësohen me objektivitet nga pala vlerësuese.
Kriteri 3	Vlerësimi përfundimtar i studentëve të doktoratës bazohet mbi të gjitha në një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij.	Mbetet për t'u plotësuar në brezin e parë të doktorantëve që përfundojnë studimet.
Kriteri 4	Mbi bazën e një marrëveshjeje të arritur që në fazën e miratimit të programit të studimeve, rezultati i kërkimit të paraqitet si tezë disertacioni, ose kumulativ me 3 artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare me <i>faktor impakti</i> , me koeficient mbi 1.	Forma standarde e mbrojtjes së doktoratës është ajo nëpërmjet tezës së disertacionit. Mbrojtja dhe procedurat e lidhura me të shprehen në <i>Rregullore</i> (seksioni 17).
Kriteri 5	<p>Në rastin e provimit në doktoratë me tezë disertacioni, doktoranti ka plotësuar kushtet e mëposhtme:</p> <p>a) Ka realizuar si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare, në një vend perëndimor (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je;</p> <p>b) Ka botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, dy prej artikujve janë botuar ose pranuar për botim në revista të njohura perëndimore, me bord editorial;</p> <p>c) Ka përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e Profesorëve të fakultetit disertacionin, së bashku me një përmbledhje, të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Struktura e disertacionit dhe e përmbledhjes së tij përcaktohen në rregulloren e studimeve të doktoratës.</p>	

Konkluzionet e vlerësimit:

Ka një përmbushje të kënaqshme të standarteve, të zbërthyer në kritere specifike, siç është argumentuar përbri secilit prej tyre). Në lidhje me standardin II.5, mund të thuhet se ka një përputhje të plotë midis procedurave të paracaktuara nga UET-i për mbrojtjen e tezës doktorale dhe nënkushteve të kriterit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Formati i *syllabus*-it të lëndëve në Doktoraturë (Aneksi XIV)
- *Vendimin* e dt. 30.10.2012 për “Ditët Doktorale” (Aneksi XV)
- Raport-progresi vjetor dhe Raport-progresi tremujor (Aneksi XVI)

8. Mësimdhënia (në vitin e formimit teorik)

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit të ciklit të tretë në Shkenca Sociale përfshin 60 kredite, një pjesë e të cilave për studime të organizuara teorike. Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoraturës studenti duhet të ndjekë lëndët e parashikuara në programin përkatës, sipas planit mësimor të miratuar, për të grumbulluar 50 kredite, që merren përmes lëndeve të zhvilluara nën drejtimin e personelit akademik vendës dhe të huaj, në UET ose në Aston University. Në studimet e organizuara teorike përfshihen lëndë që mundësojnë një formim akademik dhe shkencor të përgjithshëm në kategorinë e Shkencave Sociale dhe lëndë specifike për drejtimin përkatës. Në varësi të interesit të tyre, kandidatët përzgjedhin drejtimet: Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Sociologji-Antropologji Sociale, Komunikim, Psikologji, Pedagogji apo Dizajn. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë pjesmarrjen në diskutim, 1-2 prezantime ose ese dhe provimin përfundimtar. Në fund të vitit të parë studenti gjithashtu i nënshtrohet një provimi që përbën thelbin e formimit të tij teorik (*comprehensive exam*) që ka peshën e 10 krediteve. Programi i këtij provimi përbëhet nga një listë tekstesh klasikë dhe të rinj, të cilët përfaqësojnë kontributet kryesore në zhvillimin e teorive përkatëse. Kandidatët që arrijnë rezultate mbi 80% të pikëve lejohen të vijojnë pjesën kërkimore të studimeve të doktoratës. Ata që nuk e arrijnë këtë rezultat marrin dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara, dhe i ndërpresin studimet e doktoratës. Pasi kanë grumbulluar 60 ECTS, kandidatët mund të kalojnë në vitin e dytë të doktoratës.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies (Tab. 11)

Tabela 11

Programi i Studimit Doktoral		
<i>Format e mësimdhënies</i>		<i>Orët totale në auditor</i>
a.	Leksione	275
b.	Seminare	102.5
c.	Detyra Praktike	57.5
d.	Leksione te hapura	35
e.	Kërkimi shkencor/Pune e pavarur	780
Në total		1250

- Format e kontrollit të njohurive (Tab. 12)

Tabela 12

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10% (bonus)
Plotësimi i detyrimeve (Prezantime individuale dhe ne grup)	1-2 Prezantime ose ese <i>Kusht per futjen ne provimin final</i>
Provimi përfundimtar	100%
Në total	100%

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret/ standartet
Standardi I.2 - Ngritja e vazhdueshme e nivelit teorik dhe nxitja e punës në grup e studentëve janë objektiva të një programi studimi të ciklit të tretë të doktoratës	
Kriteri 1	<p>Niveli i zhvillimit të kërkimit shkencor ndihmon në aftësimin e studentit për të përfunduar me sukses programin e studimit.</p>
Kriteri 2	<p>Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjekin studimet e doktoratës, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Përvetësimin e metodologjive të kërkimit për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, qasje standarde për referenca, bibliografi, indekse dhe të shkruarit e përmbajtjes si bazë për përpunimin e tezës së doktoratës; b) Punën e pavarur në laborator; c) Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe interneti) dhe administrimin e informacionit; d) Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; e) Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; f) Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën kërkimore të doktorantit.
	<p>Gjatë vitit të parë të studimeve të doktoraturës, studenti duhet të ndjekë dy kurse metodologjike: <i>Metoda Kërkimi 1</i> dhe <i>Metoda Kërkimi 2</i> në Shkencat Sociale. Pra përvec njohurive të përgjithshme në lidhje me kërkimin shkencor, studenti gjithashtu fiton njohuri në lidhje me specifikat e Shkencave Sociale. Këto njohuri i mundësojnë studentit të ndjekë dhe përfundojë me sukses ciklin e studimeve doktorale.</p> <p><i>Dita Doktorale</i> demonstroi më së miri kombinimin e qasjes individuale dhe të pavarur të punës kërkimore doktorale me udhëheqjen e shumëfishtë dhe integrimin e doktorantit në komunitet apo grup kërkimor. Gjithashtu detyrat me natyrë metodologjike brenda lëndëve përkatëse e përgatisin studentin më tej drejt aftësimit shkencor.</p> <p>a. Përvec lëndëve specifike në metodologji kërkimore-shkencore, secili pedagog përfshin kornizën specifike të metodologjisë së kërkimit, apo shkrimit shkencor për lëndët e veta specifike (prezantime individuale ose ese).</p> <p>c. Sipas pikës 9.1. të <i>Regullores</i> për organizimin e programeve të studimit të doktoratës, studenti ka të drejtë të shfrytëzojë burimet e informacionit të universitetit (si bibliotekën apo internetin).</p> <p>d. Prezantimet në klasë apo gjatë ditëve doktorale i mundësojnë studentit të familjarizohet me teknologjitë bashkëkohore.</p> <p>e. Studentët marrin njohuri të avancuara të metodave dhe përpunimit të të dhënave përmes lëndëve specifike të metodave.</p>

<p>Kriteri 3</p>	<p>Studentët e doktoratës marrin pjesë në aktivitetet e parashikuara të doktoratës jashtë punës kërkimore të tyre. Një doktorant është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligjërata; Seminare; Debate ndërdisiplinare, të organizuara në kuadër të programit të studimit të doktoratës; Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të studentëve të postdoktoratës dhe të projekteve kërkimore, madje edhe kur kjo nuk lidhet drejtpërdrejt me interesin e kërkimit të studentit. Udhëheqësit shkencorë i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre kërkimore. 	<p>f. Lëndët teorike, ese-të dhe prezantimet i mundësojnë doktorantit të aftësohet në lidhje me terminologjinë specifike të fushës.</p> <p>Doktorantët njoftohen në lidhje me aktivitetet e organizuara nga Fakulteti i Shkencave Sociale apo departamentet përkatëse përfshi këtu seminare, debate, workshope, konferenca të organizuara nga UET-i në fushën e studimit etj.</p>
<p>Kriteri 4</p>	<p>Studentët kanë fituar aftësi për komunikimin e duhur me nivel shkencor (Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të shkruar në mënyrë të qartë dhe me një stil të përshtatshëm; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikulimin e qartë të ideve para publikut të interesuar; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë në mësimdhënie, mbikëqyrje ose demonstrime).</p>	<p><i>Sipas Regullores për Organizimin e Programeve të Doktoraturës</i> (pikat 15.g dhe 15.h), udhëheqësit kanë për detyrë jo vetëm të nxisin studentin drejt aktiviteteve shkencore por edhe ta ndihmojnë atë në përgatitjen e punimit.</p>
<p>Kriteri 5</p>	<p>Studentët kanë fituar aftësi për komunikim korrekt me të tjerët, aftësi e nevojshme kjo për një studiues, por edhe në situata të tjera (të qenët në gjendje të zhvillojnë dhe të ruajnë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e punës me të tjerët, vetëdijesimin se si sjellja e tyre prek atë vetë dhe të tjerët dhe për të qenë i gatshëm për të dëgjuar, për të dhënë dhe për të marrë, me mprehtësi, reagimet dhe përgjigjet).</p>	<p>Përveç kurseve teorike të cilat kanë si parim bazë aftësimin e studentit për të komunikuar në mënyrë shkencore në disiplinën përkatëse, një mënyrë tjetër sesi Shkolla Doktorale e realizon këtë është përmes Ditës doktorale. Njëri nga objektivat kryesorë të këtij aktiviteti është të përgatisë studentin që të komunikojë në mënyrë sa më të qartë dhe shkencore në lidhje me punimin e tij.</p>
<p>Kriteri 6</p>	<p>Zhvillimi i aftësive të komunikimit të studentëve të doktoratës ka nxitur inkurajimin e tyre për angazhim në mësimdhënie në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë (p.sh. duke</p>	<p>Metodat pedagogjike, si prezantimet apo diskutimet në grup, përveç zhvillimit të mendimit kritik dhe analitik (shkëmbim</p>

	<p>u angazhuar në mësimdhënie si lektorë, në mbështetje të profesorëve udhëheqës të disertacionit të tyre).</p>	<p>opinionesh dhe perspektivash), mundësojnë gjithashtu edhe zhvillimin e aftësive praktike për të bashkëpunuar me të tjerët dhe për të qenë pjesë e grupit.</p> <p>UET-i ka angazhuar studentë në procesin e kryerjes së doktoratës në procesin e mësimdhënies në programet e ciklit të parë dhe të dytë, mbi bazën e një kontrate të përkohshme. Përfshirja dhe kohëzgjatja e angazhimit në aktivitetin e mësimdhënies përcaktohet në marrëveshje me profesorët udhëheqës, brënda mundësive dhe nevojave bazë të njësisë përgjegjëse për programin e doktoraturës (§ 20 e <i>Rregullores</i> për organizimin e programeve të studimit).</p> <p>Aktualisht, brenda Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit, janë angazhuar në mësimdhënie 11 doktorantë.</p>
--	---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Mësimdhënia gjatë vitit teorik të studimeve doktorale realizohet në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara nga APAAL. Në fund të vitit të formimit teorik, studenti është aftësuar si nga pikëpamja teorike edhe ajo metodologjike për të vazhduar dhe përfunduar me sukses programin e studimit. Gjithashtu, studenti ka fituar aftësi praktike për të prezantuar punime shkencore, për të punuar në grup apo për t'u angazhuar në mësimdhënie.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- o *Marreveshja e Partneritetit me British Council* (Aneksi XVII)
- o Dosja e aplikimit të kandidatit për “Doktor” në Mësimdhënie (Aneksi XVIII).

9. Studentët doktorantë

Pjesa përshkrimore

Kriteret akademike dhe procedurat e pranimit të studentëve doktorantë, si dhe cilësia apo numri i tyre në hyrje, janë përcaktuar qartë në Rregulloren e Organizimit të Programeve të Studimit të Doktoratës (UET) seksionet 6 & 7. Koha mesatare e zgjatjes së studimeve të doktoratës si rregull mbetet brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni apo udhëzimet e MASH, dhe përjashtime mund të bëhen (por nuk kanë ndodhur) për raste të vecanta sic është parashikuar në *Rregullore* (seksionet 10 & 12). Ndërkohë në lidhje me demografinë e studentëve doktoralë, mbi 35% e tyre vijnë nga Rajoni i Ballkanit (Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Turqia, etj.) duke pasuruar eksperiencën studimore në auditorë dhe në prezantimë të punës kërkimore të kryer në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna statistikore për studentët e pranuar: Numri total i doktorantëve të regjistruar dhe numri doktorantëve për çdo vit;
- Numri i doktorantëve të regjistruar që vijnë nga jashtë njësisë që ka hapur programin e studimeve të doktoratës;
- Numri, i shprehur në përqindje, i doktorantëve të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare;
- Numri, i shprehur në përqindje, i doktorantëve të regjistruar që vijnë nga rajoni i Ballkanit;
- Numri, i shprehur në përqindje, i doktorantëve të regjistruar që vijnë nga vendet e BE-së;
- Numri, i shprehur në përqindje, i doktorantëve të regjistruar që vijnë nga vende të tjera të botës (Tab. 13).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi I.3 - Pranimi i studentëve në një program studimi doktorate		
Kriteri 1	Studenti i pranuar në programin e studimit të doktoratës ka përfunduar me notë mesatare (> 80% të pikëve) ciklin e dytë të studimeve dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”/“Master i arteve të bukura” ose një diplomë ekuivalente me të, pas përfundimit të studimeve universitare që përfshijnë një tezë shkencore të vlerësuar me 30-40 kredite ECTS.	<i>Rregullorja</i> e UET-it (bashkëlidhur) parashikon kushtet e pranimit të studentit në doktoraturë, të cilat përputhen me kërkesat e kriterit 1.
Kriteri 2	Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, doktoratën, ka njohuri të thelluara teorike në fushën përkatëse të studimit. Disa nga njohuritë bazë që doktoranti ka, janë: a) Të menduarit krijues;	Propozimi doktoral është një mënyrë për të vlerësuar njohuritë teorike të aplikantit në fushën specifike (hyrja dhe bazimi teorik, bibliografia), intervista dhe konsultimi për të vlerësuar sensin

	<p>b) Zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit;</p> <p>c) Lidhjet mes fushave të ndryshme të kërkimit;</p> <p>d) Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;</p> <p>e) Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit.</p>	<p>kritik, të të menduarit krijues dhe original dhe aftësitë bazë problemzgjdhëse. Ndërkohë në vitin e parë ofrohet kurs i thelluar në teori dhe metoda për të zhvilluar më tej këto aftësi të doktorantit (<i>referohu më lart Programit të vitit I teorik</i>)</p>
Kriteri 3	<p>Studenti i pranuar në programin e studimeve të doktoratës është i gatshëm të zbatojë në praktikë dijet dhe njohuritë e fituara nga puna kërkimore në fushën përkatëse të studimeve.</p>	<p>Doktorantët në UËT janë të angazhuar në mësimdhënie, me qëllim shpërndarjen e njohurive të fituara gjatë studimeve doktorale (<i>Rregullorja, 20</i>).</p>
Kriteri 4	<p>Studenti zotëron gjuhën angleze të certifikuar në nivelin internacional, së paku “C1”, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare dhe një gjuhë të dytë të huaj si frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht ose rusisht. Në shkencat shoqërore mund të jetë gjuha latine, greqishtja e vjetër, persishtja ose ndonjë gjuhë tjetër e nevojshme për hulumtime në fushën përkatëse.</p>	<p>Në përputhje me udhëzimet e MASH, <i>Rregullorja</i> dhe kontrata me aplikantin shprehin qartësisht domosdoshmërinë e përvetësimit të gjuhës angleze në nivel të përcaktuar sipas rregulimeve ligjore (<i>Rregullorja, § 6.1c</i>). Në UET është ngritur partneriteti me <i>British Council</i> për të udhëhequr dhe mbështetur të gjithë të interesuarit të certifikojnë njohuritë e tyre në gjuhën angleze nëpërmjet testit IELTS.</p>
Kriteri 5	<p>Këshilli i Profesorëve ka përcaktuar kriteret për t’u pranuar në programin e studimeve të doktoratës të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të doktoratës.</p>	<p>Kriteri përmbushet plotësisht. Për detajë mund t’i referoheni <i>Regullores</i>, seksioneve 6 (për pranimet) dhe 7 (për përzgjedhjen e kandidatëve).</p>
Kriteri 6	<p>Aplikanti ka marrë informacion të detajuar për programin e studimit të doktoratës, para se të pranohet në të. Ai është plotësisht i informuar lidhur me:</p> <p>a) Kohëzgjatjen e programit të studimit;</p> <p>b) Kushtet që duhet të plotësojë studenti përpara paraqitjes në provimin e doktoratës;</p> <p>c) Mbështetjen që institucioni i siguron studentit nëpërmjet strukturave administrative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit (laboratorë, biblioteka, etj).</p> <p>d) Modalitetet e ushtrimit të veprimtarisë</p>	<p>Zyra e Informacionit ofron informacion paraprak në mënyra të ndryshme (broshurë, dërgesa elektronike, verbalisht dhe të kombinuara) dhe të plotë mbi detajet e programit.</p>

<p>Kriteri 7</p> <p>Kriteri 8</p>	<p>kërkimore apo krijuese të studentëve të doktoratës, veçanërisht lidhur me përgatitjen e tezës së doktoratës;</p> <p>Në kriteret e pranimit përfshihet edhe intervista dhe mbështetjet që mund të sigurohen nga referencat dhe dokumente të tjera shtesë.</p> <p>Në politikat e pranimit përfshihet edhe provimi i pranimit për doktoratë.</p>	<p>Referencat dhe dokumentat shtesë janë parakusht për lidhjen e kontratës dhe miratimin e kandidatures.</p> <p>Duke qene se nuk është një kusht i detyrueshëm sipas udhëzimeve të MASH-it, nuk është përfshirë në kushtet e pranimit.</p>
<p>Standardi II.5 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve në këtë cikël studimesh</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p>	<p>Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri të thelluara në fushën përkatëse shkencore; Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; Aftësi profesionale në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet kritike që lidhen me fushën e tij të kërkimit; Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese; Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja që nxisin kërkimin shkencor. <p>Studenti jep prova që me anë të kërkimit shkencor të realizuar, ai ka sjellë produkte shkencore origjinale, punime shkencore të një niveli të lartë shkencor, disa prej të cilave kanë merituar a meritojnë publikimin në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i studentëve të doktoratës bazohet mbi një vlerësim të produktit kërkimor shkencor të tij.</p> <p>Mbi bazën e një marrëveshjeje të arritur që në fazën e miratimit të programit të studimeve, rezultati i kërkimit të paraqitet si tezë disertacioni, ose kumulativ me 3 artikuj shkencorë të botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti me koeficient mbi 1.</p>	<p>Provat e zhvillimit të njohurive të thelluara në fushën specifike dhe të përafërta, aftësitë problemzgjdhëse, për inovacion dhe autonomi në kërkim shkencor vlerësohen në mënyrë cilësore dhe sasimore gjatë viteve të programit (provimet, ditët doktoale, takimet e monitorimit të progresit me udhëheqësit) dhe në përmbyllje të ciklit.</p> <p>Kjo vlerësohet nga Komisionet e <i>Ditëve Doktorale</i>, udhëheqësit dhe niveli i suksesit në botueshmëri të produkteve shkencore.</p> <p>Vlerësimi i jep peshën më të madhe punës origjinale kërkimore të doktorantit (<i>Rregullorja</i>, § 17).</p> <p>Forma standarte e mbrojtjes së doktoratës është ajo nëpërmjet tezës së disertacionit. Mrojtja dhe procedurat e lidhura me të, të cilat janë në përputhje me kriterin 5, jepen me detaje në seksionin 17 të <i>Rregullores</i>.</p>

<p>Kriteri 5</p>	<p>Në rastin e provimit në doktoratë me tezë disertacioni doktoranti ka plotësuar kushtet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ka realizuar si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare, në një vend perëndimor (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe i botuar në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je; Ka botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku, dy prej artikujve janë botuar ose pranuar për botim në revista të njohura perëndimore, me bord editorial; Ka përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e Profesorëve të fakultetit disertacionin, së bashku me një përmbledhje, të miratuar nga udhëheqësi shkencor. Struktura e disertacionit dhe e përmbledhjes së tij përcaktohen në rregulloren e studimeve të doktoratës. 	<p>Kriteri përmbushet. Për më tepër detaje, shih <i>Rregulloren</i>, seksioni 16 (“Formimi dhe funksionimi i jurisë për mbrojtjen e doktoratës”).</p>
<p>Kriteri 6</p>	<p>Këshilli i Profesorëve përcakton dy ose tre oponentë, një prej të cilëve është nga jashtë institucionit. Oponentët janë edhe anëtarë të jurisë për vlerësimin e disertacionit. Ata kanë titujt akademikë të kërkuar dhe një veprimtari kërkimore e botuese të pasur, brenda e jashtë vendit, në fushën përkatëse të studimeve në të cilën ofrohet edhe programi i studimeve të doktoratës.</p>	<p>Kriteri përmbushet (<i>Rregullorja</i>, § 16.2).</p>
<p>Kriteri 7</p>	<p>Nuk emërohen oponentë të cilët kanë pasur një përfshirje substanciale në punën e studentit të doktoratës, ose puna e të cilëve është vetë fokusi i projektit të kërkimit.</p>	<p>Kriteri do të përmbushet, siç parashikohet në <i>Rregullore</i>, § 13.4</p>
<p>Kriteri 8</p>	<p>Një kopje e disertacionit i jepet çdo oponenti, duke i dhënë kohën e mjaftueshme për ta lexuar dhe për të shkruar për të një raport të veçantë.</p>	<p>Juria, e miratuar nga drejtuesi i Shkollës Doktorale, zbaton rregullat etike profesionale të konfidencialitetit.</p>
<p>Kriteri 9</p>	<p>Oponentët nuk duhet të komunikojnë midis tyre, as me doktorantin ose me udhëheqësin shkencor të tij gjatë kësaj periudhe. Oponentët duhet të verifikojnë edhe vërtetësinë e të dhënave të përdorura në disertacion, respektimin e praktikës së</p>	<p>Juria voton në mënyrë të fshehtë dhe të pavarur gjatë procesit të vlerësimit të produktit shkencor. Në qoftë se një anëtar i vetëm i jurisë vë re shkaqe që mund të cojnë në vlerësim jokalues,</p>

	<p>punës kërkimore si edhe citimet e punimeve kërkimore dhe artikujve të autorëve të tjerë.</p>	<p>atëherë kandidati nuk kalon.</p>
Kriteri 10	<p>Oponentët shprehen qartë për pastërtinë e punimit shkencor nga plagjiatura. Në rast se vërejnë e konstatojnë se kjo ka ndodhur, ata kërkojnë ndërprerjen e vlerësimit të disertacionit.</p>	<p>Kriteri do të përmbushet, bazuar në udhëzimet e ngjashme të <i>Rregullores</i>, seksioni 13.</p>
Kriteri 11	<p>Disertacioni shoqërohet me një përmbledhje, rreth 10 faqe, në gjuhën angleze. Kjo përmbledhje shpallet në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën e caktuar për informimin për këtë program studimi.</p>	<p>Parashikuar në <i>Rregullore</i>, seksioni 16.</p>
Kriteri 12	<p>Udhëheqësi shkencor i studentit nuk duhet të jetë oponent.</p>	<p>Parashikuar në <i>Rregullore</i>, seksioni 16.</p>
Kriteri 13	<p>Kur oponentët kanë përfunduar raportet e tyre, ata thirren nga dekan i kryetari i Këshillit të Profesorëve për të rënë dakord për zhvillimin e provimit me gojë. Është e rekomandueshme, që një anëtar i jurisë së provimit të doktoratës të jetë nga universitete të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse, i cili ka së paku gradën shkencore “Doktor” të fituar në fushën shkencore në të cilën vazhdon studimet doktoranti dhe mbi 5 vjet përvojë akademike e kërkimore. Ky kriter mund edhe të mos zbatohet për shkencat albanologjike. Vlerësimi i doktorantit në provim bëhet i hapur me konsensus, me kusht që të gjithë anëtarët të jenë shprehur për një notë kaluese. Nëse, qoftë edhe një anëtar e ka vlerësuar, me argumente bindëse, doktorantin/ten me notë jokaluëse, edhe rezultati përfundimtar do të jetë jokaluës.</p>	<p>Parashikuar në <i>Rregullore</i>, seksioni 16.</p>
Kriteri 14	<p>Oponentët i dorëzojnë dekanit të njësisë që e organizon programin e studimeve të doktoratës dhe kryetarit të jurisë së provimit të doktoratës nga një kopje të raporteve individuale të tyre.</p>	<p>Kriteret 14-18 do të përmbushen, siç është specifikuar me detaje në <i>Rregullore</i>, seksioni 17 (“Mbrotjtja e Doktoratës”).</p>
Kriteri 15	<p>Mbrotjtja e disertacionit për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor” është publike. Ajo njoftohet së paku 4 javë përpara dhe bëhet në prani të anëtarëve të</p>	

	<p>departamentit, studentëve dhe pedagogëve të interesuar të Institucionit përkatës të Arsimit të Lartë.</p>	
<p>Kriteri 16</p>	<p>Vlerësimet që mund të bëjnë oponentët përfshijnë: dhënien e diplomës për gradën shkencore “Doktor”; ose riparaqitjen e punimit kërkimor me shkrim, pas plotësimit të rekomandimeve të tyre; ose një zgjatje të mëtejshme të programit të studimeve; ose refuzimin e dhënies së diplomës për gradën shkencore “Doktor”.</p>	
<p>Kriteri 17</p>	<p>Nga një kopje e disertacionit, të studentit që ka marrë diplomën për gradën shkencore “Doktor” të depozitohet në bibliotekën e fakultetit, të institutit kërkimor, qendrave kërkimore universitare, universitetit ku është realizuar programi i studimit dhe punimi shkencor dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare. Diploma për gradën shkencore “Doktor” nuk lëshohet pa u depozituar në institucionet e lartpërmendura disertacioni i botuar, në letër dhe në disk, (CD) dhe pa u bërë publik në faqen zyrtare të Institucionit përkatës të Arsimit të Lartë.</p>	
<p>Kriteri 18</p>	<p>Diploma për gradën shkencore “Doktor” nuk lëshohet pa u regjistruar më parë në Regjistrin Kombëtar të Doktoratave të Komisioni të Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) në MASH.</p>	

Konkluzionet e vlerësimit:

Kriteret në lidhje me pranimin e studentëve doktorale përmbushen në mënyrë të kënaqshme. Kriteret specifike janë analizuar dhe përbri janë parashtruar argumenta për përmbushjen e tyre, mbështetur në *Rregulloren* (në seksionë dhe pika specifike) e *Organizimit të Programeve të Doktoratës në UET*, e cila gjën mbështetje në ligjet dhe udhëzimet e nxjera nga MASH-i gjatë viteve 2007-2009.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- o Dosja e aplikimit të kandidatit për “Doktor” në Mësimdhënie (Aneksi XVIII).

POLITIKA E KERKIMIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT

10. Kërkimi shkencor dhe përfshirja e kërkimeve të studentëve të doktoratës

Pjesa përshkrimore

Në UET ekziston një pozicion i rëndësishëm, dedikuar posaçërisht *Kërkimit Shkencor* që lidhet me postin e Zv/Rektores për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë, post i cili synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor që nga Fakulteti/Departamentet, Shkolla Doktorale dhe pasurimi i përhershëm i Bibliotekës, si dhe ruajtja e standarteve të botimit në revistat shkencore të UET-it.

Kërkimi shkencor në UET zë një vend qendror dhe është baza e mësimdhënies e stafit pedagogjik. Kërkimi shkencor bazohet në tre shtylla: Shkollën Doktorale, Revistat shkencore si dhe në *Bibliotekën dhe Njësinë e Lëndëve Metodologjike në UET*, nga niveli Bachelor deri në atë Doktorat. Aktorët, të cilët përfshihen në të tre këto shtylla janë së pari departamentet, por edhe *Instituti për Studime dhe Politika Sociale*. Posti i Zv/Rektores për Kërkim Shkencor dhe Metodologji bashkëpunon ngushtë me *Qendrën UET për Projekte dhe Kërkim Shkencor*, me synim koordinimin e burimeve njerëzore për projekte të ndryshme kërkimore.

Shkolla Doktorale dhe Kërkimi Shkencor: Shkolla Doktorale ka një rëndësi kyçe, sepse nxjerr hulumtuesit dhe punonjësit e parë shkencorë të përgatitur në UET. Po ashtu, *Shkolla Doktorale* ofron udhëheqje shkencore për kandidatet doktorale dhe strukturon punën kërkimore të stafit pedagogjik sipas drejtimeve specifike kërkimore.

Në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale, *Shkolla Doktorale* në UET ka strukturuar kërkimin shkencor dhe drejtimin e punës kërkimore të kandidatëve doktoralë sipas drejtimeve kërkimore për secilin program të studimit. *Drejtimet kërkimore të Shkollës Doktorale* drejtohen nga pedagogje dhe studiues me gradën më të lartë dhe numrin më të madh të botimeve në fushën përkatëse dhe përfshijne si studentet doktorale ashtu edhe nga 1, 3 deri në 5 udhëheqes doktorale, sipas udhëzimeve të MASH-it (Udhëzimit nr. 21, në vitin akademik 2011-2012, dhe Udhëzimit nr. 22 në vitin akademik në vazhdim). *Konferencat doktorale* janë strukturuar sipas drejtimeve doktorale. Organizimi sipas drejtimeve kërkimore synon të arrijë të paktën tre objektiva:

Së pari, të prodhojë ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në një fushë të caktuar dhe të kthejë UET-in në një burim të vazhdueshëm dijesh dhe konsulence, si për komunitetin akademik ashtu edhe për aktorë të tretë;

Së dyti, rritjen profesionale të stafit akademik dhe kërkimor të UET-it brenda ekspertizave dhe fushave të tyre të interesit shkencor;

Së fundi, krijimin e një komuniteti (ose disa komuniteteve) kërkimore që ndërveprojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin në funksion të gjetjeve dhe analizave sa më të arrira dhe bindëse.

Revista Shkencore të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit në UET janë:

1. *Polis*- me bord editorial vendas dhe të huaj (profesorë nga universitetet e Astonit dhe Roehamptonit në Britaninë e Madhe);
2. *Sociological Analysis*- produkt i Institutit të Studimeve Sociologjike pranë UET-it, me bord editorial kryesisht të huaj, botohet integralisht në gjuhën angleze;
3. *Educatio*- është në proces të licensimit të jashtëm, me pjesëmarrje ndërkombëtare dhe botohet integralisht në gjuhën angleze.
4. Po punohet drejt lançimit të një reviste elektronike në anglisht që do të jetë *open-access*, ku studiuesit tane apo të universiteteve të tjera të botojnë *on line*.

Artikujt për botim në revistat shkencore të UET-it i nënshtrohen procesit të “blind review” ose recensimit anonim; kjo do të thotë që çdo artikull i ardhur në redaksi i shpërndahet nga

redaksia një specialisti më afër fushës së botimit. Çdo numër i revistave shkencore paraprihet nga një *Thirrje për Kontribute* të redaksisë. Revistat e cituara më sipër dalin një deri dy herë në vit.

Departamentet: Çdo Departament dhe Fakultet i dorëzon Zv/Rektore për Kërkim Shkencor dhe Metodologji në fillim të vitit akademik kalendarin e aktiviteteve shkencore (konferenca/*workshop*-e, kolokiume shkencore etj). Po ashtu, mbledhja e fundit e muajit (mbledhja javore) në çdo Departament ka për tematikë kërkimin shkencor brenda departamentit, zhvillime të reja në fushën e botimeve, promovimit dhe pjesëmarrjes së stafit në konferenca (ndër)kombëtare.

Universiteti Europian i Tiranës është duke zhvilluar projektet e mëposhtme:

- Projekti “**Shqipëria dhe Zhvillimi Rajonal i Bashkimit Europian**”, financuar dhe mbështetur nga Komisioni Europian në kuadër të programit të BE-së për *LifeLong Learning*. Për herë të parë *Programi Jean Monnet* aplikohet në Shqipëri nëpërmjet themelimit të *Jean Monnet Chair* pranë UET-it. Qëllimi i *Jean Monnet Chair* është të zhvillojë njohuri teorike dhe praktike si dhe ekspertizë mbi Bashkimin Europian dhe zhvillimin rajonal midis studentëve, akademikëve, shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale, duke synuar rritjen e kapaciteteve shqiptare për të përfituar nga fondet strukturore në kuadër të integritimit në Bashkimin Europian. Aktivitetet kryesore në projekt, për jetëgjatësinë e tij 2012-2015, janë:
 - i. Organizimi i “*Doctoral Colloquiums*”. Në këto aktivitete, studentët e doktoraturës në UET, të cilët kanë projekte kërkimore të lidhura me Bashkimin Europian dhe Zhvillimin Rajonal, zhvillojnë seanca diskutimi mbi projektin e tyre doktorat. Këto seanca synojnë, ndër të tjera, përfshirjen e aktorëve të tretë, ekspertë në fushat përkatëse, në zhvillimin dhe progresin e kërkimit shkencor;
 - ii. Botimi i artikujve shkencorë me tematika të Bashkimit Europian dhe Zhvillimit Rajonal në revistat akademike të UET-it si dhe më gjerë nga stafi kyç i projektit si dhe nga studentët doktorantë, duke përfshirë botime *on line* në faqen Jean Monnet (<http://uet.edu.al/index.php/it/jean-monnet-chair-home>) si dhe në shtyp (gazeta MAPO);
 - iii. Pjesëmarrja e studentëve të doktoraturës në tryeza të rrumbullakta me aktorë të tjerë të qeverisë, sektorit privat, shoqërisë civile në fushën e *Zhvillimit Rajonal*, ku diskutohen tema të lidhura me proceset e aksesimit, fondeve strukturore, politikave të BE-së etj.
- Projekti “**Studimi i Qëndrueshmërisë Kulturore**” (COST) në sferën *Individët, Shoqëritë, Kulturat dhe Shëndeti* (ISCH). UET është institucioni i vetëm nga një vend jo-COST, i ftuar të marrë pjesë në Aksionin IS1007, në bashkëpunim me 23 institucione të BE-së. COST (Bashkëpunimi Europian për Shkencë dhe Teknologji) është një nga programet më të hershme europiane që mbështesin bashkëpunimin midis shkencëtarëve dhe kërkuesve në Europë.
- UET-i drejton gjithashtu **Projektin kërkimor rajonal në kuadër të RRPP-së** “*Fëmijët e rrugës në Shqipëri, Bosnie Hercegovinë, Maqedoni dhe Kosovë; Hapësira dhe identite në përpyekjen për mbijetesë*” (qershor 2012-qershor 2013). Programi i *Promovimit të Kërkimit Rajonal (RRPP)* koordinohet nga Universiteti i Fribourg-ut në Zvicër dhe financohet nga *Agjencia Sviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim*. Ky projekt kërkimor analizon dinamikat e mënyrave të jetesës dhe larmishmërinë e profileve të “fëmijëve” të rrugës në rajon, duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në proceset e shoqërizimit dhe ndërtimit të identiteteve në hapësirën e “rrugës”. Projekti përfundon me botimin e studimit si dhe me organizimin e një Konference Rajonale, ku marrin pjesë të gjithë partnerët në projekt, udhëheqësi shkencor ndërkombëtar, përfaqësues nga RRPP-ja, Universiteti i Fribourg-ut e të tjerë subjekte kërkimore-shkencore të interesuar.

- UET-i është pjesë e Koncorciumit të projektit **Tempus** (Skema IV: 2011-2014) “*Vendosja e të drejtave të njeriut në zemër të arsimit të lartë*”, drejtuar nga Universiteti i Roehampton-it në Britani. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të mbështesë themelimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të programeve shumedisiplinore të Edukimit, të cilat përqëndrohen në fushën e të drejtave të njeriut dhe qytetarisë për nivelin universitar dhe pasuniversitar në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt përfshin 11 universitete nga Shqipëria, Serbia, Kosova, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Gjermania, Suedia, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar.
- UET-i organizon **Forum e Librit Akademik** “*51 tituj akademikë-51 ide inovatore për zhvillimin e politikave në Shqipëri*”. Qëllimi i këtij projekti është të nxisë zhvillimin e debatit në hapësirën publike mbi mirëqeverisjen dhe proceset e demokratizimit, përmes diskutimeve interaktive dhe të hapura rreth titujve akademikë e shkencorë të botuar në Shqipëri. Projekti vjen si nismë e një grupi kërkuesish, lektorësh, studentësh doktorantë në UET që marrin pjesë aktive në këtë *Forum* përmes recensave/diskutimeve rreth titujve akademikë/shkencorë. Ky projekt realizohet si një veprim i përbashkët i UET-it/ *UET Press*-it, *Institutit të Dialogut dhe Komunikimit*, *Institutit Shqiptar të Medias*, *Institutit Shqiptar për Studime Ndërkombëtare* dhe disa shtëpive botuese (55, Onufri, Dituria, Toena, Dudaq).
- UET-i ka iniciuar aktivitetet në kuadër të **RCE Albania** (Qendra Rajonale e Ekspertizës për Edukimin në Zhvillimin e Qëndrueshëm), në bashkëpunim me Universitetin e Kombeve të Bashkuara në Japoni (UNU-IAS), duke u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të RCE-ve. RCE synon realizimin e aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe zhvillimore në fushën e Edukimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat mbështesin- ndër të tjera- edhe veprimtarinë akademike e shkencore të studentëve të doktoratës në UET.
- Këshilli Britanik dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, në bashkëpunim me *Qendrën UET për Zhvillim dhe Kërkim*, realizuan projektin kërkimor “**Zhvillimi i gjuhës angleze në arsimin e lartë në Shqipëri**” si një instrument për arritje të suksesshme akademike dhe profesionale të studentëve në nivel kombëtar dhe Europian. Ky projekt kërkimor interesohet për dinamikën e përdorimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek mësimdhënia dhe përvajtja e mësimnxënies, si për stafin pedagogjik ashtu edhe për studentët në mjedisin universitar. Një takim prezantues për studimin u organizua në dhjetor 2012 dhe ai u publikua *on line*.
- Në kuadër të themelimit të *Katedrës Jean Monnet* në UET, në bashkëpunim me Shoqatën e Ish-Anëtarëve të Parlamentit Europian, në kuadër të programit “**European Parliament to Campus**”, organizuan vizitën dy-ditore të Z. Jens-Peter Bonde në Shqipëri. Z. Bonde ka një eksperiencë të gjerë dhe kontribut të çmuar në strukturat dhe politikën e Bashkimit Europian, duke qenë anëtar i Parlamentit Europian për periudhën 1979-2008, ku për 17 vjet ka mbajtur pozicionin e kryetarit të Grupit të PPE. Z. Bonde është autor i mbi 60 librave mbi Bashkimin Europian. U organizuan:
 - i. Leksioni i hapur me studentë e lektorë me temë: “*Rinia dhe Integrimi në Bashkimin Europian: Perspektiva dhe Sfida*”;
 - ii. Tryeza e Rrumbullakët: “*Shqipëria drejt Bashkimit Europian përmes Zhvillimit Rajonal*” u zhvillua me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve qeveritare, si dhe kërkues dhe doktorantë në fushën e integritit europian dhe zhvillimit rajonal;
 - iii. Takim me Kryetarin e Komisionit Parlamentar të Integritit Europian, z. Ditmir Bushati, me qëllim ndarjen e pikëpamjeve dhe qëndrimeve mbi procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian;
 - iv. Z. Bonde mori pjesë në disa emisione në mediat lokale e kombëtare.

Universiteti Europian i Tiranës në bashkëpunim me partnerë të tjera ka organizuar këto aktivitete në fushën kërkimore me pjesëmarrjen e studentëve të Shkollës Doktorale:

- Tryeza e rrumbullakët “*Ide të reja për sipërmarrje të reja*”, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit mes qeverisë, akademisë dhe biznesit. Partnerë në aktivitet: *Fondacioni ABC* dhe *Instituti i Shërbimeve të Konsulencës Menaxheriale* (nëntor 2012);
- Tryeza e rrumbullakët “*Anti-Korrupsion*”, në bashkëpunim me *Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara* (UNDP), ku u diskutua roli i universiteteve në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri dhe mirëqeverisjen (dhjetor 2012);
- Tryeza e rrumbullakët “*Kërkimi dhe Politikëbërja për gjithëpërfshirjen shoqërore në Shqipëri*”, në bashkëpunim me UNICEF-in në Shqipëri, ku u diskutuan mekanizmat e ndikimit të kërkimit në politikëbërje dhe rritja e rolit të universitetit në politikat e gjithëpërfshirjes shoqërore (shkurt 2013).

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tab. 13)

Tabela 13

<i>Aktivite të planifikuara individuale dhe në rang institucioni në 2 vitet e fundit</i>		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i <i>IAL</i>	74 botime shkencore (artikuj dhe libra, monografi ose autore te pare) te stafit efektiv si dhe 68 kumtime ne konferenca brenda dhe jashte vendit ne dy vitet e fundit akademike te Shkolles se Doktoratures (2011-2012/ 2012-2013).
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	3 (RRPP+B.C+COST)
3.	Numri i projekteve të zbatuara	8 (5 projekte ne vitin akademik 2011-2012; 3 projekte ne 2012-2013)
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga <i>IAL</i>	21 (6 nga Fakulteti i Shkencave dhe Edukimit)
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda <i>IAL</i> -it	53 doktorantë
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Tempus/Jean Monnet
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	5
8.	Numri i çmimeve kombëtare	-

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor		
Kriteri 1	Një program studimi i ciklit tretë (doktoratë) është i integruar në veprimtarinë kërkimore të Institucioneve të Arsimit të Lartë.	Po

<p>Kriteri 4</p>	<p>Institucioni ka kapacitetin për të kryer udhëheqjen e çdo studenti të doktoratës në aktivitetet e kërkimit dhe detyrat respektive didaktike.</p>	<p>Udhëheqësi shkencor me titullin akademik "Profeësor", i punësuar me kohë të plotë, udhëheq njëkohësisht jo më shumë se pesë doktorantë. Udhëheqësi shkencor me titullin akademik "Profesor i Asociuar" dhe udhëheqësi shkencor me gradën shkencore Doktor ("PhD) të fituar pranë universiteteve perëndimore, i punësuar me kohë të plotë, udhëheq njëkohësisht jo më shumë se dy doktorantë. Udhëheqësi me titullin akademik "Profesor", i punësuar me kohë të pjesshme, udhëheq vetëm një doktorant.</p>
<p>Kriteri 5</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione të tjera akademike e kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që mbështesin shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës si dhe veprimtaritë akademike e kërkimore të shkollës së doktoratës.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ka iniciuar aktivitetet në kuadër të <i>RCE Albania</i> (Qendra Rajonale e Ekspertizës për Edukimin në Zhvillimin e Qëndrueshëm), në bashkëpunim me Universitetin e Kombeve të Bashkuara në Japoni (UNU-IAS), duke u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të RCE-ve. <i>RCE</i> synon realizimin e aktivitetve të përbashkëta akademike dhe zhvillimore në fushën e Edukimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të cilat mbështesin ndër të tjerave edhe veprimtarinë akademike e shkencore të studnetëve të doktoratës në UET.</p> <p>Universiteti European i Tiranës ka një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Fribourg-ut në lidhje me realizimin e projektit kërkimor të RRPP-së për "<i>Fëmijët në situatë rruge</i>". UET-i ka gjithashtu një marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin European për projektin e ndërtimit të Katedrës <i>Jean Monnet</i> si dhe bashkëpunon me Universitetin e Roehampton-it (Londër, UK) dhe 11 universitete të tjera partnere në Projektin "<i>Tempus</i>" për të Drejtat e Njeriut në Arsimin e Lartë, i cili parashikon shkëmbim të stafit dhe studentëve ne mes universiteteve partnere.</p>

<p>Kriteri 6</p>	<p>Personeli akademik duhet të tregojë arritjet në fushën kërkimore përmes veprimtarive krijuese të tilla si: referime, botime shkencore, revista, libra a monografi.</p>	<p>Në nenin 67 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në institucionet e Arsimit të Lartë, thuhet midis të tjerash, shprehimisht: “Institucionet e Arsimit të Lartë kryejnë kërkim shkencor bazë ose të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese në mënyrën e përcaktuar në Statutin e institucionit të Arsimit të Lartë”, sipas objektivave specifikë të institucionit përkatës.</p> <p>Personeli akademik në UET ka një aktivitet të pasur shkencor, në sajë të të cilit bëhet e mundur mbështetja e doktorantëve që ata kanë në udhëheqje. Ky aktivitet shprehet së pari në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në institucionin tonë, perkatesisht ne Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit. Në dy vitet e fundit kemi këto aktivitete të rëndësishme, ku kanë marrë pjesë doktorante:</p> <p>Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. “<i>Pluralizmi politik në Shqipëri; 20 vjet pas ligjërimit të pluralizmit</i>” (nëntor 2011); 2. “<i>Negotiating of Modernity</i>” (qershor 2012); 3. “<i>Siguria Njerëzore</i>” (qershor 2012). <p>Departamenti i Komunikimit dhe i Marrëdhënieve me Publikun ka organizuar Konferencen: “<i>Mediat dhe Audienca</i>” (maj 2012) dhe ka lançuar <i>call for papers</i> për një Konferencë Ndërkombëtare në qershor 2013.</p> <p>Departamenti i Edukimit ka organizuar Konferencen Nderkombetare: “<i>Arsimi i Lartë; Masivizimi dhe sfidat e tij drejt Integritimit Evropian</i>” (tetor 2012).</p> <p>Artikujt për botim në revistat shkencore të UET-it i nënshtrohen procesit <i>blind review</i> ose recensimit anonim; kjo do të thotë që cdo</p>
-------------------------	---	---

<p>Kriteri 7</p>	<p>Tregues të veprimtarisë kërkimore të nivelit të lartë janë publikime që përmbajnë citime nga veprimtaria botuese e kërkimore-shkencore nga studiues të tjerë jashtë programit të studimit të doktoratës, sidomos ndërkombëtarë, lidhur me rezultatin e kërkimit shkencor në institucionin që ofron programe të doktoratës.</p>	<p>artikull i ardhur në redaksi i shpërndahet nga redaksia një specialisti më afër fushës së botimit. Çdo numër i revistave shkencore të Fakultetit (shih me lart) paraprihet nga një <i>‘Thirrje për Kontribute’</i> të redaksisë.</p> <p>Veç këtyre aktiviteteve, çdo pedagog ka planifikimin e vet të pavarur për pjesëmarrje në aktivitete/konferenca ndërkombëtare dhe për botime; disa prej tyre kanë botuar tashmë libra mesimore dhe monografi (15 botime shkencore si monografi ose libra si autore të pare dhe 25 artikuj shkencore, 53 kumtesa të stafit në konferenca dhe aktivitete shkencore).</p> <p>Ka disa punime të pedagogëve të UET që janë cituar nga studiues të tjerë jashtë programit të studimit të Doktorates, të cilat mund të verifikohen në Internet.</p>
-------------------------	---	--

Standardi III.1.1 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij

<p>Kriteri 1</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Fakulteti ka në dispozicion <i>Aksin Doktorat</i> të secilit pedagog në harkun e 5 viteve si dhe një bazë të plotë të dhënash të punës kërkimore, botimeve dhe pjesëmarrjeve me kumtesa në konferenca brenda dhe jashtë vendit të stafit në fund të çdo viti shkollor.</p>
<p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p><i>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit</i> në UET disponon një bazë të dhënash (Excel spreadsheet) me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimit, ndërtim-kapacitetesh etj., në të cilat ka marrë pjesë ose është aktualisht i përfshirë personeli akademik si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme.</p>
<p>Kriteri 3</p>	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Baza e të dhënave përmban detaje për projektin, donatorin, për partnerët, për personelin akademik të përfshirë etj.</p>

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij

<p>Kriteri 1</p>	<p>Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Universiteti organizon në mënyrë periodike <i>Staff Development Day</i> (Ditën e Zhvillimit të Stafit), me synim trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet, metodologjinë dhe <i>TIK</i>-un.</p>
<p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Anëtarë të stafit akademik të Fakultetit marrin pjesë në <i>Programin European për Shkencë dhe Teknologji</i> (COST).</p> <p><i>Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit</i> është e angazhuar për të përfshirë stafin akademik në projekte kërkimore të lancuara nën programin FP7, në <i>konsortium</i>-e me partnerë ndërkombëtarë. Kjo Zyrë në UET përgatit dhe shpërndan rregullisht te personeli akademik informacion në lidhje me mundësi aplikimi për programe kërkimore, trajnime dhe kualifikime si dhe ofron konsulencë për zhvillimin e aplikimeve.</p> <p>Anëtarë te stafit akademik marrin pjesë në trajnimet për metodologjinë në kërkimin shkencor në shkencat sociale në kuadër të <i>Programit të Promovimit të Kërkimit Rajonal</i> (RRPP).</p> <p>Ne kuader të projektit “Tempus” <i>‘Zhvillimi i të Drejtave të Njeriut në Zemër të Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor’</i>, pedagogët që japin lëndët më afër problematikës se <i>Te Drejtave të Njeriut</i> do të trainohen nëpërmjet ‘staff mobility schemes’ mes universiteteve të <i>konsorcium</i>-it.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

* *Kriteri 1*- Është realizuar. Ka një integrim të aktivitetit shkencor të Shkollës Doktorale dhe të aktivitetit shkencor të pedagogëve e, si rrjedhim, të Universitetit;

* *Kriteri 4*- Është realizuar, duke marrë parasysh ligjin ne fuqi kur është krijuar Shkolla

Doktorale në UET;

Kriteri 5- Në bazë të lidhjeve/ partneritetve të UET-it me universitetet dhe institucione të tjera janë të gjitha mundësitë që këto lidhje të mbështesin aktivitetin doktoral në UET;

* *Kriteri 6-* Eshtë realizuar. Ka një aktivitet të pasur referues dhe publikues të pedagogëve, doktorantëve si dhe punë të përbashkët të tyre;

* *Kriteri 7-* Është realizuar.

11. Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar në funksion të programit të doktoratës

Pjesa përshkrimore:

Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit është e angazhuar për të përfshirë studentët e doktoraturës në UET në projekte kërkimore të lancuara nën programin FP7, në Konsortiume me partnerë ndërkombëtarë. Gjithashtu programi TEMPUS është një mjet, me anë të të cilit *Zyra për Zhvillimin e Projekteve dhe Kërkimin* përfshin studentë të doktoraturës në projekt-propozimet e *Thirrjes VI* të shpallur. Projekti *COST* është gjithashtu një dritare e hapur për bashkëpunim midis studentëve doktorantë në UET dhe rrjeteve të kërkimit shkencor (Actions) të krijuara nën projektet e këtij programi, falë pjesëmarrjes së UET në një prej Aksioneve të ngritura të *COST*.

Numri i orëve mësimore të zhvilluara nga lektorë të huaj

- Leksion i hapur: *“Rinia dhe integrimi në Bashkimin Europian; Perspektiva dhe sfida”* organizuar nga Universiteti Europian i Tiranës në kuadër të themelimit të Katedrës *Jean Monnet Chair* në UET dhe programit *“Parlamenti Europian në Kampus Universitar”*, me pjesëmarrjen e Z. Jens-Peter Bonde, ish-anëtar i Parlamentit Europian (13 nëntor 2012).

Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit

- Në kuadër të projektit kërkimor të *Programit të Promovimit të Kërkimit Rajonal (RRPP)*, Universiteti i Fribourg-ut nën mandatin e Agjencisë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, **4 doktorantë** nga UET ka marrë pjesë në trajnimin për *“Metodat Sasiore”*, të zhvilluar më 13-16 shtator 2012 në Prishtinë dhe në atë për *“Metodat Cilësore dhe Shkrimin e Projekteve Shkencore”* më 10-12 prill 2013 në Shkup.
- Në kuadër të projektit për transferimin e kurrikulave për Zgjidhjen e Konfliktëve të Universitetit të Columbia-s në Ballkanin Perëndimor, **2 doktorantë** morrën pjesë në seminarin e zhvilluar për *“Metodologjinë e Mësimdhënies dhe Kurrikulat për Zgjidhje Konfliktesh në Tetovë”* (25-28 mars 2013).

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në rrafsh UET-i (Tab. 14)

Tabela 14

Aktivite shkencore në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar		
1	Numri i studentëve pjesëmarrës si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	20
2	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	68
3	Numri i lektorëve të huaj që janë angazhuar në mësimdhënie/ udhëheqje (në rrafsh Fakulteti)	4
4	Numri i orëve mësimore të zhvilluara nga lektorë të huaj	286
5	Numri i pjesëmarrësve në trajnime në fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	6
6	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	-
7	Numri i çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor	-

- Bashkëpunimi me institucionet shkencore, tetor 2011 e në vazhdim, për të tre Fakultetet (Tab. 15)

Tabela 15

<i>Institucionet dhe Organizatat shkencore bashkëpunuese</i>	
Swiss Agency for Development	Donatorë
British Council	Partnerë/Donatorë
USA Embassy	Donatorë
European Commission	Donatorë
COST	Donatorë
University of Fribourg	Donatorë
University of Mannheim	Partnerë
University of Gothenburg	Partnerë
University of Sarajevo	Partnerë
University of Zenica	Partnerë
University of Kragujevac	Partnerë
University of Novi Sad	Partnerë
University of Beograd	Partnerë
University of Donja Gorica	Partnerë
University of Montenegro	Partnerë
National University Ireland	Partnerë
University of Pristina	Partnerë
International Business School Budapest	Partnerë
Koblenz-Landau University	Partnerë
University of Potsdam	Partnerë
Munich University of Applied Sciences	Partnerë
University of Thessaly	Partnerë
University of Wageningen	Partnerë
Van Hall Larenstein University of Applied Sciences	Partnerë
Scottish Agricultural College	Partnerë
Staffordshire University	Partnerë
FHS St.Gallen, Hochschule für Angewandte Wissenschaften	Partnerë
Charls University	Partnerë
University of Jyvaskyla	Partnerë
University of Warsaw	Partnerë
University of Salento	Partnerë
University of National and World Economy	Partnerë
Foundation for European Policy Studies	Partnerë
Risk Monitor Foundation	Partnerë
University of Zagreb	Partnerë
Universiteti Cyril & Metodius	Partnerë
Everis Spain	Partnerë
Center for Security Studies, Serbia	Partnerë
Internative Progressive Education, Kosovo	Partnerë
South East European University, Maqedoni	Partnerë

Mediterranean University Podgorica, Maqedoni	Partnerë
New Business Education Foundation, Maqedoni	Partnerë
EMBRA, Maqedoni	Partnerë
Group for Legal and Political Studies, Kosovë	Partnerë
PVPU Euro College, Maqedoni	Partnerë
Univeristeti Westminster, Londër	Partnerë
Burgas Free University	Partnerë
Universitatea de Vest din Timisoara, Romania	Partnerë
Universiteti i Lubjanës, Slloveni	Partnerë
Università di Foggia, Itali	Partnerë
R C E - Education for Sustainable Development Graz-Styria University of Graz, Austri	Partnerë

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar për të tre Fakultetet (Tab. 16)

Tabela 16

<i>Aktivite shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit</i>		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare.	2 (<i>Cost, Tempus</i>)
2	Numri i leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore.	286 (78 në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit)
3	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL-it	<u>2011-2012</u> S'ka.
4	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	Zv/Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë; Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit, e cila koordinon <i>Rrjetin UET</i> që përfshin: - Qendra Rajonale e Ekspertizës për Zhvillimin e Qëndrueshëm; - Instituti i Studimeve Strategjike dhe Sigurisë; - Instituti i Studimeve Sociale dhe të Politikave; - Qendra për Studime Gjinore; - Asociimin me Think Tank "Qendra UET" - Revistat shkencore ("Polis", "Sociological Analysis"; "Educatio").
5	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL-it/ jashtë vendit dhe prezantime	10 pjesëmarrje jashtë vendit për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit.

6	Numri i çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Alumni Grant Program (AGP) of the Open Society Foundations Scholarship Programs for the year 2013 – Research Project Award: ‘Measuring and Promoting Internal Party Democracy in Albania’;</i> - <i>Winning research project of the Global Research Competition held under the Global Research Capacity Building Programme (Global Development Network): ‘To what extent has the Albanian and Kosovo party system institutionalized since democratization?’;</i> - <i>Winning research project supported by Open Society Foundation for Albania ‘Inclusive Education’.</i>
---	--	---

Tabela 17

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
<i>Institucionet qeveritare bashkëpunuese</i>	<i>Lloji i bashkëpunimit</i>
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	Donatorë
12 Qarqet e Shqipërisë	Partnerë
Bashkia e Tiranës	Partnerë
Agjencia për Kërkimin, Teknologjinë dhe Inovacionin	Partnerë
Instituti i Trajnimit të Administratës Publike	Partnerë
<i>Organizatat Profesionale</i>	
SOROS	Donatorë
British Council	Partnerë/Donatorë
USA Embassy	Donatorë
European Commission	Donatorë
COST	Donatorë
University of Fribourg	Donatorë
University of Mannheim	Partnerë
University of Gothenburg	Partnerë
University of Sarajevo	Partnerë
University of Zenica	Partnerë
University of Kragujevac	Partnerë
University of Novi Sad	Partnerë
University of Beograd	Partnerë
University of Donja Gorica	Partnerë
University of Montenegro	Partnerë
National University Ireland	Partnerë
University of Pristina	Partnerë
Koblenz-Landau University	Partnerë

	University of Potsdam	Partnerë
	Munich University of Applied Sciences	Partnerë
	University of Thessaly	Partnerë
	University of Wageningen	Partnerë
	Van Hall Larenstein University of Applied Sciences	Partnerë
	Staffordshire University	Partnerë
	FHS St.Gallen, Hochschule für Angewandte Wissenschaften	Partnerë
	Charls University	Partnerë
	University of Jyvaskyla	Partnerë
	University of Warsaw	Partnerë
	University of Salento	Partnerë
	Foundation for European Policy Studies	Partnerë
	Risk Monitor Foundation	Partnerë
	University of Zagreb	Partnerë
	Universiteti Cyril & Metodius	Partnerë
	Mobility IT, Italy	Partnerë
	Gruppo Sigla, Italy	Partnerë
	Everis Spain	Partnerë
	Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli	Partnerë
	Center for Security Studies, Serbia	Partnerë
	International Progressive Education, Kosovo	Partnerë
	Association Alumni of the Center for Interdisciplinary Postgraduate Studies, Bosnie Hercegovinë	Partnerë
	South East European University, Maqedoni	Partnerë
	Mediterranean University Podgorica, Maqedoni	Partnerë
	EMBRA, Maqedoni	Partnerë
	Group for Legal and Political Studies, Kosovë	Partnerë
	PVPU Euro College, Maqedoni	Partnerë
<i>Komuniteti i biznesit, tregu i punës</i>		
	ABC	Donatorë
	BRIC-AIDA	Donatorë/ Partnerë

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, Tregun e Punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi III.4 - Internacionalizimi i programit të studimeve të doktoratës		
Kriteri 5	Programi i studimeve të doktoratës inkurajon mobilitetin e doktorantëve duke marrë përsipër një masë të konsiderueshme të shpenzimeve për formim akademik jashtë programit të studimeve të doktoratës.	Universiteti European i Tiranës ka iniciuar aktivitetet në kuadër të <i>RCE Albania</i> (Qendra Rajonale e Ekspertizës për Edukimin në Zhvillimin e Qëndrueshëm), në bashkëpunim me Universitetin e Kombeve të Bashkuara në Japoni (UNU-IAS), duke u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të <i>RCE-ve</i> .
Kriteri 6	Programi i studimeve të doktoratës inkurajon mobilitetin e doktorantëve duke marrë përsipër një masë të konsiderueshme të shpenzimeve për prezantimin e rezultateve të kërkimit në veprimtari shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres).	Në kuadër të projektit kërkimor të <i>RRPP-së</i> , Dr. Paula Mayock shërben si udhëheqëse shkencore (international mentor) e dy doktorantëve të angazhuar në këtë projekt. Ajo është Profesor i Asociuar/ Senior Lektore në Trinity College, Dublin – Ireland.
Kriteri 7	Institucioni ka marrëveshje së paku me një universitet perëndimor, që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës, si edhe realizim të projekteve kërkimore të përbashkëta. Për shkencat albanologjike bashkëpunimi mund të jetë edhe me një Institucion të Arsimit të Lartë apo qendër kërkimore në Kosovë dhe në trojet shqiptare.	Me Universitetin e Astonit ne Britanine e Madhe (shih me siper).
Kriteri 8	Programi i studimeve të doktoratës krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimeve të doktoratës me universitete homologe në rajon, Evropë e më gjerë.	Po
Kriteri 9	Programi i studimeve të doktoratës parashikon zhvillimin e 3-4 moduleve (jo më pak se 15 ECTS) në studimet e organizuara teorike dhe marrjen në provim të doktorantëve nga pedagogë të universiteteve partnere të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse të studimeve. Për	

<p>Kriteri 10</p>	<p>shkencat albanologjike vlen përjashtimi i cituar në kriterin 7.</p> <p>Programi i studimeve të doktoratës nxit përfshirjen e profesorëve nga universitete të huaja si udhëheqës shkencorë ose si bashkëpunëtorë shkencorë të doktorantëve.</p>	<p>Deri tani asnjë për Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit.</p>
<p>Standardi II.1 - Kapacitetet për kërkim shkencor</p>		
<p>Kriteri 5</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje me institucione të tjera akademike e kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që mbështesin shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës si dhe veprimtaritë akademike e kërkimore të shkollës së doktoratës.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës ka iniciuar aktivitetet në kuadër të RCE Albania, (Qendra Rajonale e Ekspertizës për Edukimin në Zhvillimin e Qëndrueshëm), në bashkëpunim me Universitetin e Kombeve të Bashkuara në Japoni (UNU-IAS), duke u bërë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të RCE-ve. RCE synon realizimin e aktivitetve të përbashkëta akademike dhe zhvillimore në fushën e Edukimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat mbështesin, ndër të tjera, edhe veprimtarinë akademike e shkencore të studentëve të doktoratës në UET.</p> <p>Universiteti European i Tiranës ka një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Fribourg-ut në lidhje me realizimin e projektit kërkimor të RRPP-së për “fëmijët në situatë rruge”.</p> <p>Universiteti European i Tiranës bashkëpunon me Universitetin e Roehampton-it (Londër, UK) dhe me 11 universitete të tjera partnerë në Projektin <i>Tempus</i> për të Drejtat e Njeriut në Arsimin e Lartë. Projekti parashikon shkëmbim të stafit dhe studentëve mes universiteteve partnere si</p>

	dhe midis U. Roehampton dhe UET-it.
--	-------------------------------------

Konkluzionet e vlerësimit:

- Ka një integrim të aktivitetit shkencor të Shkollës Doktorale dhe të aktivitetit shkencor të pedagogëve, e si rrjedhim të Universitetit, duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi, qysh në momentin kur u krijua kjo *Shkolle*.
- Në bazë të lidhjeve dhe partneriteteve të UET-it me universitetet dhe institucione të tjera, janë të gjitha mundësitë që këto lidhje të mbështesin aktivitetin doktoral në UET.
- Në kuader të Shkolles Doktorale ka një aktivitet të pasur referues dhe publikues të pedagogëve, doktorantëve si dhe punë të përbashkët të tyre.

Kriteret 5-7 janë realizuar. Mbështetja financiare për aktivitete të ndryshme të doktorantëve mbështetet në marrëveshjet e UET-it me universitete të huaja, si ajo midis *Centre for Europe University*, Birmingham/ UK dhe Universitetit European të Tiranës.

Kriteri 8- Potencialisht janë krijuar të gjitha premisat që Shkolla Doktorale e UET-it të zhvillojë më tej marrëveshjet tashmë ekzistuese me universitete të ndryshme të Europës për shkëmbim studentësh. Këtu mund të theksojmë iniciativën që çdo pedagog udhëheqës mund të shfrytëzojë lidhjet me universitetet europiane në dobi të udhëheqjeve të veta në nivelin e doktoraturës.

Kriteri 9- Eshtë realizuar, ka pedagogë të huaj që zhvillojnë leksione në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe të Edukimit, në atë raport që kërkohet.

Kriteri 10- Potencialisht janë krijuar gjithë premisat që Shkolla Doktorale e UET-it të zhvillojë më tej marrëveshjet tashmë ekzistuese me institucione të tjera akademike e kërkimore, brenda dhe jashtë vendit.

ANALIZA SWOT

RVB mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVB**” sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

1) **Filozofia e UET-it**, e fokusuar te *qasja kërkimore-shkencore*:

UET-i synon të formojë dhe diplomojë studentë që karakterizohen nga bindje të forta profesionale dhe shkencore, nga fuqia dhe cilësia e argumentimit dhe që zotëron informacionin e nevojshëm për të mbështetur opinionet që mbron.

2) **Dokumentacioni i UET-it**:

Është i plotë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore perkatëse (shih kryesisht: *Statutin e UET-it; Rregulloren bazë; Broshurën e dokumenteve themelore të UET-it; Rregulloren për Organizimin e Programit të studimit të Doktoratures*). Këto dokumente janë të depozituara në sistemin informatik të UET-it dhe të arritshme elektronikisht nga tërë personeli akademik, administrativ si dhe nga studentët.

3) **Rekrutimi dhe cilësia e stafit**:

Shkolla Doktorale në UET ka përzgjedhur dhe rekrutuar një personel të kualifikuar mësimdhënës, drejtues, administrativ e mbështetës, i cili garanton një shërbim cilësor bashkëkohor ndaj studentëve doktorantë. Rekrutimi i personelit akademik mbështetet te grada/titulli shkencor i kandidatit për pedagog, aktiviteti kërkimor-shkencor e botues si dhe te përvoja e gjerë në mësimdhënie universitare dhe në udhëheqje shkencore.

4) **Format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve**:

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit rigoroz dhe të vazhdueshëm. Vlerësimi është rezultante e kombinimit të disa treguesve që përfshijnë provimet përfundimtare dhe ecurinë e studentëve gjatë *Ditëve Doktorale*.

5) **Kontrolli i brendshëm i ecurisë së stafit akademik**:

Në filozofinë e UET-it, kontrolli i brendshëm i ecurisë së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimdhënies dhe synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve.

6) **Kërkimi shkencor**:

Garanton pjesëmarrjen dhe aftësimin e pedagogëve dhe studentëve doktorantë në procesin e kërkimit shkencor, angazhimin e tyre sa më të gjerë në botime e studime shkencore, organizimin periodik të konferencave shkencore nga çdo Departament, botimin e revistave

shkencore “*Polis*”, “*Sociological Analysis*” dhe “*Educatio*”, botimin e monografive, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët etj. Kërkimi shkencor në ciklin e tretë është më i organizuar dhe i orientuar qartë në drejtime prioritare për UET, duke u mbështetur në ndarjen organike sipas profileve të Programit të studimit e më tej sipas drejtimeve (akseve kërkimore) të çdo pedagogu brenda profileve.

7) Organizimi i Ditëve Doktorale:

Nëpërmjet kësaj forme kontrolli dhe debatesh interaktive midis pedagogëve dhe studentëve, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit shërben si një institucion i vlefshëm për sa i përket ndihmesës që i jepet studentit në drejtim të kërkimit shkencor dhe përgatitjes me nivel të punimeve të tyre të Doktoratës.

8) Imazhi i mirë i UET-it në publik:

Sondazhet e organizuara nga vetë UET-i tregojnë se imazhi që ky institucion gëzon në publik është mjaft pozitiv. Ky imazh vjen si rezultat i punës cilësore në funksion të përmbushjes së misionit të UET-it.

9) Bashkëpunimi me institucione akademike ndërkombëtare:

Aston-UK, AAB-Prishtine, Tetove-Maqedoni.

10) Punësimi i doktorantëve në mësimdhënie, përfshirja e tyre në projekte kërkimore.

11) Kombinimi i metodave (formative dhe shumative) për vlerësimin e produktit doktoral.

12) Botimi i periodikëve shkencorë, me hapësira për doktorantët.

13) Organizimi i simpoziumeve dhe konferencave vjetore, dukeui dhënë akses parësor doktorantëve të UET-it.

b. Pika të dobëta:

1) Përfshirja e studentëve në veprimtarinë kërkimore-shkencore të UET-it nuk është ende në nivelin e synuar me objektivat e UET-it.

2) Mobiliteti i studentëve është akoma në nivele minimale lidhur me veprimtaritë e kërkimit shkencor në universitetet dhe institucionet e huaja partnere.

3) Varësia ende e konsiderueshme nga akademikë jashtë UET-it.

4) Raporti i PAE/PAE+PAK nën nivelin e kërkuar prej 60% (aktualisht 52% për të treja fakultetet).

c. Mundësitë:

- 1) Zgjerimi i bashkëpunimit me institucione të tjera akademike ndërkombëtare.
- 2) Emri dhe imazhi pozitiv publik i UET në Shqipëri dhe Rajon mund të ndikojë në përzgjedhjen e mëtejshme të UET-it si një universitet elitare për kërkimin shkencor.
- 3) Kuadri ligjor aktual përbën një mundësi të mirë që UET-i të konsolidohet dhe zhvillohet më tej në të ardhmen.
- 4) Arritjet e UET-it në ciklin e tretë (të doktoraturës) mund të rrisin prirjen për besim të publikut ndaj sektorit privat të arsimit të lartë.

d. Pengesat:

- 1) Udhëzimet e deritanishme të MASH-it për numrin e udhëheqjeve në *Shkollën Doktorale*.
- 2) Perceptimi i *Shkollës Doktorale* si “jo plotësisht brenda UET-it”, ndërkohë që ajo është e lidhur organikisht me Fakultetin: për rekrutim, mësimdhënie, konferenca, botime të doktorantëve etj.
- 3) Vështirësia e diversifikimit të burimeve të financimit, që mbart rrezikun e vështirësisë së financimit të programit të doktoratës në UET, si institucion i vetëfinancuar në tregun shqiptar të Arsimit.

Përfundime

Me cilësinë e anëtarëve të *Grupit të Vlerësimit të Brendshëm* (GVB), ne mund të themi se programi doktoral i Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit në Universitetin Europian të Tiranës është pozicionuar midis programeve të institucioneve më serioze të arsimit të lartë të vendit. Sidoqoftë, ky program vazhdimisht duhet të ndjekë përvojat më të mira në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të bashkëpunojë me institucione brenda dhe jashtë vendit, të bëhet më tërheqës për studiuesit e shquar në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor brenda dhe jashtë vendit si dhe të ndjekë më nga afër të gjitha ndryshimet ekonomike, sociale e kulturore në Shqipëri e në rajon. Kështu, ky program do të garantojë gjithmonë cilësinë e shërbimit që ofron.

ANEKSE

- Aneksi I: Statuti i UET-it
- Aneksi II: Rregullorja e Shkolles Doktorale
- Aneksi III: Organigrama e Shkolles Doktorale
- Aneksi IV: Marrëveshjet me institucionet bashkepunuese
- Aneksi V: Plani mesimor 60 ECTS i programeve te studimit
- Aneksi VI: Kontrata-tip e Punes (per PAB dhe PAK)
- Aneksi VII: Bilancet vjetore
- Aneksi VIII: Raportet e auditit të pavarur
- Aneksi IX: Planimetritë e godinav (njesive ndihmese dhe mbeshtetese)
- Aneksi X: Teknologjia e pajisjeve kërkimore
- Aneksi XI: Kopje e formularit të anketimit
- Aneksi XII: Raporti i auditimit të brendshëm të KSBC-së
- Aneksi XIII: Pyetësori i vlerësimit të pedagogut/udhëheqësit nga studenti
- Aneksi XIV: Formati i *syllabus*-it të lëndëve në Doktoraturë
- Aneksi XV: Vendimi i dt. 30.10.2012 “Për Ditët Doktorale” dhe formati
- Aneksi XVI: Raport-progresi vjetor dhe Raport-progresi tremujor
- Aneksi XVII: Marrëveshja e Partneritetit me *British Council*
- Aneksi XVIII: Dosja e aplikimit të kandidatit për “Doktor” në Mësimdhënie.

Dokumenta të tjera

- Vendimi i Senatit për hapjen e programit
- Vendimi për ngritjen e Gupeve te Vlerësimit të Brendshëm
- Strategjia e UET-it për Mësimdhënien
- Strategjia e UE-it per Kërkimin Shkencor
- Vendimet e akreditimit të programeve të ciklit të pare dhe të dytë
- Vendimi i emërimit të koordinatorit dhe stafit të shkollës doktorale
- Vendimi për ngritjen e Këshillit të Profesorëve
- Rregullorja e brendëshme e Këshillit te Profesorëve
- Marrëveshjet kontraktuale me universitete të huaja
- CV model të pedagoqeve
- Kodi i Etikes dhe Integritetit Akademik
- Dokument tip për Komisionin e Përzgjedhjes së Kandidatëve
- Vendimi i përcaktimit të tarifave të shkollimit
- Rregullorja “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës”
- Projekt-kërkimi shkencor i Shkollës Doktorale të UET-it
- Plani kalendar i Shkollës Doktorale
- Udhëzues mbi Diplomat Doktorale në Universitetin Europian të Tiranës
- Udhëzuesi mbi Ditët Doktorale në UET
- Formati i propozimit doktoral
- Udhëzues mbi elementet kryesore të propozimit doktoral
- Kontrata-tip e studentit të doktoraturës me UET
- Guida e Shkolles Doktorale
- Rregullore e Revistave shkencore të Fakultetit.